Banka e Shqipërisë

2009

RAPORTI I STABILITETIT FINANCIAR

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.
Botuar nga: Banka e Shqipërisë, Sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë.
Tel: 355-4-2222230; 2222152; 2235569;
Faks: 355-4-2223558
e-mail: public@bankofalbania.org

www.bankofalbania.org

Për informacione lidhur me këtë publikim, lutemi kontaktoni:
Zyra e Botimeve, Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Evropian dhe Komunikimit.
E-mail: public@bankofalbania.org

Tirazhi: 900 kopje
Shtypur në shtypshkronjën "ADELprint" sh.p.k.

P Ë R M B A J T J A

HYRJE		7
1	DEKLARATA E STABILITETIT FINANCIAR	9
2	ZHVILLIMET NË MJEDISIN E JASHTËM	19
3	ZHVILLIMET MAKROEKONOMIKE	31
4	TREGJET	43
5	ZHVILLIMET NË SISTEMET E PAGESAVE	48
6	ZHVILLIME TË SISTEMIT FINANCIAR	52
SHËNIME		94

P Ë R M B A J T J A E T A B E L A V E

2 Zhvillimet në mjedisin e jashtëm

Tabelë 1. *Ecuria e disa treguesve kryesorë makroekonomikë të SHBA 2007-2009 dhe parashikimi për vitin 2010.* 20
Tabelë 2. *Ecuria e treguesve kryesorë makroekonomikë në BE dhe Eurozonë.* 21
Tabelë 3. *Ecuria e disa treguesve makroekonomikë në Evropën Qendrore e Lindore.* 23
Tabelë 4. *Tregues kryesorë makroekonomikë.* 31
Tabelë 5. *Të dhënat e prodhimit sipas degëve.* 33
Tabelë 6. *Produkti i Brendshëm Bruto sipas aktivitetit ekonomik, ndryshimet në% të një tremujori me të njëjtin tremujor të një viti më parë(Tv,i/Tv-1,i).* 33
Tabelë 7. *Produkti i Brendshëm Bruto sipas aktivitetit ekonomik, ndryshimet vjetore në përqindje.* 33
Tabelë 8. *Tregues të punësimit.* 37
Tabelë 9. *Financimi i deficitit buxhetor.* 40
Tabelë 10. *Kredia për ekonominë, në milionë lekë.* 41

4 Tregjet

Tabelë 11. *Shlyerja e çeqeve në AIPS.* 49
Tabelë 12. *Pesha e aktiveve të subjekteve të sistemit financiar ndaj PBB-së në vite (në%).* 52
Tabelë 13. *Treguesit e aktivitetit të shoqërive të kursim-kreditit dhe unioneve të tyre sipas tremujorëve.* 57
Tabelë 14. *Pesha e zërave të aktiveve (dhjetor'03 – dhjetor'09).* 58
Tabelë 15. *Pesha e zërave të pasiveve (dhjetor '03 – dhjetor '09).* 59
Tabelë 16. *Pesha e aktiveve dhe detyrimeve në valutë ndaj totalit të aktiveve të sektorit bankar, në përqindje (dhjetor'05 – dhjetor'09).* 60
Tabelë 17. *Të dhënat e kredisë së re, për tremujorin e katërt të vitit 2009.* 67
Tabelë 18. *Pesha e tepricës së kredisë së individëve sipas qëllimit të përdorimit ndaj tepricës së kredisë totale të individëve, në përqindje.* 68
Tabelë 19. *Rritja vjetore e totalit të depozitave për sektorin bankar, gjatë viteve 2004-2009.* 81
Tabelë 20. *Struktura e maturimit të depozitave të reja të pranuara nga sektori bankar në lekë.* 82
Tabelë 21. *Struktura e maturimit të depozitave të reja të pranuara nga sektori bankar, në euro.* 82
Tabelë 22. *Struktura e maturimit të depozitave të reja të pranuara nga sektori bankar, në usd.* 83
Tabelë 23. *Rezultatet e stress-test për skenarin e parë.* 87
Tabelë 24. *Rezultatet e stress-test për skenarin e dytë.* 87
Tabelë 25. *Rezultatet e stress-test për skenarin e parë.* 88
Tabelë 26. *Rezultatet e stress-test për skenarin e dytë.* 88
Tabelë 27. *Rezultatet e stress-test për skenarin e tretë.* 88
Tabelë 28. *Rezultatet e stress-test për skenarin e katërt.* 89
Tabelë 29. *Raporti i kredisë me probleme në fund të vitit 2010* 89
Tabelë 30 *Sektori bankar.* 90
Tabelë 31 *Grupet sipas madhësisë së aktiveve.* 91
Tabelë 32. *Grupet sipas origjinës së kapitalit.* 92

P Ë R M B A J T J A E G R A F I K Ë V E

2 Zhvillimet në mjedisin e jashtëm

Grafik 1. Norma e papunësisë në BE dhe Eurozonë. 21
Grafik 2. Balanca buxhetore në BE dhe Eurozonë. 22
Grafik 3. Borxhi i qeverisë në BE dhe Eurozonë. 22
Grafik 4. Normat bazë të interesit në vendet e zhvilluara. 25
Grafik 5. Normat e tregut të parasë. 25
Grafik 6. Indekset kryesore të tregut të aksioneve. 26
Grafik 7. Spread-i i obligacioneve të korporatave AAA dhe BB. 26
Grafik 8. Indekset e çmimit të lëndëve të para. 27

3 Zhvillimet makroekonomike

Grafik 9. Indeksi i shifrës së afarizmit (rritja vjetore në përqindje). 32
Grafik 10. Treguesi i tendencës ekonomike. 34
Grafik 11. Treguesi i besimit të industrisë. 34
Grafik 12. Treguesi i besimit të ndërtimit. 34
Grafik 13. Treguesi i besimit të shërbimeve. 35
Grafik 14. Treguesi i besimit të konsumatorit. 35
Grafik 15. Kërkesa aktuale dhe e pritshme – industria. 35
Grafik 16. Kërkesa aktuale dhe e pritshme – ndërtimi. 35
Grafik 17. Kërkesa aktuale dhe e pritshme – shërbimet. 35
Grafik 18. Blerjet aktuale dhe të pritshme – konsumatorët. 35
Grafik 19. Gjendja financiare – industria. 36
Grafik 20. Gjendja financiare – ndërtimi. 36
Grafik 21. Gjendja financiare – shërbimet. 36
Grafik 22. Situata financiare aktuale dhe e pritshme e konsumatorëve. 36
Grafik 23. Punësimi aktual dhe i pritshëm – shërbimet. 37
Grafik 24. Punësimi aktual dhe i pritshëm – ndërtimi. 37
Grafik 25. Punësimi aktual dhe i pritshëm – industria. 38
Grafik 26. Remitancat dhe norma e papunësisë në disa vende të Evropës. 38
Grafik 27. Përbërësit e borxhit publik. 41

4 Tregjet

Grafik 28. Indeksi i çmimeve të shtëpive për rrethin e Tiranës. 43
Grafik 29. Pesha e kredisë për prona të patundshme në% kundrejt tepricës së kredisë. 43
Grafik 30. Tregu ndërbankar. 44
Grafik 31. Raporti Bid-to-cover për Bonot. 45
Grafik 32. Volumi i kërkesës dhe ofertës së bonove. 45
Grafik 33. Kurba e yield-eve. 46
Grafik 34. Kursi Ditor i Këmbimit Valutor të EUR, USD dhe GBP në Lekë. 46
Grafik 35. Kursi i këmbimit sipas shportës 80:20. 46
Grafik 36. Normat e tregut. 47
Grafik 37. Spread-i për normën e interesit në%. 47

5 Zhvillimet në sistemet e pagesave

Grafik 38. Pesha e aktiveve të subjekteve të sistemit financiar ndaj totalit të aktiveve të sistemit financiar në%. 52

6 Zhvillime të sistemit financiar

Grafik 39. Rritja e nivelit të aktiveve të institucioneve jobanka sipas tremujorëve në%. 53
Grafik 40. Llogaria kapitale ndaj totalit të aktiveve në%. 53
Grafik 41. Ecuria e kredive në miliardë lekë dhe rritja e tyre në%. 54
Grafik 42. Kredi me probleme ndaj totalit të kredive në%. 54
Grafik 43. Pesha e zërave të aktiveve të shoqërive të sigurimit ndaj totalit të aktiveve në% TIII-09. 55
Grafik 44. Ekspozimi ndaj rrezikut të kursit të këmbimit për sektorin bankar dhe grupet e bankave sipas madhësisë së aktivitetit. 60
Grafik 45. Maturimi mesatar i mbetur i aktiveve dhe pasiveve (në muaj). 61
Grafik 46. Maturimi mesatar i mbetur i depozitave (në muaj). 61
Grafik 47. Maturimi mesatar i mbetur i kredisë (në muaj). 61

Grafik 48.	Ecuria e zërave të aktivit në mln Lekë.	62
Grafik 49.	Kontributi në rritjen e aktiveve nga burimet në%.	63
Grafik 50.	Aktivet me rrezik dhe portofoli i kredisë, ndaj totalit të aktiveve në%.	63
Grafik 51.	Aktivet me rrezik ndaj totalit të aktiveve, sipas grupeve të bankave në%.	64
Grafik 52.	Pesha e portofolit të kredisë ndaj totalit të aktiveve, sipas grupeve të bankave (në%).	64
Grafik 53.	Kredia e re (majtas) dhe përdorimi i kredisë (djathtas).	64
Grafik 54.	Kredia e re sipas tremujorëve në vite (Mars '06=1).	65
Grafik 55.	Shpërndarja e kredisë së re të bizneseve sipas qëllimit të përdorimit (në%).	65
Grafik 56.	Shpërndarja e kredisë së re për biznesin në%.	65
Grafik 57.	Shpërndarja e kredisë së re për individët sipas qëllimit të përdorimit (në%).	66
Grafik 58.	Shpërndarja e kredisë së re për individët në%, Dhjetor 2009.	66
Grafik 59.	Shpërndarja e kredisë, Dhjetor 2009.	67
Grafik 60.	Pesha e tepricës së kredisë së bizneseve sipas qëllimit të përdorimit ndaj tepricës së kredisë totale të bizneseve në%.	68
Grafik 61.	Shpërndarja e kredisë (në% ndaj totalit) Dhjetor 2009.	69
Grafik 62.	Pesha mesatare e kredisë për rrethet kryesore të vendit në% (T4/07-T4/09).	69
Grafik 63.	Pesha mesatare e kredisë sipas afateve për rrethet kryesore të vendit në% (T4/07-T4/09).	69
Grafik 64.	Shpërndarja e kredisë sipas sektorëve të ekonomisë për rrethet kryesore të vendit në% (TIV-2009).	69
Grafik 65.	Hua me probleme (bruto) ndaj totalit të huave në%.	70
Grafik 66.	Hua me probleme ndaj totalit të huave sipas grupeve të bankave (në%).	70
Grafik 67.	Cilësia e portofolit të kredisë sipas sektorëve të ekonomisë në%.	71
Grafik 68.	Hua me probleme neto ndaj kapitalit rregullator në%.	72
Grafik 69.	Hua me probleme neto ndaj kapitalit bazë sipas grupeve të bankave në%.	72
Grafik 70.	Ecuria e raportit të mbulimit të kredive me probleme me provigjone sipas tremujorëve në%.	72
Grafik 71.	Kategoritë e kredisë të kolateralizuara me pasuri të paluajtshme në%.	73
Grafik 72.	Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit (raporti i kapitalit rregullator ndaj aktiveve të ponderuara me rrezik).	73
Grafik 73.	Raporti i kapitalit aksioner ndaj aktiveve.	74
Grafik 74.	Kthimi nga kapitali (RoE).	75
Grafik 75.	Kthimi nga aktivet (RoA).	75
Grafik 76.	Shpenzime të përgjithshme jo për interesa ndaj të ardhurave bruto të veprimtarisë.	76
Grafik 77.	Të ardhurat neto nga interesat ndaj të ardhurave bruto të veprimtarisë.	77
Grafik 78.	Paraqitja grafike e elementeve përbërëse të kthimit nga kapitali.	79
Grafik 79.	Struktura e depozitave të sektorit bankar sipas maturimit.	81
Grafik 80.	Vëllimi total i pranimeve të reja në lekë kundrejt normave mesatare të interesit për llogaritë rrjedhëse, depozitat pa afat dhe depozitat me afat në lekë.	83
Grafik 81.	Vëllimi total i pranimeve të reja në valutë kundrejt normave mesatare të interesit për llogaritë rrjedhëse, depozitat pa afat dhe depozitat me afat në euro dhe usd.	83
Grafik 82.	Aktive të jorezidentëve / detyrime ndaj jorezidentëve.	85
Grafik 83.	Totali i aktiveve të jorezidentëve mbi totalin e aktiveve (sistemi).	85
Grafik 84.	Aktivet e jorezidentëve, ndaj totalit të aktiveve, sipas grupbankave.	85
Grafik 85.	Totali i pasiveve të jorezidentëve mbi totalin e pasiveve (sistemi).	85
Grafik 86.	Detyrimet ndaj jorezidentëve, ndaj totalit të detyrimeve, sipas grupbankave.	86
Grafik 87.	Përqendrimi i detyrimeve ndaj jorezidentëve.	86
Grafik 88.	Raporti i portofolit të bonove të thesarit/hua marrë nga Banka e Shqipërisë.	86
Grafik 89.	Gap i maturimit për shportat "Deri në 1 muaj"dhe "Deri në 3 Muaj".	86
Grafik 90.	Shpërndarja e raportit të kredive me probleme sipas katër skenarëve.	89

HYRJE

Ky është numri i tretë i Raportit të Stabilitetit Financiar, një publikim i Bankës së Shqipërisë, i cili duke filluar prej vitit 2010, do të përgatitet dhe do të publikohet dy herë në vit. Ky ndryshim motivohet nga nevoja për të integruar në një dokument të vetëm edhe Deklaratën e Stabilitetit Financiar, publikimi i së cilës çdo gjashtë muaj është një kërkesë ligjore. Në këtë mënyrë, realizohet një konsolidim dhe fokusim më i mirë i informacionit, përsa i takon numrit të publikimeve, çështjeve që trajtohen dhe përshtatshmërisë kohore. Deklarata e Stabilitetit Financiar është vendosur në hyrje të raportit dhe përgjithësisht shërben edhe si një përmbledhje e tij.

Qëllimi i raportit është identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve me të cilat ndeshet sistemi financiar dhe infrastruktura e tij, për t'i dhënë autoriteteve publike mundësinë që të identifikojnë masat përkatëse për korrigjimet e nevojshme. Për hartimin e raportit janë shfrytëzuar të dhëna që disponohen në Bankën e Shqipërisë, është shkëmbyer informacion me autoritete të tjera që mbikëqyrin veprimtarinë e tregut financiar, si edhe janë shfrytëzuar informacione dhe analiza të institucioneve të vendit dhe të atyre financiare ndërkombëtare, publike dhe private.

Të dhënat dhe analizat përfshijnë kryesisht zhvillimet gjatë vitit 2009. Pritjet për zhvillimet e ardhshme shtrihen sipas rastit, deri në fund të gjashtëmujorit të parë ose deri në fund të vitit 2010. Duke nisur nga numri tjetër i raportit, fokusi i analizës do të jetë mbi zhvillimet që kanë ndodhur në periudhat pararendëse gjashtëmujore.

Stabiliteti i sistemit financiar është vlerësuar në bazë të performancës dhe rreziqeve që krijohen nga ndërveprimi i tij me mjedisin e përgjithshëm ekonomik, të brendshëm dhe të jashtëm, si edhe nga veprimtaria e tij. Për të vlerësuar rreziqet që vijnë për shkak të ndërveprimit me mjedisin rrethues, janë analizuar zhvillimet më të fundit në tregjet financiare ndërkombëtare dhe në ekonomitë e zhvilluara e ato të rajonit, si dhe është bërë një vlerësim mbi ndikimin e tyre në sistemin financiar të vendit dhe sektorin bankar. Ndër treguesit e brendshëm, janë vlerësuar zhvillimet e përgjithshme dhe pritshmëritë për rritjen ekonomike, bilancin tregtar, nivelin e përgjithshëm të çmimeve, kursin e këmbimit dhe treguesit fiskalë. Gjithashtu, nëpërmjet një analize të situatës së punëzënies, është vlerësuar situata e të ardhurave personale dhe efektet që ajo ka mbi aftësinë paguese të kredimarrësve të sektorit bankar.

Për të vlerësuar rreziqet që rrjedhin si rezultat i veprimtarisë së sistemit financiar, janë analizuar zhvillimet në treguesit kryesorë të shëndetit financiar të tij, ku përfshihen kapitali, cilësia e aktiveve dhe performanca financiare. Madhësia e rreziqeve është vlerësuar nëpërmjet analizës stress-test ndërtuar mbi skenarë të ndryshëm. Në një hapësirë informuese është realizuar gjithashtu, një vlerësim i përmbledhur i situatës së sektorit financiar jobankar.

Me qëllim që raporti të lexohet nga grupe të ndryshme interesi dhe publiku në tërësi, është synuar që gjuha e përdorur dhe informacioni që paraqitet, të jenë sa më të përshtatshëm. Përmirësimi i cilësisë së raportit, veçanërisht në kuadër të të dhënave që përmban, do të jetë objektivi ynë për çdo publikim të ardhshëm.

1 DEKLARATA E STABILITETIT FINANCIAR

Në mbështetje të kërkesës së nenit 69 të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9962, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", për të informuar Këshillin e Ministrave, Kuvendin e Republikës së Shqipërisë dhe për të tërhequr vëmendjen e institucioneve financiare dhe të publikut mbi gjendjen e sistemit financiar në vend dhe rreziqet potenciale që mund të kërcënojnë qëndrueshmërinë e tij, Banka e Shqipërisë publikon Deklaratën e Stabilitetit Financiar, si pjesë e Raportit të Stabilitetit Financiar për vitin 2009.

Për shkak të stimujve të jashtëzakonshëm fiskalë e monetarë në periudhën 2008-2009 dhe pas përmirësimit të situatës në sektorin financiar, ekonomia botërore paraqitet e stabilizuar dhe në prag të një rigjallërimi të qëndrueshëm. Më konkretisht:

Stimujt e jashtëzakonshëm monetarë e fiskalë të ofruar nga autoritetet publike në mbarë botën kanë rezultuar efektivë në uljen e tensioneve në tregjet financiare dhe në zbutjen e ndikimit negativ të krizës në sektorët realë të ekonomisë. Stabilizimi i tregjeve financiare ndodhi më shpejt nga sa pritej, por mjaft nga parametrat e tregjeve që lidhen me vëllimet, me likuiditetin, me çmimet, janë ende larg niveleve të parakrizës duke reflektuar praninë e pasigurisë nga ana e agjentëve ekonomikë. Kushtet e huamarrjes janë ende të vështira, veçanërisht për sipërmarrjet e mesme dhe të vogla, si edhe për konsumatorët. Tregjet e produkteve të strukturuara vazhdojnë të jenë të dëmtuara duke e vështirësuar rolin ndërmjetësues të institucioneve financiare, ndërsa funksionimi i tregjeve të kapitalit në segmentet e pakolateralizuara apo me cilësi të ulët, ka qenë i dobët dhe me kosto të lartë.

Ecuria e sektorit financiar ka ndikuar ecurinë e sektorit real të ekonomisë, por rikuperimi i këtij të fundit ka qenë përgjithësisht më i ngadaltë. Aktiviteti ekonomik i vendeve të zhvilluara është tkurrur në total me 3.9% gjatë vitit 2009, por ka shfaqur shenja të qarta stabilizimi në gjashtëmujorin e dytë të vitit nën ndikimin e politikave stimuluese. Vlerësohet që rigjallërimi i ekonomisë së këtyre vendeve do të jetë i ngadaltë dhe niveli i prodhimit do të mbetet nën prirjen historike, të paktën deri në vitin 2011. Grupi i vendeve në zhvillim ka mbajtur peshën kryesore të aktivitetit ekonomik global, me një rritje mesatare të përgjithshme prej 2.1% gjatë vitit 2009. Në këtë grup vendesh, ndikimin kryesor në rritjen ekonomike e kanë dhënë vendet në zhvillim të Azisë, ndërsa vendet në zhvillim të Evropës kanë shfaqur një rigjallërim më të ngadaltë të ekonomisë.

Ecuria ekonomike e Evropës ka ardhur duke u përmirësuar gjatë vitit 2009, veçanërisht në tremujorin e fundit, por përmirësimi ka ndodhur me ritme më të ngadalta se në SHBA dhe me diferenca të theksuara midis vendeve të rajonit. Stimujt monetarë e fiskalë dhe rigjallërimi i aktivitetit tregtar ishin dy faktorët kryesorë që mbështetën stabilizimin ekonomik të rajonit. Vendet e Evropës Qendrore dhe Juglindore vlerësohet se kanë pësuar një tkurrje të ekonomisë me 4.3% në vitin 2009. Vendet e Zonës së Euros vlerësohet

se kanë regjistruar një tkurrje të ekonomisë me 4% gjatë vitit 2009. Për këto vende, Komisioni Evropian parashikon një rritje ekonomike modeste me 0.7% gjatë vitit 2010, ku kontributin kryesor do ta japin vendet më të fuqishme si Gjermania dhe Franca. Disa vende të tjera, si Greqia ose Spanja, do të vazhdojnë të përjetojnë tkurrje të ekonomisë. Në përgjithësi, ritmi i rigjallërimit të ekonomisë do të kushtëzohet prej aftësisë ndërmjetësuese të sektorit financiar, ecurisë së tregjeve të mjeteve jofinanciare, situatës fiskale dhe zhvillimeve në tregun e punës.

Zhvillimet në tregjet e këmbimit të valutave, kanë reflektuar perceptimin e tregjeve për shkallën e ndikimit të ekonomive më të avancuara nga kriza financiare ndërkombëtare. Gjatë vitit 2009, dollari amerikan është nënçmuar ndaj euros dhe valutave të tjera kryesore. Megjithatë, në dy muajt e fundit të vitit, duket se pritjet për shpejtësinë e rigjallërimit të ekonomive kryesore, për lëvizjet në normat e interesit të politikës monetare si edhe për qëndrueshmërinë e pozicioneve fiskale, kanë mbështetur një mbiçmim të dollarit amerikan ndaj euros. Sidoqoftë, luhatshmëria në këto tregje ka vijuar të jetë e lartë duke reflektuar praninë e pasigurisë që ende ndjejnë investitorët dhe rritjen e rrezikut të kreditit për borxhin sovran.

Në tregjet e energjisë dhe të lëndëve të para, pas rënies së theksuar të çmimeve në gjysmën e dytë të vitit 2008, u konstatua stabilizimi i çmimeve në fillim të vitit 2009 dhe një rritje relative e tyre pas tremujorit të dytë të vitit. Kjo ecuri u ndikua kryesisht prej rigjallërimit të aktivitetit ekonomik në rajonet në zhvillim dhe falë përmirësimit të kushteve në tregjet financiare botërore.

Megjithë pritjet për një përmirësim të qëndrueshëm të gjendjes së ekonomisë botërore, ekzistojnë gjithashtu disa rreziqe, që mund të bëhen shkak për episode paqëndrueshmërie në rajone ose vende të ndryshme. Këto rreziqe me ndikim më afatgjatë, janë krijuar për shkak të masave që u morën për të përballuar efektin afatshkurtër të krizës. Më konkretisht:

Për shkak se stabilizimi i ekonomisë botërore është realizuar në kushtet e stimulit të jashtëzakonshëm fiskal e monetar, kjo është shoqëruar me përkeqësim të pozicionit fiskal dhe krijimin e rritjeve të paqëndrueshme të çmimeve të mjeteve financiare dhe jofinanciare. Këto pasoja kërkojnë tërheqjen e këtyre stimujve në mënyrë graduale dhe të kujdesshme. Një numër faktorësh që lidhen me vështirësinë në harmonizimin e këtyre politikave në nivel ndërkombëtar, me mundësinë e ndalimit të procesit të rigjallërimit ekonomik në vendet e zhvilluara dhe me shfaqjen e luhatjeve të ndjeshme në treguesit financiarë, ruajnë pasigurinë tek tregjet financiare për ecurinë e ekonomisë botërore në të ardhmen dhe pengojnë një zhvillim ekonomik më të shpejtë.

Rritja e shpejtë e deficiteve buxhetore dhe borxheve publike në mbarë botën ka rritur dyshimet për aftësinë paguese të qeverive të ndryshme. Për shkak të mënyrës së ndërtimit dhe çështjeve të tjera strukturore, Bashkimi Evropian po e ndjen këtë hezitim të investitorëve më tepër se SHBA-të. Situata e vështirë fiskale në disa vende të Eurozonës, kërkon që masat e forta korrigjuese për

uljen e deficitit buxhetor në nivel kombëtar, të shoqërohen me mbështetje të mjaftueshme financiare në nivelin e Bashkimit Evropian, me qëllim që qëndrueshmëria e këtij projekti të përbashkët politik dhe monetar të mos vihet seriozisht në diskutim. Nga ana tjetër, në terma më praktikë kjo ndihmë financiare është e nevojshme për të zbutur rritjen e kostos së borxhit edhe për sektorin privat dhe për të zbutur tkurrjen e ekonomisë si rezultat i rënies së ndjeshme të stimulit fiskal.

Në rajonin e Evropës Qendrore dhe Juglindore, mjedisi ekonomik vijon të përballet me sfida të rëndësishme. Sipas raportit të BQE-së, papunësia, rënia e të ardhurave dhe falimentimet në sektorin privat do të mbeten të larta dhe gjatë vitit në vazhdim, duke ruajtur një ndikim negativ në cilësinë e portofolit të kredive bankare dhe në rritjen ekonomike. Gjithashtu, ndjeshmëria e sektorit privat ndaj rrezikut të kursit të këmbimit mbetet e lartë për shkak të huamarrjes ekzistuese në monedhë të huaj.

Sipërmarrjet private mund të kenë përsëri një vit të vështirë, për sa kohë që tërheqja e stimulit fiskal nuk shoqërohet me rritjen e ndërmjetësimit të sistemit financiar. Aftësia e sektorit privat për të financuar nevojat e tyre për investime në tregjet e kapitalit, do të ndikohet negativisht prej tepricës së kapaciteteve dhe të inventarëve në kushtet e rënies së kërkesës dhe prej rritjes së kostos së emetimit të borxhit privat. Rigjallërimi i ekonomisë në mënyrë të ngadaltë do të diktonte një korrigjim të mëtejshëm të kostove dhe të marzheve të fitimit, duke përcaktuar kështu aftësinë e sipërmarrjeve të biznesit për të përballuar mundësinë e rënies së mëtejshme të kërkesës për mallra.

Ekonomia e vendit arriti të shënojë një rritje ekonomike pozitive gjatë vitit 2009, megjithë ndikimin e krizës financiare dhe ekonomike ndërkombëtare. Sistemi financiar, i dominuar prej sektorit bankar, u paraqit i qëndrueshëm dhe stimuli fiskal e monetar zbuti vështirësitë e sektorit real të ekonomisë. Më konkretisht:

Gjatë vitit 2009, ekonomia e vendit u përball me ngadalësim të ritmit të rritjes ekonomike, por ruajti një rritje ekonomike pozitive duke shfaqur një rezistencë të mirë ndaj ndikimit të krizës financiare dhe ekonomike ndërkombëtare. Ndër faktorët që ndikuan në rënien e ritmit të rritjes ekonomike përmendim: qëndrueshmërinë e deficitit të bilancit tregtar; rritjen e vështirësive të sipërmarrjeve të biznesit për shkak të rënies së kërkesës së jashtme dhe rënies së financimit nga ana e sektorit bankar; dhe rënien e dinamizmit të konsumit të familjeve për shkak të rënies së financimit nga bankat, rënies së dërgesave të emigrantëve dhe pasigurinë për nënçmimin e kursit të këmbimit të monedhës kombëtare. Ndër faktorët që mbështetën rritjen ekonomike gjatë vitit të kaluar, përmendim veprimet e autoriteteve publike për të rivendosur me shpejtësi besimin e publikut në sistemin financiar dhe sektorin bankar, si edhe stimulin fiskal që u realizua nëpërmjet rritjes së shpenzimeve publike, veçanërisht të investimeve publike.

Në lidhje me politikën fiskale, në fund të vitit 2009 teprica buxhetore rezultoi negative dhe u vlerësua në masën 79 miliardë lekë ose rreth 7.1% e

Produktit të Brendshëm Bruto (PBB). Sipas analizës së Ministrisë së Financave, të ardhurat e përgjithshme të buxhetit u realizuan në masën 298 miliardë lekë, rreth 93.2% e planit të rishikuar nga ana e Ministrisë së Financave dhe me një rritje prej rreth 2.4% krahasuar me vitin 2008. Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit u realizuan në masën 377 miliardë lekë, rreth 94% e planit të rishikuar nga ana e Ministrisë së Financave dhe me një rritje prej rreth 7.8% në krahasim me vitin 2008. Rritja e deficitit të buxhetit është shoqëruar me një rritje të nevojës për huamarrje, me qëllim financimin e tij. Kështu, financimi i deficitit me burime të brendshme ishte në masën 64%, ku pak më tepër se gjysma e tyre përfaqësohej nga të ardhurat nga privatizimet. Pjesa tjetër u financua me burime të jashtme, ku rreth 63% e tyre përfaqësonte financimin me kredi të përfituar nga institucionet financiare jorezidente. Gjatë vitit 2009, pjesa e financimit që është siguruar me huamarrje nga subjektet rezidente, nëpërmjet letrave me vlerë të borxhit ose kredive, vlerësohet në masën 23.8 miliardë lekë ose 30.8% e nevojave të përgjithshme për financimin e deficitit. Në vitin 2008, të njëjtët tregues ishin përkatësisht në masën 19 miliardë lekë ose 31.5%. Për sa i takon instrumenteve të përdoruara për financim, gjatë vitit 2009 ka patur një ritëm më të ulët të emetimit të letrave me vlerë të borxhit afatgjatë, në krahasim me vitin 2008. Arsyeja lidhet me preferencën më të madhe të investitorëve, kryesisht të bankave dhe të individëve, për investimet në instrumente afatshkurtra, në kushtet e rritjes së pasigurisë për nevojat e tyre për fonde likuide. Në afatin e shkurtër, një politikë fiskale me karakter ekspansionist i shërbeu nevojës për të ofruar një përgjigje kundërciklike ndaj ndikimit të krizës ndërkombëtare mbi zhvillimin e ekonomisë së brendshme. Duhet patur në konsideratë që efekti i këtij stimuli mbi zhvillimin ekonomik, u shfaq më i dobët në tremujorin e fundit të vitit, duke e bërë të nevojshme njohjen më të mirë të faktorëve strukturorë që kushtëzojnë përcjelljen e stimujve fiskalë e monetarë në zhvillimin e ekonomisë. Me fjalë të tjera, eficienca reale e një politike fiskale ekspansioniste mund të gjykohet me saktësi më të madhe vetëm nëpërmjet vlerësimit të eficiencës së përdorimit të stimulit fiskal në projektet e ndryshme të zhvillimit.

Për sa i takon gjendjes së sektorit real të ekonomisë gjatë vitit 2009, tregues të ndryshëm mbështesin vlerësimet për një situatë përgjithësisht më të dobët në krahasim me vitin 2008, një prirje e përforcuar kryesisht në tremujorin e fundit të vitit. Ndër to përmendim rënien e të ardhurave të buxhetit që mblidhen në formën e taksave dhe të tatimeve, rënien e investimeve dhe të konsumit si rezultat i rënies së financimeve prej sektorit bankar dhe dërgesave nga jashtë, dhe në përgjithësi ngadalësimin e rritjes ekonomike. Informacioni që merret nëpërmjet vrojtimeve konfirmon këtë situatë. Kështu, ndonëse vlera nominale e shitjeve u rrit mesatarisht me rreth 6% në vitin 2009, në tremujorin e katërt të vitit rritja e tyre ishte vetëm 2%. Sektorët e industrisë dhe të ndërtimit kanë patur një ndikim negativ në ecurinë e shitjeve, ndërsa sektori i shërbimeve ka dhënë ndikimin kryesor pozitiv në ecurinë e tyre. Në gjendjen ekonomike të bizneseve, përgjithësisht konstatohet rritja e kapaciteteve të papërdorura dhe rënia e investimeve, si edhe përkeqësimi i pritjeve për ecurinë e përgjithshme të ekonomisë. Kështu, në fund të vitit 2009, përdorimi i kapaciteteve nga ana e bizneseve zbriti në rreth 66%, kundrejt mesatares afatgjatë prej rreth 74%. Gjithashtu, në tremujorin e fundit të vitit 2009, treguesi i pritjeve ekonomike

zbriti me rreth 16.8 pikë përqindjeje prej mesatares së tij afatgjatë, pas një ecurie pozitive në dy tremujorët paraardhës. Indeksi i besimit të biznesit ka shënuar gjithashtu rënie në tremujorin e katërt të vitit 2009, në përbërësit e tij kryesorë të industrisë, të ndërtimit e më pak të shërbimeve. Nga ana tjetër, besimi i konsumatorëve për zhvillimin e ekonomisë ka qenë më i qëndrueshëm. Për sa i takon zhvillimeve në bilancin e pagesave, gjatë vitit 2009 u konstatua një ulje e lehtë e deficitit të llogarisë korrente dhe e deficitit tregtar në vlerë absolute. Megjithatë, në raport me PBB-në, deficiti tregtar ruajti vlerën 27%, sa edhe në vitet 2007 e 2008. Dërgesat financiare vjetore nga emigrantët, vlerësohen rreth vlerës 780 milionë euro, me një rënie prej rreth 53 milionë eurosh në krahasim me vitin 2008.

Sistemi financiar shënoi zgjerim të veprimtarisë së tij gjatë vitit 2009, ndonëse me ritme më të ulëta se në vitin 2008. Niveli i ndërmjetësimit financiar në Shqipëri, i matur si raport i mjeteve të sistemit financiar[1] ndaj PBB-së, vlerësohet se është ngritur në nivelin 83% në fund të vitit 2009, kundrejt 82% në fund të vitit 2008. Në fund të vitit 2009, vëllimi i mjeteve të institucioneve financiare u rrit me rreth 7% krahasuar me fundin e vitit 2008. Sektori bankar mbizotëron në vlerën e përgjithshme të mjeteve të sistemit financiar. Në fund të vitit 2009, në vendin tonë operonin 16 banka dhe mjetet e tyre përfaqësonin rreth 94.7% të totalit të mjeteve të sistemit financiar dhe rreth 78.5% të PBB-së. Vlera e mjeteve të sektorit bankar u rrit në 886.3 miliardë lekë, me një rritje nominale vjetore prej 6.3%, ose rritje reale[2] prej 1.2%, kundrejt fundit të vitit 2008. Ecuria e burimeve financiare, e të ardhurave dhe e kapitalit të sistemit financiar, u ndikua prej krizës financiare ndërkombëtare dhe ndikimit të saj në ekonominë reale të vendit. Në sektorin bankar, rënia e depozitave të publikut u ndërpre në fund të tremujorit të parë, dhe rikthimi i tyre në banka ka vijuar me ritme të qëndrueshme gjatë gjithë pjesës tjetër të vitit 2009. Sidoqoftë, ndryshimet në situatën e likuiditetit, nënçmimi i kursit të këmbimit si edhe vështirësitë e sektorit real të ekonomisë, ndikuan në ngadalësimin e kreditimit dhe në rënien e cilësisë së tij.

Në fund të vitit 2009, veprimtaria e kreditimit, duke përfshirë edhe interesat e përllogaritura, zinte rreth 50.8% të totalit të mjeteve të sektorit bankar, ose rreth 40% të PBB-së. Ndërkohë, raporti i kredive me probleme ndaj vlerës së përgjithshme të portofolit të kredisë u ngjit në nivelin 10.5%. Nevoja për rritjen e fondeve rezervë për përballimin e rrezikut të kreditit nga ana e bankave, ndikoi në rënien e rezultatit financiar të sektorit. Për këto arsye, gjatë vitit 2009, rezultati financiar i sektorit bankar ishte pozitiv për rreth 3.5 miliardë lekë, gati gjysma e vlerës së realizuar një vit më parë. Kapitalizimi i veprimtarisë mbeti i mjaftueshëm gjatë vitit 2009, si rezultat i rënies së ritmit të zgjerimit të investimeve me rrezik të lartë në banka, injektimit të kapitalit të ri nga aksionerët dhe ruajtjes së një rezultati neto pozitiv. Në fund të vitit 2009, treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit ishte 16.2%. Autoritetet publike ndërmorën disa veprime për të mbështetur sistemin financiar dhe veçanërisht sektorin bankar, gjatë vitit 2009. Ndër këto veprime, veçojmë miratimin e ligjit për rritjen e vlerës së sigurimit të depozitave të publikut, si edhe vendimet e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë për të kufizuar ekspozimin e bankave ndaj grupeve të huaja bankare zotëruese dhe për të pezulluar

shpërndarjen e fitimit të bankave të realizuar në vitin 2008 dhe gjatë vitit 2009. Së bashku me këto vendime, gjatë vitit 2009 vijuan të zbatohen edhe një sërë vendimesh të tjera të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë që në tremujorin e fundit të vitit 2008, në lidhje me krijimin e kushteve më lehtësuese për sigurimin e likuiditetit në tregun ndërbankar. Vendimet e Bankës se Shqipërisë në muajt janar dhe tetor për të ulur normën bazë të interesit me 1 pikë përqindje, në nivelin 5.25%, kontribuan më tej në rritjen e mundësive të sektorit bankar për të siguruar likuiditet me një kosto më të ulët.

Nga këndvështrimi i nevojës për një zhvillim të qëndrueshëm të ekonomisë së vendit, është e nevojshme të ndërmerren disa veprime për të korrigjuar disa çekuilibra të krijuar gjatë vitit të kaluar. Më konkretisht:

Zhvillimi ekonomik i vendit gjatë vitit 2010, do të mbështetet prej një situate më të favorshme të ekonomisë ndërkombëtare, e cila do të ofrojë një mjedis më të mirë për investimet e huaja dhe do të mbështesë më mirë kërkesën për eksportet e vendit. Megjithatë, ky ndikim pozitiv pritet të jetë i kufizuar, për shkak të problemeve të shfaqura në ekonominë greke. Në ekonominë e brendshme, zhvillimet e konstatuara gjatë vitit 2009 në lidhje me rritjen e deficitit buxhetor dhe të borxhit të brendshëm, uljen e ritmit të kreditimit nga ana e sektorit bankar, dhe me një situatë më të ngurtë në ecurinë e prodhimit dhe të konsumit, duhet të adresohen nëpërmjet veprimeve të shpejta dhe të vendosura, me një shtrirje kohore të përshtatshme. Në këtë kuadër, është e domosdoshme të kontrollohet deficiti buxhetor për vitin 2010, në nivele që garantojnë respektimin e objektivave të përcaktuar në Kuadrin Makroekonomik Afatmesëm, në lidhje me nivelin e deficitit buxhetor dhe të borxhit publik. Shkurtimi i shpenzimeve, veçanërisht i atyre korrente, duhet të jetë instrumenti kryesor në realizimin e këtij objektivi, në kushtet kur ecuria e të ardhurave publike mbetet e paqartë dhe potenciali i rritjes së tyre duket i kufizuar. Ulja e shpenzimeve publike do të ndikojë në përmirësimin e deficitit të llogarisë korrente në bilancin e pagesave, duke ndikuar pozitivisht në faktorët që përcaktojnë qëndrueshmërinë e kursit të këmbimit. Nga ana tjetër, konsolidimi i financave publike, i pasqyruar nëpërmjet rivendosjes së prirjes rënëse të deficitit buxhetor, merr rëndësi në lidhje me mundësinë dhe me uljen e kostos së financimit të tij, duke përmirësuar në vazhdimësi situatën e likuiditetit në tregun financiar dhe duke çliruar më shumë burime financiare në sistem, përdorimi i të cilave do të mbështesë rritjen e kreditimit në sektorin privat. Sipërmarrjet e biznesit dhe familjet do të vazhdojnë të ndjejnë vështirësi edhe gjatë vitit 2010, për sa kohë që ecuria e paqëndrueshme e të ardhurave të disponueshme dhe e konsumit, do të ndikojë në ruajtjen e kapaciteteve të lira dhe në ritmin e ulët të investimeve private. Megjithatë, kjo periudhë duhet të shfrytëzohet nga sipërmarrjet e biznesit për të kontrolluar kostot dhe për të kryer veprimet e nevojshme për ristrukturimin e veprimtarisë me qëllim përmirësimin e eficiencës. Në përgjithësi, këto veprime të autoritetit fiskal dhe të agjentëve ekonomikë privatë në afat të shkurtër, janë të nevojshme për të krijuar një mjedis më të përshtatshëm që do të mundësojë ndërmarrjen e masave të tjera për rritjen e kontributit të prodhimit në rritjen ekonomike dhe rritjen e kursimeve të brendshme, në një afat më të gjatë.

Sistemi financiar do të vijojë të zgjerojë veprimtarinë e tij edhe gjatë vitit 2010. Për shkak të peshës së ulët në sistemin financiar, pjesa e institucioneve financiare jobanka do të vazhdojë të provojë një rritje natyrale të veprimtarisë. Sektori bankar do të zgjerojë veprimtarinë në nivele më të larta se në vitin 2009, por përsëri më pak se mesatarja afatgjatë e rritjes vjetore. Zgjerimi i veprimtarisë ka të ngjarë të jetë më i shpejtë në gjysmën e dytë të vitit. Në drejtim të burimeve të financimit të veprimtarisë, sektori bankar do të përfitojë prej rritjes së qëndrueshme të depozitave të publikut. Rritja e depozitave në lekë, do të vazhdojë të mbështetet prej flukseve më të qëndrueshme të depozituesve, kthimit real pozitiv dhe pritjes për një qëndrueshmëri më të madhe në kursin e këmbimit. Rritja e depozitave në valutë do të reflektojë ecurinë sezonale duke qenë më e lartë në stinën e verës. Struktura e maturimit të depozitave në përgjithësi, nuk pritet të ketë ndryshime të rëndësishme prej gjendjes aktuale, megjithatë afati mesatar i maturimit të depozitave pritet të jetë më i lartë gjatë vitit 2010, në krahasim me vitin 2009. Përmasat e këtij ndryshimi do të përcaktohen prej ecurisë së të ardhurave të depozituesve dhe prej stimujve që do të vendosin bankat për të orientuar strukturën e kursimeve. Banka e Shqipërisë do të vijojë të ofrojë likuiditetin e nevojshëm në tregun ndërbankar. Përsa i takon linjave të financimit dhe kapitalit të aksionerëve, Banka e Shqipërisë do të vijojë të kërkojë që bankat të disponojnë sasitë e nevojshme jo vetëm për të zhvilluar një veprimtari normale e për të qenë në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullativ, por edhe për të mbështetur një rigjallërim të veprimtarisë me rreziqe të mirëkontrolluara. Përsa i takon investimeve të bankave, Banka e Shqipërisë pret ritme pak më të larta të kreditimit nga ana e sektorit bankar gjatë vitit 2010 në krahasim me vitin 2009, ku pjesa më e madhe e rritjes vlerësohet të ndodhë në gjysmën e dytë të tij.

VLERËSIM MBI NDJESHMËRINË E SEKTORIT BANKAR NDAJ RREZIQEVE

Stabiliteti i sistemit financiar dhe veçanërisht i sektorit bankar, përcaktohet nga marrëdhëniet e veprimtarisë financiare me zhvillimet ekonomike të brendshme dhe të jashtme, dhe ndërveprimin e tyre me gjendjen e brendshme të vetë sistemit financiar. *Mbështetur në analizën e zhvillimeve të vitit 2009, vlerësohet që niveli i përgjithshëm i rrezikut për sistemin financiar dhe sektorin bankar, është ulur. Megjithë përmirësimin e disa elementeve të veprimtarisë financiare në afat të shkurtër, gjatë vitit 2009 janë shfaqur disa sfida që do të ndikojnë mbi veprimtarinë e sistemit financiar dhe veçanërisht të sektorit bankar, për një periudhë afatmesme, duke kërkuar në këtë mënyrë një monitorim dhe trajtim të kujdesshëm.*

Në afat të shkurtër, situata financiare e sektorit bankar ka përfituar pozitivisht nga këto zhvillime:

a) *përmirësimi i ndjeshëm i situatës së likuiditetit, në kushtet e rikthimit të besimit të publikut dhe rritjes së qëndrueshme të depozitave.* Vlerësohet që gjatë vitit 2009, rritja vjetore e vlerës së depozitave të publikut ishte në nivelin 7.6%, duke u ngjitur në vlerën 694.3 miliardë lekë. Kjo

vlerë është pothuaj e njëjtë me vlerën e depozitave në fundin e muajit shtator 2008, përpara fillimit të tërheqjes së depozitave. Megjithatë, në këtë krahasim duhet patur parasysh edhe nënçmimi i kursit të këmbimit të lekut gjatë vitit 2009, i cili ndikon në rritjen e vlerës në lekë të depozitave në valutë. Sidoqoftë, është e rëndësishme që rritja e depozitave të publikut në banka gjatë vitit 2009, ka vijuar me ritme të qëndrueshme edhe gjatë muajve të parë të vitit 2010. Ritmi i rritjes së depozitave të publikut do të ishte më i lartë nëse do të përmirësohej situata në sektorin real të ekonomisë dhe do të gjallërohej veprimtaria e kreditimit nga sektori bankar.

b) *rritja me ritme më të ulëta e mjeteve me rrezik të sektorit bankar*. Gjatë vitit 2009, është pakësuar ndjeshëm zgjerimi i mjeteve (aktiveve) me rrezik të sektorit bankar, i ndikuar kryesisht prej ritmit shumë më të ulët të rritjes së kreditimit dhe në përgjithësi, rënies së ritmit të zgjerimit të veprimtarisë bankare. Në fakt, gjatë vitit 2009 sektori bankar e rriti kreditimin me rreth 13.2%, kundrejt një rritjeje prej rreth 35.7% në vitin 2008. Vlerësohet që kredia në lekë është rritur me rreth 23%, ndërsa kredia në valutë është rritur me rreth 9%. Sidoqoftë, në terma realë, rritja e kreditimit në valutë ka qenë negative.

c) *nënçmimi i kursit të këmbimit të monedhës kombëtare gjatë vitit 2009, vlerësohet se ka ndodhur me një ritëm dhe madhësi të përballueshme,* duke i lejuar sektorit bankar dhe agjentëve të tjerë ekonomikë kohën e nevojshme për ndërmarrjen e veprimeve të përshtatshme dhe mbrojtëse. Pritshmëritë për një qëndrueshmëri të kursit të këmbimit gjatë vitit 2010 janë më të mëdha. Megjithatë, lëvizjet në kursin e këmbimit në kushtet e një regjimi fleksibël janë normale dhe duhet të jenë një fenomen i pritshëm nga ana e agjentëve ekonomikë, për të cilin ata duhet të jenë të përgatitur.

d) *qëndrueshmëria e infrastrukturës teknike thelbësore të sistemit financiar dhe veçanërisht të sektorit bankar, siç janë sistemet e pagesave*. Në këtë kuadër, vlerësohet se sistemet e pagesave që administrohen nga Banka e Shqipërisë, kanë funksionuar mirë dhe kanë patur një mbikëqyrje të përshtatshme nga Banka e Shqipërisë. Për funksionimin normal dhe mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave, si në vlera të mëdha ashtu edhe në vlera të vogla, Banka e Shqipërisë ka caktuar burimet e nevojshme njerëzore, financiare dhe teknologjike, si edhe ka punuar për përmirësimin e kuadrit rregullativ që përmirëson eficiencën dhe sigurinë e sistemeve të pagesave. Gjithashtu, do të vlerësohen rregullisht nevojat për përmirësim të procedurave dhe të infrastrukturës teknologjike, për të mbështetur funksionimin normal të këtyre sistemeve në të ardhmen, në kushtet e rritjes së vëllimit të transaksioneve.

Burimet kryesore të rrezikut lidhen kryesisht me situatën makroekonomike në vend dhe me gjendjen e brendshme të disa treguesve të veprimtarisë bankare. Më konkretisht:

Në përgjithësi, zhvillimet ekonomike do të ushtrojnë presion mbi situatën financiare të sipërmarrjeve të biznesit dhe të familjeve, të paktën në gjashtë muajt e parë të vitit 2010. Përmirësimet në ekonominë ndërkombëtare pritet të zbusin efektin ngadalësues mbi rritjen ekonomike në vend, të pakësimit të pritshëm dhe të nevojshëm të stimulit fiskal. Megjithatë, ky ndikim pozitiv pritet të bëhet më i ndjeshëm në gjysmën e dytë të vitit 2010, pas vendosjes në një gjendje më të stabilizuar të ekonomisë greke, si edhe pas ndikimit sezonal të turizmit. Përmirësimi i ekonomisë ndërkombëtare do të përmirësojë pozicionin e ekonomisë së vendit në raport me atë ndërkombëtare dhe do të ndikojë pozitivisht në madhësinë e deficitit të llogarisë korrente. Sidoqoftë, ky efekt pritet të jetë më i ndjeshëm në një periudhë afatmesme. Gjendja financiare e sektorit real të ekonomisë së vendit, e sipërmarrjeve të biznesit dhe e familjeve, pritet të jetë përgjithësisht e pandryshuar, dhe një përmirësim i saj vlerësohet se mund të ndodhë në gjashtëmujorin e dytë të vitit. Kjo do të thotë që veprimtaria e kreditimit të sektorit bankar do të vazhdojë të ndeshet me një mjedis sfidues dhe përmirësimet e synuara në cilësinë e kredisë do të kërkojnë më tepër kohë për t'u realizuar.

Sektori bankar duhet të synojë një rigjallërim gradual të kreditimit, duke kontrolluar cilësinë e kredisë. Rigjallërimi i kreditimit është një zhvillim i dëshiruar, por kjo duhet të realizohet mbi bazën e një analize të kujdesshme, duke ndjekur me vëmendje ecurinë e cilësisë së kreditimit. Vlerësohet që përkeqësimi i cilësisë së kredisë do të shënojë vlerën më të lartë në gjashtëmujorin e parë të vitit 2010 dhe do të stabilizohet në gjysmën e dytë të tij. Një përmirësim gradual por i qëndrueshëm i këtij treguesi, pritet të shfaqet në vitin 2011. Megjithatë, këto parashikime në nivel të përgjithshëm, mbështeten në domosdoshmërinë e ndjekjes me vëmendje të situatës në bankat individuale, të cilat mund të shfaqin zhvillime të ndryshme nga mesatarja e sektorit. Duke patur parasysh këtë element dhe në terma më praktikë, është e nevojshme që për kreditë ekzistuese bankat të reflektojnë plotësisht madhësinë e kredive me probleme dhe të krijojnë rezervat përkatëse për rrezikun e humbjeve nga kreditë. Në portofolin e kredive me probleme, bankat duhet të identifikojnë klientët me probleme të përkohshme dhe të kapërcyeshme, dhe të ndërtojnë për ta politika që ofrojnë mbështetje në këmbim të shtimit të elementëve që mbrojnë bankën prej rrezikut të këtyre kredive në të ardhmen. Për klientët që i vlerësojnë me një mundësi të ulët të pagesës së detyrimit të kredisë, bankat duhet të ndjekin vendosmërisht procedurat ligjore për ekzekutimin e garancive dhe të formave të tjera të kolateraleve, për rikuperimin e një vlere sa më të madhe të kredisë. E gjithë vendimmarrja në këtë proces duhet të jetë e qartë dhe e dokumentuar, dhe duhet të ketë si bazë analizën e strukturave të specializuara të Bankës. Për kreditë e reja, nisur nga përvoja e bankave me problemet e shfaqura në portofolin e kredisë dhe arsyet përkatëse, është e domosdoshme të ketë një shpërndarje më të mirë sektoriale dhe një ekuilibër më të arsyeshëm midis projekteve publike dhe private, midis klientëve që përfaqësojnë sipërmarrje biznesi apo familje, midis formave të dhënies së kredisë në lekë ose në valutë etj., duke e orientuar kreditimin në mënyrë që të zvogëlohet ekspozimi ndaj formave më problematike dhe të ulet përqendrimi i kreditimit në përgjithësi. Duke vlerësuar para së gjithash mundësinë e pagesës së kredisë nga ana e

kredimarrësve dhe sigurinë e kreditimit, Banka e Shqipërisë gjykon që ekzistojnë mjaft hapësira për bankat tregtare, që në varësi të madhësisë së aktiveve dhe mundësive që kanë, të mbështesin më shumë kreditimin e sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe të ofrojnë mundësi më të mëdha financimi në lekë. Ecuria e cilësisë së portofolit të kredisë do të vazhdojë të ushtrojë presion mbi rezultatin financiar të bankave. Në këtë kuadër, merr rëndësi edhe ndjekja me kujdes e vlerave të kapitalizimit të veprimtarisë bankare, pavarësisht niveleve të tij aktualisht të mjaftueshme.

Sektori bankar vijon të mbetet i ndjeshëm ndaj lëvizjeve me luhatshmëri të lartë të kursit të këmbimit *veçanërisht për ndikimin që këto përcjellin në cilësinë e portofolit të kredisë, i cili dominohet prej kredisë në valutë*. Në këtë rast, zgjidhja më e mirë do të ofrohej nga zbatimi i politikave më të ekuilibruara të kreditimit të cilat synojnë rritjen e peshës së kredisë në lekë. Përsa i takon pozicionit valutor në bilanc, sektori bankar, si edhe më parë, vazhdon të evidentojë një pozicion të hapur neto në vlera të ulëta, duke kufizuar ndjeshëm madhësinë e humbjeve të mundshme.

Në një kuadër më të gjerë, përvoja e vendeve të tjera për ngjarjet e zhvilluara në vitet 2008 dhe 2009, duhet të nxisë autoritetet publike në vend për të përmirësuar kuadrin ligjor dhe procedural të veprimeve për administrimin e situatave që mund të cënojnë stabilitetin e sistemit financiar, sipas ndryshimeve që po përvijohen nga organizmat ndërkombëtarë që vendosin standardet në këtë drejtim. Është e rëndësishme që ky proces të jetë i harmonizuar mes autoriteteve publike, duke respektuar peshën e segmenteve të caktuara të sistemit financiar.

Në përfundim, vlerësohet që gjendja e sistemit financiar dhe e sektorit bankar, paraqitet e përmirësuar në krahasim me fundin e vitit 2008, përsa i takon administrimit të veprimtarisë në afat të shkurtër. Në një afat më të gjatë, sektori bankar duhet t'i kushtojë vëmendje trajtimit të problemeve që janë shfaqur në cilësinë e portofolit të kredisë. Pavarësisht këtyre zhvillimeve, analizat *stress-test* dhe skenarët e ndryshëm të zhvillimit të disa treguesve të rëndësishëm makroekonomikë dhe financiarë, tregojnë për një qëndrueshmëri të mirë të sektorit bankar.

2 ZHVILLIMET NË MJEDISIN E JASHTËM

2.1 ZHVILLIMET E PËRGJITHSHME EKONOMIKE NË BOTË

Pas krizës së thellë ekonomike që përfshiu botën gjatë vitit 2008 dhe u shtri deri në tremujorin e parë të vitit 2009, ekonomia globale duket se ka hyrë gradualisht në rrugën e rikuperimit. *Politikat e jashtëzakonshme monetare, fiskale e financiare* të iniciuara që në vjeshtën e vitit 2008, u intensifikuan gjatë vitit 2009 dhe luajtën një rol vendimtar në uljen e tensioneve në tregjet financiare dhe zbutjen e efekteve të krizës në sektorët realë të ekonomisë. Stabilizimi i tregjeve financiare ishte më i shpejtë nga sa pritej, veçanërisht në gjysmën e dytë të vitit, por shumica e parametrave mbeti gjithsesi larg niveleve të parakrizës duke reflektuar shkallën ende të lartë të pasigurisë. Ecuria pozitive e sektorit financiar ndikoi ecurinë e sektorit real, por rikuperimi i këtij të fundit ishte disi më i ngadaltë. Në terma vjetorë, aktiviteti ekonomik global u tkurr me 0.8% gjatë vitit 2009, por pritet që të rritet me 3.9% gjatë vitit 2010 (FMN - parashikimi i janarit 2010). *Vendet e zhvilluara*, të cilat u goditën dhe më shumë nga kriza globale, shënuan rënie totale ekonomike prej 3.2% gjatë 2009-ës por shfaqën shenja stabilizimi në 6-mujorin e dytë të vitit nën ndikimin e politikave të gjera fiskale. Rikuperimi i tyre pritet të jetë i ngadaltë dhe niveli i prodhimit do të mbetet poshtë standardeve historike deri në vitin 2011. Për një pjesë të këtyre vendeve, normat e larta të papunësisë dhe borxhit publik, në kushtet kur tregjet financiare nuk janë kthyer ende në gjendje plotësisht normale funksionimi, pritet të sjellin sfida të forta gjatë vitit në vazhdim. Grupi i *vendeve në zhvillim,* ka mbajtur peshën kryesore të aktivitetit ekonomik global, me një rritje mesatare totale prej 2.1% gjatë vitit 2009, ku kanë dominuar Kina (8.7%) dhe India (5.6%)[3]. Rritja e flukseve hyrëse të kapitalit dhe rritja e çmimit të lëndëve të para, pritet të ndikojnë në një rikuperim të shpejtë të tyre, por me diferenca të mëdha brenda grupit. FMN ka parashikuar një rritje prej 6% të prodhimit total të vendeve në zhvillim gjatë vitit 2010, ku do të vazhdojë të kryesojë rajoni i vendeve në zhvillim të Azisë (rritje 8.4% gjatë vitit 2010). Një ecuri e mirë pritet dhe për rajonin e Amerikës Latine gjatë vitit në vazhdim (rritje mbi 4%), ndërkohë që rikuperimi parashikohet të jetë i ngadaltë për vendet në zhvillim të Evropës (rritje 2%).

Me gjithë ecurinë e përgjithshme pozitive, një *sërë rreziqesh* do të vazhdojnë të jenë të pranishme në mjedisin makroekonomik botëror gjatë vitit në vazhdim. *Së pari*, tërheqja e parakohshme e politikave mbështetëse makroekonomike konsiderohet një nga rreziqet kryesore që mund të dëmtojë rritjen e ardhshme globale dhe rivendosjen e ekuilibrave. *Së dyti*, rikuperimi ekonomik i vendeve të zhvilluara mund të jetë më i ngadaltë nga sa pritet, duke rrezikuar frenimin e rritjes ekonomike të pjesës tjetër të botës. *Së treti*, rritja e shpejtë e deficiteve buxhetore dhe e borxheve publike në mbarë botën, si rezultat i implementimit të politikave fiskale stimuluese gjatë vitit 2009, mund të sjellë destabilitet të tregjeve financiare dhe rritje të kostove të huamarrjes për sektorin privat, duke ulur në këtë mënyrë ritmet e rikuperimit.

Ekonomia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës vazhdoi të përjetojë efektet e krizës ekonomike gjatë gjysmës së parë të vitit 2009, me rënie të mëtejshme

të prodhimit dhe rritje të papunësisë në nivele që nuk ishin parë që prej viteve '80. Ndërhyrjet e jashtëzakonshme dhe të vazhdueshme të Rezervës Federale dhe Qeverisë Amerikane, me anë të politikave stimuluese monetare e fiskale, rezultuan në stabilizimin e tregut financiar e atij të pasurive të paluajtshme, dhe në nxitjen e kërkesës dhe konsumit gjatë gjysmës së dytë të vitit. Sipas të dhënave të BEA[4] , PBB-ja reale e SHBA-së u rrit me -2.4% në total gjatë vitit 2009 (0.4% në vitin 2008), duke reflektuar rënien në investime, në eksporte dhe në konsumin privat. Nga ana tjetër, rritja e PBB-së rezultoi pozitive në tremujorin e tretë dhe të katërt të vitit 2009 (respektivisht 2.2 dhe 5.9%), çka tregon se ekonomia e SHBA-së ka hyrë tashmë në rrugën e rikuperimit. Sipas FMN-së, pavarësisht ecurisë pozitive të sektorit financiar dhe atij real gjatë muajve të fundit të vitit, ndikimi i disa faktorëve si papunësia e lartë, niveli i ulët i konsumit dhe investimeve, ritmet e ulëta të shkëmbimeve tregtare etj., do të bëjnë që rritja ekonomike e SHBA-së të jetë modeste në nivelin 2.7%.

Në sferën e jashtme, deficiti i llogarisë korrente vlerësohet të jetë zvogëluar me 2.3 pikë përqindje nga viti 2008 në vitin 2009, duke reflektuar kryesisht dobësimin e konsumit privat në SHBA. Norma e papunësisë ka vazhduar të mbetet në nivele të larta. Tregu i pasurive të paluajtshme në SHBA ka dhënë sinjale stabilizimi gjatë muajve të fundit të vitit dhe rënia e çmimit të shtëpive u ndërpre në korrik 2009. Nga ana tjetër, situata financiare e sektorit të korporatave ka vazhduar të mbetet e vështirë dhe norma e falimentimit ka mbetur e lartë, ndërkohë që kushtet e financimit nga sektori bankar kanë qenë të shtrënguara. Kjo është balancuar disi nga një rritje e emetimit të borxhit dhe të aksioneve të reja në tregjet financiare, duke filluar që nga tremujori i dytë i vitit 2009. Inflacioni ka rezultuar negativ gjatë tre 3-mujorëve të parë të vitit 2009 dhe ka regjistruar një rritje modeste prej 1.4% në tremujorin e fundit.

Tabelë 1. Ecuria e disa treguesve kryesorë makroekonomikë të SHBA 2007-2009 dhe parashikimi për vitin 2010.

	2007	2008	2009	2010*
Rritja reale e PBB-së (në% vjetore)	2.1	0.4	-2.4	2.7
Norma vjetore e inflacionit (në%)	2.9	3.8	-0.3	1.7
Norma vjetore e papunësisë (në%)	4.6	5.8	9.3	10.1
Deficiti i llogarisë korrente	5.2	4.9	2.6	2.2
Deficiti buxhetor (në% ndaj PBB-së)	-2.8	-5.9	-12.5	-10.0
Borxhi bruto i qeverisë (në% ndaj PBB-së)	61.9	70.4	84.8	93.6

Burimi: FMN, raporti 'Parashikimi Ekonomik Botëror', tetor 2009; FMN, përditësim – 'Parashikimi Ekonomik Botëror', janar 2010; BEA (Bureau of Economic Analysis), shkurt 2010.

Një nga shqetësimet kryesore të tregjeve amerikane po bëhet thellimi i madh i deficitit buxhetor dhe rritja e shpejtë e borxhit shtetëror, si rezultat i masave fiskale stimuluese. Stabilizimi i këtyre treguesve, pritet të jetë një nga sfidat më të vështira për ekonominë amerikane në vitin në vazhdim.

Perspektiva ekonomike e rajonit të Evropës gjithashtu ka ardhur duke u përmirësuar gjatë vitit 2009, por me ritme më të ngadalta se ajo e SHBA-së dhe me diferenca të theksuara midis vendeve. *Vendet e zhvilluara* të Evropës, kanë vazhduar të përjetojnë rënie të prodhimit në terma vjetorë, veçanërisht në gjysmën e parë të vitit, si pasojë e kombinimit të rënies së kërkesës vendase, rënies së investimeve dhe tkurrjes së aktivitetit tregtar midis vendeve brenda

rajonit. Sipas Eurostat[5], rënia ekonomike e BE-së dhe Eurozonës, në total për vitin 2009, kanë qenë respektivisht 4.2% dhe 4.1%, por aktiviteti ka njohur rritje modeste pozitive në tremujorin e tretë (BE 0.3% dhe Eurozona 0.4%) dhe të katërt (BE 0.1% dhe Eurozona 0.1%), duke i dhënë fund recesionit më të gjatë në historinë e këtij rajoni. Ekonomitë eksportuese si Gjermania dhe Franca, të cilat u prekën veçanërisht nga rënia e kërkesës së jashtme gjatë krizës, filluan të rikuperohen me ritme më të shpejta falë rigjallërimit të tregtisë globale dhe rritjes së kërkesës nga rajonet në zhvillim.

Tabelë 2. Ecuria e treguesve kryesorë makroekonomikë në BE dhe Eurozonë.

	Rritja reale e PBB-së (në %)				Inflacioni (mesatare vjetore)				Bilanci i llogarisë korrente (në % ndaj PBB-së)			
	2007	2008	2009	2010*	2007	2008	2009	2010*	2007	2008	2009	2010*
Bashkimi Evropian	2.9	0.8	-4.1	0.7	2.3	3.7	1.0	1.4	-1.1	-2.0	-1.7	-1.5
Eurozonë	2.8	0.6	-4.0	0.7	2.1	3.3	0.3	1.1	0.1	-1.1	-1.0	-0.8
Gjermani	2.5	1.3	-4.8	1.2	2.3	2.8	0.2	0.7	7.9	6.6	4.0	3.8
Francë	2.3	0.4	-2.3	1.2	1.6	3.2	0.1	1.2	-2.3	-3.3	-2.3	-2.2
Itali	1.5	-1.0	-4.8	0.7	2.0	3.5	0.8	1.7	-1.8	-3.0	-2.4	-2.2
Greqi	4.0	2.9	-1.1	-0.3	3.0	4.2	1.3	1.4	-14.7	-13.8	-8.8	-7.9
Spanjë	3.6	0.9	-3.6	-0.6	2.8	4.1	-0.3	1.1	-10.0	-9.5	-5.4	-4.6
Jo-Eurozonë												
Mbretëri e Bashkuar	2.6	0.5	-4.8	0.6	2.3	3.6	2.2	2.4	-2.7	-1.6	-2.4	-1.6

Burimi: Eurostat database, Komisioni Evropian "Parashikimi Ekonomik Evropian", vjeshtë 2009; Komisioni Evropian, Parashikimi i Ndërmjetëm, shkurt 2010.

Masat monetare e fiskale të ndërmarra nga BE, Eurosistemi dhe autoritetet e vendeve të veçanta, si dhe rigjallërimi i aktivitetit tregtar, ishin faktorët kryesorë që sollën kthesën ekonomike të BE-së (dhe Eurozonës). Komisioni Evropian parashikon[6] që rritja ekonomike gjatë vitit 2010, si në BE dhe në Eurozonë do të jetë rreth 0.7%, ku do të kryesojnë Gjermania dhe Franca. Ndërkohë, vende të tjera si Greqia dhe Spanja do të vazhdojnë të përjetojnë kontraktim ekonomik. Ritmi i rikuperimit ekonomik në disa prej vendeve do të ndikohet nga presioni i vazhdueshëm i tregut të shtëpive, tensionet në sektorin bankar dhe ecuria e tregut të punës.

Niveli i *inflacionit* në BE dhe Eurozonë ka qenë veçanërisht i ulët gjatë gjithë vitit 2009, duke regjistruar dhe shifra negative në periudhën e verës, kryesisht për shkak të rënies së çmimit të produkteve ushqimore dhe energjisë, si dhe plogështisë së përgjithshme ekonomike. Situata në *tregun e punës* ka vazhduar të përkeqësohet pothuaj gjatë gjithë vitit 2009 dhe norma e papunësisë në muajin dhjetor 2009, arriti në mesatarisht 10% për Eurozonën dhe mesatarisht 9.6% për BE-në (Grafiku 1). Në disa vende si, Spanja, Irlanda dhe Sllovakia, normat e papunësisë arritën në vlera dyshifrore.

Grafik 1. Norma e papunësisë në BE dhe Eurozonë.



Burimi: Eurostat database, Eurostat News release, 1 mars 2010.

Komisioni Evropian ka parashikuar që papunësia në Evropë do të vazhdojë të rritet gjatë vitit 2010 dhe do të fillojë të bjerë disi në vitin 2011. Gjithsesi,

Grafik 2. Balanca buxhetore në BE dhe Eurozonë.



Burimi: BQE, Eurostat.

situata e punëzënies në Evropë do të varet shumë nga ecuria e aktivitetit ekonomik dhe shpejtësia e reflektimit në tregun e punës. Përkundrejt këtyre zhvillimeve, kërkesa konsumatore do të vazhdojë të jetë e ulët, çka do të ndikojë negativisht rritjen e vendeve të orientuara nga eksporti.

Në *vendet e zhvilluara* të Evropës, bankat qendrore ulën në mënyrë të konsiderueshme normat e interesit dhe morën një sërë masash jo tradicionale si blerjet e drejtpërdrejta të aktiveve (Banka e Anglisë) apo blerja e obligacioneve të mbuluara (BQE). Një sasi e madhe të ardhurash publike u përdorën nga këto vende për të mbështetur sektorin financiar, kryesisht përmes skemave të garancisë dhe injektimeve të kapitalit, ndërsa sektorin real përmes paketave fiskale stimuluese.

Grafik 3. Borxhi i qeverisë në BE dhe Eurozonë.



Burimi: Parashikime të BQE dhe Eurostat.

Si rrjedhojë, pozicionet fiskale u përkeqësuan ndjeshëm në të gjithë rajonin e BE-së (shih grafikun 2 dhe grafikun 3) dhe disa vende si Greqia, Irlanda dhe Spanja regjistruan deficite dyshifrore në raport me PBB-të përkatëse. Deficiti fiskal në total për Eurozonën u rrit nga 2.0% e PBB-së në vitin 2008 në 6.2% e PBB-së në 2009, ndërkohë që niveli i borxhit publik u rrit nga 69.4% e PBB-së në 2008 në 78.7% e PBB-së në 2009. Në përgjithësi, 14 nga 16 vende të Eurozonës regjistruan deficite fiskale mbi nivelin referencë prej 3% të PBB-së gjatë vitit 2009 dhe do t'i nënshtrohen procesit të konsolidimit fiskal gjatë dy viteve në vazhdim.

Greqia ka përjetuar përkeqësimin më të madh të bilancit fiskal në Eurozonë, ku deficiti buxhetor në vitin 2009 arriti në minimalisht 12.7% e PBB-së (7.7% në 2008), ndërsa borxhi publik arriti në nivelin 113.4% e PBB-së (99.2% e PBB-së në 2008), gjë që ka rritur rrezikun e destabilizimit financiar në vend dhe ka sjellë uljen e vlerësimit në tregjet financiare. Në bazë të rekomandimeve të Këshillit ECOFIN të mbledhur në 16 shkurt 2010 për këtë çështje, Greqisë i është kërkuar të ndërmarrë një reformë gjithëpërfshirëse për të reduktuar deficitin buxhetor brenda nivelit 3% të PBB-së deri në vitin 2012 (reduktim me 3.5 pikë përqindje gjatë viteve 2010, 2011 dhe të paktën 2.5 pikë përqindje për vitin 2012).

Përsa i përket *rajonit të Evropës Qendrore dhe Juglindore*, situata makroekonomike e tyre vazhdoi të përkeqësohej ndjeshëm deri në tremujorin e parë të vitit 2009. Shumë vende si Rumania, Bullgaria dhe vendet e Baltikut, përjetuan një rënie të shpejtë të eksporteve dhe të flukseve hyrëse të kapitalit, me pasojë rënie të ndjeshme të prodhimit. Kredidhënia ndaj sektorit privat

ra ndjeshëm pothuaj në të gjithë rajonin, duke krijuar një rreth vicioz midis dobësimit të aktivitetit ekonomik dhe rënies së cilësisë së aktiveve të sistemit bankar. Në muajt e parë të vitit 2009, çmimet e aksioneve të këtij rajoni vazhduan të bien, monedhat u dobësuan dhe *spread*-et e normave të interesit në tregjet e kapitalit vazhduan të rriten. Disa prej vendeve të Evropës Lindore si Hungaria, Lituania, Rumania, Serbia etj., kërkuan ndihmën e FMN–së për ekuilibrimin e bilancit të pagesave, ndërsa Polonia fitoi akses në Linjën e Kredisë Fleksibël të FMN-së.

Situata njohu përmirësim në gjashtëmujorin e dytë të vitit, pas vënies në zbatim të një sërë masash stimuluese nga bankat qendrore dhe qeveritë përkatëse. Ritmi i rënies ekonomike u ngadalësua dhe disa prej vendeve përjetuan rritje ekonomike në nivele modeste. Perceptimi ndaj riskut u moderua, por gjithsesi kredidhënia ndaj sektorit privat mbeti e dobët dhe norma e papunësisë në rritje gjatë gjithë vitit. Tensionet në tregjet financiare u lehtësuan, duke u reflektuar në rënien e normave të interesit dhe *spread*-eve në tregjet e kapitalit, por duke mbetur gjithsesi më lart se nivelet e para krizës. Presioni i krizës financiare çoi në zbutjen e zhbalancave makroekonomike në 6-mujorin e dytë të vitit. Kështu, deficitet e llogarisë korrente kanë rënë ndjeshëm dhe disa vende arritën të krijojnë suficite.

Tabelë 3. Ecuria e disa treguesve makroekonomikë në Evropën Qendrore e Lindore.

	Rritja reale e PBB-së (në%)				Inflacioni (mesatare vjetore)				Balanca e llogarisë korrente (në% ndaj PBB-së)			
	2007	2008	2009*	2010*	2007	2008	2009*	2010*	2007	2008	2009*	2010*
Evropa Qendrore dhe Juglindore		3.1	-4.3	2.0	6.0	8.1	4.8	4.2	-7.9	-8.0	-3.1	-3.9
Hungari	1.2	0.6	-6.7	-0.9	7.9	6.1	4.5	4.1	-6.5	-8.4	-2.9	-3.3
Poloni	6.8	4.9	1.0	2.2	2.5	4.2	3.4	2.6	-4.7	-5.5	-2.2	-3.1
Rajoni i Ballkanit												
Bullgari	6.2	6.0	-6.5	-2.5	7.6	12.0	2.7	1.6	-25.2	-25.5	-11.4	-8.3
Rumani	6.2	7.1	-8.5	0.5	4.8	7.8	5.5	3.6	-13.5	-12.4	-5.5	-5.6
FYROM	5.9	4.9	-2.0	1.5	2.2	8.3	-0.6	1.1	-7.2	-13.1	-9.6	-9.2
Vendet e Baltikut	8.9	-0.7	-17	-3.7	7.3	12.2	2.6	-2.5	-17.7	-11.4	2.3	2.6

Burimi: FMN- raporti 'Parashikimi Ekonomik Botëror' tetor 2009; FMN, përditësim – 'Parashikimi Ekonomik Botëror', janar 2010; KE- raporti "Parashikimi Ekonomik Evropian", vjeshtë 2009.

** Vlerësime të FMN dhe KE.*

Përsa i përket të ardhmes së rajonit të Evropës Lindore e Qendrore, FMN parashikon një rritje mesatare prej 2% gjatë vitit 2010 dhe 3.7% gjatë vitit 2011[7]. Ky tregues pritet të ketë ndryshime të theksuara midis vendeve, ku vendet e rajonit të Baltikut do të vazhdojnë të kontraktohen, gjë që do të balancohet nga një rritje e konsiderueshme e prodhimit në vende të tjera si Poloni dhe Turqi.

Me gjithë sinjalet pozitive, mjedisi pritet të mbetet sfidues për shumicën e vendeve të këtij rajoni, duke paraqitur një sërë rreziqesh për rritjen ekonomike dhe stabilitetin financiar. Sipas raportit të BQE-së, papunësia, rënia e të ardhurave dhe falimentimet në sektorin privat do të mbeten të larta edhe gjatë vitit në vazhdim, duke rritur rrezikun e përkeqësimit të portofolit të bankave dhe ngadalësimin e rritjes ekonomike. Një tjetër rrezik kryesor mbetet ekspozimi i

madh ndaj kursit të këmbimit që ka krijuar sektori privat (si familjet ashtu dhe firmat) si pasojë e huamarrjes të lartë në monedhë të huaj. Në të njëjtën kohë, niveli i borxhit të jashtëm dhe kostot e financimit të tij në këtë rajon mbeten mjaft të larta, ndërkohë që vazhdon të jetë prezent rreziku i daljes së kapitalit. Së fundi, duke mbajtur parasysh lidhjet e ngushta financiare dhe tregtare të këtij rajoni me vendet e BE-së, rikuperimi ekonomik i tyre do të varet shumë dhe nga stabilizimi ekonomik i vendeve të zhvilluara të Evropës.

2.2 ZHVILLIMET KRYESORE NË TREGJET FINANCIARE NË BOTË

Viti 2009 dhe veçanërisht gjysma e dytë e tij, u karakterizua nga një përmirësim i përgjithshëm i kushteve në tregjet financiare botërore. Ndërhyrja publike, normat shumë të ulëta të interesit dhe pritjet pozitive lidhur me rikuperimin e ekonomisë globale, nxitën përmirësimin e tregjeve dhe i dhanë një shtysë të re lëvizjes së flukseve të kapitalit. Fillimisht, stimuli kryesor u sigurua nga politikat publike të jashtëzakonshme të ndërmarra nga autoritetet monetare dhe qeveritë në mbarë botën që në fund të vitit 2008 e në vazhdim të vitit 2009. Këtu përfshiheshin: garancitë për mbulimin e depozitave të institucioneve financiare, injektimet e kapitalit, sigurimi i likuiditetit shtesë dhe mbështetja e tregjeve të kredisë. Në gjysmën e dytë të vitit, përmirësimi i parametrave makroekonomikë ndikoi pozitivisht në rindërtimin e besimit të humbur të investitorëve, gjë që u reflektua në zbutjen e normave të interesit dhe në rritjen e vëllimit të transaksioneve në shumicën e segmenteve të tregjeve të kapitalit.

Me gjithë frymën e përgjithshme optimiste, situata në disa segmente të tregjeve financiare vazhdon të mbetet e tensionuar dhe me varësi të lartë nga mbështetja publike. Kushtet e huamarrjes janë ende shumë të vështira për një pjesë të mirë të huamarrësve, veçanërisht për bizneset e mesme e të vogla dhe për konsumatorët. Tregjet e produkteve të strukturuara vazhdojnë të jenë të dëmtuara duke e vështirësuar rolin ndërmjetësues të institucioneve financiare, ndërsa funksionimi i tregjeve të kapitalit në segmentet e pakolateralizuara apo me cilësi të ulët, ka qenë i dobët dhe me kosto të lartë. Mjedisi financiar dhe ai makroekonomik global mbetet ende i vështirë dhe niveli i rrezikut i perceptuar nga publiku është ende i lartë, ndaj rikuperimi i plotë i tregjeve financiare do të kërkojë kohë.

Zhvillimet në tregjet e parasë. Aktiviteti në tregjet e parasë në sajë të mbështetjes së bankave qendrore erdhi duke u normalizuar, vëllimet e transaksioneve u rritën dhe normat e interesit filluan të bien gradualisht, duke u luhatur në disa raste në nivelet e parakrizës. Në SHBA, publikimi i rezultateve të *stress test*-it për bankat më të mëdha amerikane dhe vënia në zbatim e planit TARP (*Troubled Asset Relief Program*), ndihmoi në rindërtimin e besimit në sektorin bankar dhe sistemin financiar në përgjithësi. Në Evropë, masat ekzistuese të BQE-së u zgjeruan, duke vënë në zbatim 3 operacione të reja rifinancimi 1-vjeçar[8] dhe programin e blerjes së obligacioneve të mbuluara. Në të njëjtën kohë, bankat qendrore kryesisht në vendet e zhvilluara, ndoqën

një politikë monetare tepër ekspansioniste, me mbajtje të normave të interesit pranë zeros (grafiku 4).

Masat e lartpërmendura rezultuan të suksesshme në uljen graduale të rrezikut të kreditimit dhe të likuiditetit të bankave dhe lehtësimin e tensioneve në tregjet e parasë. Kjo u reflektua në rënien e ndjeshme të normave të interesit dhe në ngushtimin e *spread*-eve (grafiku 5). Kështu, në tregjet amerikane të parasë, *spread*-i midis normës së LIBOR-it tremujor dhe normës së OIS (*overnight index swap*), që përdoret gjerësisht si tregues i rrezikut të likuiditetit dhe kundërparti të bankave, u ul pothuaj në nivelet e parakrizës. Në kontrast me këtë, *spread*-et LIBOR/OIS për maturime më të gjata se 3 muaj, vazhduan të mbeten mbi nivelet historike, duke reflektuar ekzistencën e tensioneve në segmentet më afatgjata. Në tregjet e Eurozonës, *spread*-i EURIBOR/OIS vazhdoi të ngushtohej pothuaj në të gjithë spektrin e maturimeve, duke iu afruar gradualisht niveleve të parakrizës. Gjithsesi, në muajt e fundit të vitit 2009, ritmi i rënies së *spread*-eve u moderua, ndikuar dhe nga njoftimet për fillimin e daljes nga programet e ndihmës nga BQE. Mbyllja e këtyre programeve në mbarë botën, pritet të jetë një test i fortë për qëndrueshmërinë e tregjeve dhe mund të reflektohet në rritje të normave të interesit në tregjet e parasë.

Grafik 4. Normat bazë të interesit në vendet e zhvilluara.



Burimi: BQE, Rezerva Federale, Banka e Japonisë.

Grafik 5. Normat e tregut të parasë.



Burimi: BQE, Eurostat.

Zhvillimet në tregjet e kapitalit. Këto tregje, gjithashtu u rigjallëruan në gjashtëmujorin e dytë të vitit, gjë që u reflektua në rritjen e vëllimit të emetimeve të reja në tregjet primare, rënien e normave të interesit, rihapjen e tregjeve të titujve të pakolateralizuar etj. Tregjet e obligacioneve qeveritare kanë përjetuar një rënie të përgjithshme të *yield*-eve gjatë vitit 2009, por duke ruajtur luhatshmëri të lartë midis titujve qeveritarë të vendeve të ndryshme. Tregu amerikan i obligacioneve qeveritare, pavarësisht blerjeve në sasi të mëdha nga Rezerva Federale, ka ndjerë një rënie të kërkesës në gjysmën e dytë të vitit. Kjo ka ardhur për shkak të largimit të investitorëve nga letrat e sigurta drejt atyre më fitimprurëse, si rrjedhojë e rritjes së besimit në tregjet financiare, përmirësimit të pritjeve ekonomike dhe rritjes së shqetësimeve mbi zgjerimin e borxhit të qeverisë. Në tregjet e Eurozonës, *yield*-et e obligacioneve qeveritare afatgjata kanë ardhur përgjithësisht duke rënë, si rezultat i pritjeve pozitive mbi ecurinë e aktivitetit ekonomik dhe rritjes së kërkesës së investitorëve. Gjithsesi, ritmi i rënies së *yield*-eve dhe *spread*-eve brenda grupit ka qenë i ndryshëm, duke reflektuar perceptimet e ndryshme të tregut mbi situatën makroekonomike dhe veçanërisht atë fiskale të vendeve të Eurozonës. Për këtë arsye, normat e

interesit të titujve qeveritarë të vendeve të prekura më shumë nga kriza, kanë vazhduar të mbeten të larta.

Në tregjet e aksioneve në mbarë botën, pasojat e krizës financiare u shtrinë deri në tremujorin e parë të vitit 2009, duke reflektuar ecurinë e dobët makroekonomike të vendeve të zhvilluara dhe shqetësimet lidhur me ekspozimet e sektorit financiar. Situata filloi të ndryshojë pozitivisht pas muajit mars 2009 dhe veçanërisht në gjysmën e dytë të vitit, si rezultat i kombinimit të rritjes së aktivitetit ekonomik, përmirësimit të pritjeve dhe zbutjes së rreziqeve të perceptuara.

Grafik 6. Indekset kryesore të tregut të aksioneve.

(norma vjetore e ndryshimit)



Burimi: BQE, Eurostat database.

Grafik 7. *Spread*-i i obligacioneve të korporatave AAA dhe BB.



Burimi: FMN- raporti 'Parashikimi Ekonomik Botëror', tetor 2009.

Në tregjet amerikane, pavarësisht rritjes së çmimit të aksioneve pothuaj në të gjithë sektorët e ekonomisë, mbizotëroi rritja e aksioneve të sektorit financiar. E njëjta tendencë u vu re dhe në tregjet evropiane të aksioneve, ku në fund të muajit nëntor 2009, norma çmim/fitim për shumicën e aksioneve standarde të Eurozonës u rrit ndjeshëm, ndërkohë që për kompanitë financiare në disa raste i tejkaloi vlerat historike. Rritja e fitimeve në këto tregje çoi në një përmirësim të shpejtë të të gjithë indekseve (grafiku 6), por ecuria e tyre sugjeron se pasiguria në tregjet e aksioneve edhe pse është ulur ndjeshëm, vazhdon të mbetet mbi nivelet e parakrizës.

Pavarësisht ecurisë së mirë, investitorët vazhdojnë të jenë tepër të ndjeshëm ndaj çdo sinjali negativ, gjë që u bë evidente në reagimin e menjëhershëm dhe negativ të tregjeve të aksioneve, pas problemeve financiare të Dubai World në nëntor 2009. Përsa i përket të ardhmes, shqetësimi më i madh për tregjet e aksioneve veçanërisht në SHBA dhe në Evropë, është rreziku i përmbysjes së ecurisë pozitive në momentin e tërheqjes së politikave mbështetëse nga autoritetet apo një rikuperim më i ngadaltë nga sa pritet. Në të dyja rastet, ecuria e aktivitetit dhe për pasojë fitimet e sektorit privat do të dëmtoheshin, me pasojë një valë të re rënieje të çmimit të aksioneve.

Edhe për *tregjet globale të kredisë,* kushtet vazhduan të ishin të vështira në muajt e parë të vitit 2009, për shkak të përkeqësimit të mëtejshëm të portofolit të institucioneve financiare dhe pritjeve të atëhershme negative të aktivitetit ekonomik. Deri në mars 2009, këto tregje vazhduan të përjetojnë luhatshmëri të lartë dhe norma vazhdimisht në rritje, për të marrë më pas një kthesë pozitive që kulmoi në tremujorin e tretë dhe të katërt të vitit. Rimëkëmbja e çmimeve në tregjet e aksioneve, shenjat e stabilizimit të sistemit

financiar dhe masat e marra nga autoritetet e vendeve të zhvilluara për të nxitur aktivitetin në tregjet e kredisë[9], sollën përmirësimin e përgjithshëm të sentimentit të tregut. Kjo u reflektua në rënien e normave të interesit të titujve të borxhit dhe ngushtimin e *spread*-eve të kredisë, fillimisht për kompanitë financiare e më pas dhe për ato jofinanciare. Vëllimet e emetimit të kapitalit të ri u rritën ndjeshëm në gjysmën e dytë të vitit, krahasuar me vitin e kaluar, por mbetën gjithsesi nën nivelet e parakrizës. Në tregjet amerikane të kredisë, kushtet u përmirësuan ndjeshëm në segmentin e obligacioneve të korporatave duke reflektuar pritjet pozitive ekonomike të SHBA-së dhe rritjen e interesit të investitorëve për tituj fitimprurës. Edhe në tregjet e kapitalit të Eurozonës, emetimi i obligacioneve të korporatave njohu një rritje të konsiderueshme dhe shumë kompani arritën të zëvendësojnë huamarrjen nga bankat me huamarrjen nga tregjet financiare. Me gjithë ecurinë e përgjithshme pozitive të tregjeve të kapitalit, aktiviteti në segmentet e produkteve të strukturuara dhe titujve sigurues, ka vazhduar të mbetet i dobët dhe me varësi të lartë nga mbështetja e bankave qendrore. Kjo ka ardhur si pasojë e kërkesës së ulët dhe nivelit të lartë të pasigurisë së këtyre produkteve.

Tregjet e vendeve në zhvillim. Ecuria e mirë ekonomike e vendeve në zhvillim, veçanërisht në gjysmën e dytë të vitit 2009 dhe rënia e përgjithshme e rreziqeve të perceptuara, nxitën rigjallërimin e flukseve hyrëse të kapitalit drejt tregjeve në zhvillim. Kjo solli rritje të konsiderueshme të çmimeve në tregjet e aksioneve, rritje të aktivitetit të emetimit dhe rënie të interesave në tregjet e kapitalit. Ecuria e tregjeve të aksioneve dhe të kapitalit në vendet në zhvillim e tejkaloi ecurinë e tregjeve të maturuara.

Nga ana tjetër, flukset e larta të kapitalit dhe shpejtësia e rikuperimit, veçanërisht në rajonin e Azisë, ka ngritur shqetësimet mbi qëndrueshmërinë e rritjes së këtyre tregjeve dhe rrezikun e fryrjes artificiale të vlerës së aktiveve. Një tjetër rrezik është që rikuperimi i çmimit të aktiveve në tregjet në zhvillim, mund të ecë në drejtimin e kundërt, në rast se aktiviteti ekonomik global do të ngadalësohej në momentin e tërheqjes së stimujve monetarë e fiskalë, çka do të rriste pasigurinë dhe mund të nxisë një valë të re lëvizjeje të kapitalit.

Grafik 8. Indekset e çmimit të lëndëve të para.



Burimi: FMN database.

TREGJET E LËNDËVE TË PARA

Përsa i përket tregjeve të lëndëve të para, pas rënies së theksuar të çmimeve në gjysmën e dytë të vitit 2008, ato filluan të stabilizohen disi që në fillim të vitit 2009 dhe njohën rritje modeste pas tremujorit të dytë. Kjo erdhi kryesisht për shkak të rigjallërimit të aktivitetit ekonomik në rajonet në zhvillim dhe falë përmirësimit të kushteve në tregjet financiare globale.

Çmimi i naftës në tregjet ndërkombëtare ka qenë i luhatshëm gjatë vitit 2009, ku çmimi mesatar për

fuçi arriti vlerën 61 dollarë ose 38.7% më i ulët se çmimi mesatar vjetor një vit më parë. Kjo erdhi si pasojë e dobësimit të kërkesës agregate dhe rënies së aktivitetit prodhues në vendet e industrializuara. Nga ana tjetër, vlerësimi i dollarit amerikan kundrejt disa monedhave kryesore gjatë vitit 2009 dhe politikat e prodhimit të OPEC-ut ndikuan në drejtimin rritës të çmimit të naftës në tregjet ndërkombëtare.

Përsa i përket të ardhmes, çmimet e lëndëve të para pritet të rriten ende, të nxitura nga forcimi i kërkesës globale, dhe veçanërisht nga grupi i vendeve në zhvillim. Gjithsesi, ky presion pritet të jetë modest për shkak të nivelit të lartë ekzistues të inventarëve dhe kapaciteteve të lira në shumë sektorë të lëndëve të para.

Hapësirë informuese 1. Shkurtimisht mbi gjendjen financiare të grupeve të huaja bankare të pranishme në vendin tonë[10].

1. RAIFFEISEN INTERNATIONAL (AUSTRI)
Në fund të muajit dhjetor '09, totali i aktiveve për Raiffeisen International Bank prej 76.3 miliardë euro evidentoi rënie me 10.7% në krahasim me fundvitin 2008. Depozitat e klientëve, prej 42.6 miliardë euro llogariten 3.7% më pak kundrejt fundit të 2008-ës, ndërsa kreditë për klientët me një rënie prej 12.8%, duke shënuar nivelin 50.5 miliardë euro. Në fund të muajit shtator 2009, në Evropën Juglindore, kreditë me probleme arritën në 5.7% të portofolit, në rritje me 4 pikë përqindje dhe përbënin nivelin më të ulët krahasuar me të gjitha rajonet e tjera.

Fitimi neto i konsoliduar për Raiffeisen International, në fund të vitit 2009, ishte 212 milionë euro, në rënie me 78.4% kundrejt shifrës për të njëjtën periudhë, një vit më parë. Shpenzimet për provigjone arritën në 1 738 milionë euro, duke shfaqur rritje prej 122.8% kundrejt së njëjtës periudhë të vitit 2008. Provigjonet e larta dhanë ndikimin e tyre negativ, përmes rezultatit neto, tek treguesit e rentabilitetit. Në fund të vitit 2009, kthimi nga kapitali aksioner (përpara taksave) arriti në 5.7%, në rënie me 16.3 pikë përqindje kundrejt vitit 2008.

Në fund të vitit 2009, Banka Raiffeisen në Shqipëri përbënte 2.4% të totalit të aktiveve të Raiffeisen International.

2. INTESA SANPAOLO (ITALI)
Intesa Sanpaolo, Itali, regjistroi një total aktiviteti prej 624.8 miliardë eurosh në fund të vitit 2009, ose 1.8% më pak se në fundvitin 2008. Kreditë për klientët u pakësuan me 5.2% kundrejt fundit të 2008-ës, duke shkuar në nivelin 374 miliardë euro, ndërsa depozitat arritën në rreth 421.9 miliardë euro, në rënie me 0.2% në krahasim me fundin e vitit 2008. Intesa Sanpaolo Itali e mbylli vitin 2009 me një fitim neto prej 2 805 milionë eurosh, në rritje me rreth 9.9% në krahasim me rezultatin e vitit të kaluar. Ndërkohë, provigjonet dhe shpenzimet për zhvlerësime arritën në 4 238 milionë euro për vitin 2009, në rritje me rreth 11% nga shifra prej 3 833 milionë eurosh e vitit 2008. Gjithsesi, kthimi nga kapitali aksioner llogaritet rreth 5.2% për vitin 2009, pothuaj në të njëjtën vlerë sikurse në vitin 2008 (prej 5.1%).*

Në fund të vitit 2009, Intesa Sanpaolo Bank Shqipëri përbënte rreth 0.1% të totalit të aktiveve të grupit Intesa Sanpaolo.

** Shumatori i kapitalit të paguar, rezervave, rezervave të rivlerësimit dhe rezultatit neto të periudhës.*

3. BANKA ALFA (GREQI)
Në fund të vitit 2009, Banka Alfa (Greqi) arriti një total aktivesh prej rreth 69.6 miliardë eurosh ose 6.6% më shumë krahasuar me një vit më parë. Ndërkohë, totali i depozitave ishte 42.9 miliardë euro, me një rritje vjetore prej 0.9%. Në Greqi, depozitat (36 miliardë euro) shfaqën qëndrueshmëri krahasuar me dhjetorin 2008, kurse në Evropën Juglindore baza e depozitave u rrit me 3.7% ndaj një viti më parë, në nivelin 6.3 miliardë euro. Për gjithë vitin 2009, humbjet nga kreditë e fshira ishin 676.3 milionë euro, rreth 163 milionë nga të cilat në Evropën Juglindore (në rritje me 81% krahasuar me shifrën e vitit 2008). Raporti i kredive me probleme u rrit me 50 pikë bazë në tremujorin e katërt 2009, duke arritur në 5.7% në fund të dhjetorit 2009, ndërsa raporti i kredive me probleme për Evropën Juglindore arriti në 4.1%, me një rritje prej 60 pikësh bazë vetëm për tremujorin e fundit të vitit 2009.

Në fund të vitit 2009, Banka Alfa raportoi një fitim neto prej 349.8 milionë eurosh, në rënie me rreth 32% kundrejt vitit 2008, për shkak të ngadalësimit të aktivitetit ekonomik në Greqi dhe në Evropën Juglindore. Të ardhurat neto nga interesi arritën në 1 762,6 milionë euro, me një rënie vjetore 2%. Megjithatë, të ardhurat neto nga interesi për tremujorin e fundit arritën në 458 milionë euro dhe ishin përgjithësisht të pandryshuara krahasuar me tremujorin e tretë.

Shpenzimet e veprimtarisë u rritën me 2% në nivelin 1 201.9 milionë euro, vlerë që i përgjigjet një raporti "shpenzime/të ardhura" prej 50.5% për vitin 2009.

Në fund të vitit 2009, Banka Alfa, Shqipëri përbënte rreth 0.7% të totalit të aktiveve të Bankës Alfa (Greqi).

4. PIRAEUS BANK (GREQI)
Në fund të vitit 2009, totali i aktiveve për Piraeus Bank Greqi ishte 54.3 miliardë euro, në rënie me 1% krahasuar me të njëjtën periudhë një vit më parë. Fitimi neto në vitin 2009 arriti në 235 milionë euro, 25% më i ulët sesa një vit më parë, për shkak të rritjes së konsiderueshme të provigjoneve. Marzhi neto i interesave mbi aktivet mesatare që sjellin të ardhura, ishte 2.6% për vitin 2009, krahasuar me 3.0% në vitin 2008 për shkak të tkurrjes që erdhi si pasojë e kostos së rritur të depozitave, faktor veçanërisht i ndjeshëm gjatë gjithë vitit 2009. Shpenzimet e veprimtarisë mbetën në nivelin e së njëjtës periudhë të vitit të mëparshëm (893 milionë euro, kundrejt 897 milionë euro të fundvitit 2008), megjithë rritjen e numrit mesatar të degëve. Raporti "shpenzime/të ardhura" ishte në nivelin 54% gjatë vitit 2009, nivel i përafërt me atë të vitit paraardhës. Ndërkohë, kthimi nga kapitali aksioner (përpara taksave) u llogarit 7.9% për vitin 2009, në rënie me 271 pikë bazë kundrejt vitit 2008.

Në fund të vitit 2009, Banka Tirana përbënte rreth 1.1% të totalit të aktiveve të grupit Piraeus Bank.

5. BANKA KOMBËTARE E GREQISË (GREQI)
Në fund të vitit 2009, totali i aktiveve të grupit të BKG regjistroi vlerën prej 113.4 miliardë eurosh. Fitimi neto prej 971 milionë eurosh për vitin 2009, u llogarit 37% më i ulët se shifra e një viti më parë. Rreth 59% e fitimit të grupit në tremujorin e tretë erdhi nga filialet e huaja. Fitimi neto i njësive të Evropës Juglindore gjatë vitit 2009 arriti në 93 milionë euro, në rënie me rreth 51% kundrejt shifrës së vitit 2008 (190

milionë euro). Fitimi neto nga aktiviteti në Greqi ishte rreth 398 milionë euro, me një rënie vjetore prej 57%. Kjo rënie ka ardhur si pasojë e provigjoneve thuajse të dyfishuara, të cilat në vitin 2009 arritën në 618 milionë euro, kundrejt 322 milionë euro në vitin 2008. Si rezultat i politikës provigjonuese, fondet e provigjonimit të grupit janë rreth 2.5 miliardë euro, ose 3.4% e kredidhënies së tij agregate, duke mbuluar 64% të kredive me probleme, pa llogaritur kolateralin. Burimet kryesore të të ardhurave të grupit u rritën me 6%, kryesisht në sajë të forcimit të të ardhurave nga interesat (+5% në bazë tremujore dhe +10% në bazë vjetore). Marzhi i interesave u rrit në bazë tremujore, duke e mbajtur marzhin vjetor në mbi 4%.

Në fund të vitit 2009, BKG në Shqipëri përbënte 0.3% të totalit të aktiveve të grupit të BKG.

6. SOCIÉTÉ GÉNÉRALE (FRANCË)
Totali i aktiveve për Société Générale, në fund të vitit 2009, ishte 1 023.7 miliardë euro, në rënie me 9% kundrejt vitit të mëparshëm. Rrjeti ndërkombëtar i bankës regjistroi rritje të të ardhurave gjatë vitit (+1.9% kundrejt vitit 2008) duke arritur në 4.7 miliardë euro dhe duke kontribuar me rreth 22% në të ardhurat neto të grupit për vitin 2009. Në rrjetin ndërkombëtar, depozitat u rritën me 5.4%, kurse kreditë zbritën me 2.6% kundrejt vitit 2008.

Fitimi neto i grupit për vitin 2009 ishte 678 milionë euro, në rënie me 66.3% kundrejt vitit 2008. Kthimi neto nga kapitali aksioner ishte 0.9% për vitin 2009 (kundrejt 6.4% një vit më parë), ndërsa vetëm në tremujorin e katërt, ky tregues ka treguar përmirësim të dukshëm (1.5% kundrejt 0.4% në tremujorin e katërt 2008).

Të ardhurat neto nga aktiviteti bankar për grupin ishin 21.7 miliardë euro, në rënie me 0.6% kundrejt vitit 2008. Shpenzimet e veprimtarisë, rreth 15.8 miliardë euro për vitin 2009, llogariten 1.5% më shumë kundrejt vitit të kaluar.

Në fund të vitit 2009, Banka Popullore në Shqipëri përbënte rreth 0.03% të totalit të aktiveve të grupit Société Générale.

7. CREDIT AGRICOLE (FRANCË) dhe EMPORIKI (GREQI)
Totali i aktiveve të grupit Credit Agricole, në fund të vitit 2009 ishte rreth 1 557.3 miliardë euro, në rënie me 5.8% kundrejt vitit 2008. Fitimi neto prej 1 125 milionë eurosh, paraqiti rritje prej 9.9% kundrejt fitimit të vitit 2008. Të ardhurat neto nga aktiviteti kryesor bankar për vitin 2009 ishin 17.9 miliardë euro, me një rritje vjetore 12.4%. Shpenzimet e veprimtarisë u zvogëluan me 3.6%, në nivelin 12.2 miliardë euro, ndërkohë që të ardhurat bruto të veprimtarisë u rritën me 73.4% kundrejt vitit 2008, duke shënuar nivelin rreth 5.8 miliardë euro. Shpenzimet e lidhura me rreziqet arritën në 4.7 miliardë euro, me një rritje të konsiderueshme gjatë vitit, e cila reflektoi kushtet e vështirësuara ekonomike në Greqi.

Kontributi i Bankës Emporiki në fitimin e grupit ishte negativ prej – 458 milionë euro për vitin 2009. Shpenzimet e lidhura me rrezikun vazhduan të ndikoheshin negativisht nga Emporiki, por ato u stabilizuan në tremujorin e katërt dhe pothuaj u përgjysmuan gjatë vitit.

Në fund të vitit 2009, Banka Emporiki në Shqipëri përbënte rreth 0.01% të totalit të aktiveve të grupit Credit Agricole.

3 ZHVILLIMET MAKROEKONOMIKE

Megjithë ndikimet negative të ekonomisë botërore, ekonomia shqiptare ka patur një rritje reale ekonomike pozitive gjatë vitit 2009. Tregues të ndryshëm të kërkesës, megjithatë sugjerojnë se dinamika e rritjes ekonomike ka qenë e ndryshme gjatë vitit, duke shfaqur një ngadalësim në tremujorin e katërt të tij. Faktorët që kanë shkaktuar këtë ngadalësim veç atyre të jashtëm përfshijnë mungesën e likuiditetit në disa sektorë kyçë të ekonomisë si dhe mungesën e alternativave të investimit, në kushtet e një pasigurie në rritje, gjë që është shfaqur edhe në ecurinë e kursit të këmbimit. Ekonomia ka përfituar nga një stimul i qëndrueshëm fiskal, ndërkohë që investimet private të bizneseve kanë shënuar rënie. Kërkesa konsumatore pas një rigjallërimi të fillimit të vitit, mbështetur edhe nga kthimi i besimit të publikut në sistemin financiar, në pjesën e fundit të vitit ka ndjerë efektet e reduktimit të financimit nga bankat dhe të reduktimit të transfertave nga jashtë.

Kontraktimi i kërkesës ka reduktuar presionet inflacioniste në ekonomi. Në fund të vitit 2009, inflacioni vjetor shënoi vlerën 3.5% dhe norma mesatare vjetore e inflacionit ishte 2.2%. Nga ana tjetër, mundësia e shfaqjes së presioneve inflacioniste në vendet e zhvilluara si dhe ecuria negative e kursit të këmbimit kanë dhënë ndikim në rritjen e kostos së jetesës. Në përputhje me qëllimin e mbajtjes së inflacionit rreth vlerës 3%, politika e Bankës së Shqipërisë ka përdorur instrumentet e saj në drejtim të ofrimit të një stimuli monetar për ekonominë duke ulur me 1 pikë përqindjeje normën bazë të interesit. Injektimi i likuiditetit në sistem ka zbutur ndikimin e reduktimit të burimeve të financimit për bankat dhe nëpërmjet tyre ka mundësuar kreditimin e ekonomisë.

Tabelë 4. Tregues kryesorë makroekonomikë.

	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Rritja reale vjetore e PBB-së me çmime konstante krahasuar me vitin e mëparshëm, në%[11]	7.94	4.23	5.77	5.71	5.72	5.4	6	7.8*	3.3*
PBB me çmime korrente në milionë lekë	583,369	622,711	694,098	750,785	814,797	882,209	966,651	1,087,867*	1,143,373*
PBB për frymë në usd	1,323	1,437	1,831	2,336	2,597	2,854	3,394	4,073*	3,765
Numri i të punësuarve (në mijë)	1,065	921	928	917	932	934	935	970	972**
Përqindja e papunësisë	14.6	15.8	15	14.6	14.2	13.8	13.4	12.6	12.8**
Përqindja e inflacionit (v/v)	3.5	1.7	3.3	2.2	2	2.5	2.9	3.4	3.5
Deficiti i buxhetit (me grantet, në% të PBB-së)	-28.9	-6.6	-4.5	-5.1	-3.6	-3.1	-3.5	-5.7	-7.0*
Borxhi publik (në% të PBB-së)[12]	66.8	65.3	61.7	56.6	56.7	55.9	52.2	55.9	59.5*
Borxhi i jashtëm (në% të PBB-së)[13]	25.8	23.5	20.6	18	17.5	17.2	14.4	18.3	23.1*
Llogaria korrente (pa transfertat zyrtare, në% të PBB-së)	-6.1	-10	-7.9	-5.6	-7.7	-7.2	-11.2	-15.2	-15.6*
Kursi mesatar i këmbimit, lek/usd	143.5	140.1	121.9	102.8	99.8	98.1	90.4	83.9	95.0
Kursi mesatar i këmbimit, lek/eur	128.5	132.4	137.5	127.7	124.2	123.1	123.6	122.8	132.1

** Vlerësime paraprake.*

*** Deri në tremujorin e tretë.*

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave, FMN.

Ecuria e lekut kundrejt shportës së valutave kryesore, në terma mesatarë, gjatë vitit 2009 ka vijuar në të njëjtën linjë nënçmuese të vërejtur që prej fundit të vitit 2008. Faktorët që mendohet të kenë ndikuar ecurinë e kursit të këmbimit janë të lidhur me krizën globale dhe ndikimin e saj në tregun vendas. Si të tillë mund të përmendim prurjet e reduktuara valutore nga emigrantët, rënien e eksporteve, reduktimin e kredisë në valutë dhe lëkundjen e besimit të agjentëve ekonomikë. Krahas këtyre faktorëve, zhbalancimit të raportit ofertë-kërkesë i është bashkëngjitur edhe efekti stinor, që ka karakterizuar rritjen e kërkesës për valutë në periudha të caktuara gjatë vitit.

3.1 ECURIA E EKONOMISË DHE E BIZNESEVE

Gjatë vitit 2009, ritmet e rritjes ekonomike u ngadalësuan si pasojë e ndikimeve të jashtme dhe materializimit të disa prej rreziqeve të brendshme me pasojë ngadalësimin e kërkesës agregate. Deri në fund të tremujorit të katërt, vlerësimet paraprake tregojnë se prodhimi i përgjithshëm u rrit me 3.3% në terma vjetorë, duke u ngadalësuar nga 5.4% në tremujorin e parë në -0.8% në tremujorin e katërt. Sipas publikimit tremujor të INSTAT mbi Prodhimin e Brendshëm Bruto, degët që patën rritjet më të larta krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2008 ishin postë-telekomunikacioni, tregtia dhe transporti respektivisht me 8.3%, 7.2% dhe 3.0%. Degët që patën rënie në këtë tremujor krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit të mëparshëm ishin ndërtimi dhe industria, respektivisht me 14.4 dhe 41%.

Gjithashtu, gjatë tremujorit të katërt të vitit, treguesit e besimit të bizneseve dhe konsumatorëve, treguesit fiskalë të realizimit të të ardhurave dhe performanca e kredisë për ekonominë sinjalizojnë një përkeqësim të aktivitetit.

Grafik 9. Indeksi i shifrës së afarizmit (rritja vjetore në përqindje).



Burimi: INSTAT, Statistikat Afatshkurtra tremujori i tretë 2009.

Indeksi i volumit të shifrës së afarizmit, i cili jepet në tabelën 5 dhe grafikun 9, në tremujorin e tretë 2009 arriti në 152.7, duke shënuar një rritje prej 12% krahasuar me tremujorin e tretë 2008. Treguesi i volumit të shifrës së afarizmit për industrinë dhe shërbimet paraqitet me një rënie prej 5% krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2008, si pasojë e performancës më të ulët të sektorëve të industrisë dhe ndërtimit gjatë tremujorit të tretë. Treguesi i volumit të shifrës së afarizmit për industrinë, krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2008 paraqitet pothuajse në të njëjtat nivele, ndërsa krahasuar me tremujorin paraardhës ka një rënie prej 1.5%. Në ndërtim, volumi i shifrës së afarizmit ka një rënie prej 8.3% krahasuar me tremujorin e mëparshëm, ndërsa krahasuar me tremujorin e tretë 2008 rritja është 24.5%. Rritja mesatare vjetore e tre tremujorëve të parë të vitit

megjithatë është 40% ose 20 pikë përqindjeje më e ulët se rritja mesatare e tre tremujorëve të parë të vitit 2008. Volumi i ndërtimit gjithashtu është ngadalësuar ndjeshëm krahasuar me vitin 2008; në tremujorin e tretë rritja e volumit është 21.5% nga 63.4 në tremujorin e tretë të vitit 2008. Në sektorin e shërbimeve për këtë periudhë, u shënua 13% rritje në terma vjetorë.

Tabelë 5. Të dhënat e prodhimit sipas degëve.

Indeksi i vëllimit të shifrës së afarizmit	I-07	II-07	III-07	IV-07	I-08	II-08	III-08	IV-08	I-09	II-09	III-09
Prodhim dhe shërbime	94.7	105.6	112.9	120.7	111.8	119.1	136.2	146	139.4	145.2	152.7
Prodhim (industri dhe ndërtim)	92.1	113.2	108.1	134.7	113.5	137.4	146	158.9	147	168.7	160.8
Industria	108.7	126.2	112.6	112.7	112.4	130.3	133.3	127.5	132.4	135.5	133.5
Industria nxjerrëse	116.2	172.5	144.5	125.3	117.6	177.3	147.3	109.5	88.5	128.6	149.9
Industria përpunuese	108.3	127	117.4	117.7	109.7	132.1	138.8	131	130.7	140.1	131
Energji elektrike, gaz, ujë	105.5	107.2	87.2	92.5	115.1	109	110.7	119.1	148.7	121.4	132.9
Ndërtimi	69	95.2	101.7	164.9	114.8	146.8	162.8	201	166.7	221	202.7
Shërbime	96.3	101.2	115.6	112.7	110.1	109.1	130.8	138.9	135.5	132.8	148
-Tregti	94.6	100.8	115.5	112.7	110.6	108.5	129.2	141.5	131.3	127.4	142.3
-Transport, komunikacion	103.7	102.1	115.5	112.7	111.1	110.7	138.8	126.5	142	142.3	167.3
-Hotele	78.7	117.2	141.6	129.7	103.1	114.1	142.9	108.6	111.2	130.2	149.6

Burimi: INSTAT, Statistikat Afatshkurtra tremujori i tretë 2009.

Tabelë 6. Produkti i Brendshëm Bruto sipas aktivitetit ekonomik, ndryshimet në% të një tremujori me të njëjtin tremujor të një viti më parë(Tv,i/Tv-1,i).

Seritë e të dhënave të shprehura me çmimet e një viti bazë (2005=100)												
	2007				2008				2009			
	T1	T2	T3	T4	T1	T2	T3	T4	T1	T2	T3	T4
Bujqësia, gjuetia dhe pyjet	1.6	1.4	2.7	5.7	8.6	7.7	7.1	7.7	3.1	3	2.7	1.7
Industria	-2.8	-5	-16.3	-21.5	-11.6	7.2	21.6	25.7	6.5	3.2	-8.3	-4.1
Ndërtimi	32.1	4.5	0.1	10.8	9.7	16.6	9.6	-9	-3.9	18.2	0.7	-14.4
Tregti, hotele dhe restorante	5.5	5.6	6	6.2	13.5	8.3	10.2	3.9	2.5	4	7	7.2
Transporti	15.2	17.7	1.7	-4.7	1.9	-10.7	-9.1	4.2	-1.3	13.4	16.7	3
Posta dhe komunikacioni	9.5	34.7	18.9	10.9	7	19	17	32.3	52.9	23.7	37	8.3
Shërbime të tjera	6.1	9.5	13	17.5	22.3	12.5	8.8	-3.7	2.3	2.6	0.8	0.1
Totali i vlerës së shtuar	7.5	5.7	3.9	6.3	10.6	9.4	9.4	3.1	4.1	6.6	4.2	-0.3
FISIM	25.3	25.7	23.1	19.6	9.4	1.5	1.4	6.7	10.5	14.8	14	10.6
Vlera e shtuar bruto me çmimet bazë	6.8	5	3.2	5.9	10.7	9.7	9.7	2.9	3.8	6.3	3.9	-0.8

Burimi: INSTAT, Produkti i Brendshëm Bruto Tremujor, Prill 2010.

Tabelë 7. Produkti i Brendshëm Bruto sipas aktivitetit ekonomik, ndryshimet vjetore në përqindje.

Seritë e të dhënave të shprehura me çmimet e një viti bazë (2005=100)												
	2007				2008				2009			
	T1	T2	T3	T4	T1	T2	T3	T4	T1	T2	T3	T4
Bujqësia, gjuetia dhe pyjet	2.5	1.6	1.7	2.6	4.2	6.3	7.4	7.7	6.4	4.9	3.9	2.7
Industria	6.3	3.9	-0.35	-11.7	-13.8	-10.9	-2	10.3	15.1	13.8	5.7	-1.2
Ndërtimi	15.2	16.7	13.5	10.1	6.5	9.2	11.6	4.8	1.9	2.8	0.8	-0.6
Tregti, hotele dhe restorante	1.9	2.8	5.1	5.9	7.6	8.2	9.3	8.6	6.3	5.3	4.5	5.4
Transporti	2.6	8.2	6.6	6.6	3.9	-3.2	-6.1	-4	-4.7	1.5	8.6	8.3
Posta dhe komunikacioni	10.3	20.3	22.4	17.6	16.7	13.9	13.6	19.5	30	30.8	35.9	18.2
Shërbime të tjera	4.9	6.1	8.8	11.8	15.7	16.3	15.1	9.1	4.5	2.3	0.4	1.4
Totali i vlerës së shtuar	5.4	6.3	6.3	5.8	6.5	7.5	8.9	7.9	6.5	5.8	4.5	3.6
FISIM	16.9	19.1	22.8	23.3	19	12.8	7.5	4.7	5	8.3	11.5	12.4
Vlera e shtuar bruto me çmimet bazë	5	5.9	5.7	5.1	6	7.3	8.9	8.1	6.5	5.7	4.2	3.3

Burimi: INSTAT, Produkti i Brendshëm Bruto Tremujor, Prill 2010.

Grafik 10. Treguesi i tendencës ekonomike.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Shtrëngimi i kërkesës agregate gjatë tremujorit të katërt të vitit mbështetet nga treguesi i tendencës ekonomike (TTE), i cili ra në nivelin 83.2, pas një rritjeje në dy tremujorët paraardhës. Në tremujorin e parë të vitit, ky tregues shënoi pikën e tij më të ulët (73.3) që prej vitit 2002. Kontributi kryesor në përkeqësimin e këtij treguesi ka qenë nga sektori i ndërtimit, ku treguesi i besimit ka shënuar vlerën më të ulët historike. Gjithashtu për sektorët e industrisë dhe të shërbimeve, treguesit e besimit qëndrojnë përkatësisht 127% dhe 126% më poshtë nivelit të tyre në fund të vitit 2008. Treguesi i besimit të konsumatorëve, gjithashtu paraqitet më i ulët se vitin e kaluar.

Treguesit e kërkesës aktuale dhe të pritshme në tre sektorët e vrojtuar janë vlerësuar gjithashtu në ulje nga bizneset gjatë vitit 2009. Kontratat porositëse janë ulur në tremujorin e katërt të vitit dhe shfrytëzimi i kapaciteteve ka rënë duke shënuar normën 65.6% gjatë kësaj periudhe. Pritjet e bizneseve në lidhje me kërkesën po ashtu janë vlerësuar në rënie, ndonëse sipas vrojtimit të konsumatorëve treguesit e blerjeve aktuale dhe të pritshme duken se kanë marrë një pikë kthese që prej kontraktimit të një viti më parë.

Si pasojë e një kërkese të ulët, edhe situata financiare e tre sektorëve të vrojtuar paraqitet e përkeqësuar, sidomos në gjysmën e dytë të vitit. Megjithatë krahasuar me fundin e vitit 2008, me përjashtim të sektorit të ndërtimit, fundi i vitit 2009 ka një përmirësim të dukshëm. Rëndimi i situatës ekonomike gjatë gjysmës së dytë të vitit pasqyrohet edhe në situatën financiare të individëve; treguesi i situatës financiare aktuale të individëve në fundin e vitit 2009 është përkeqësuar ndjeshëm krahasuar me fundin e gjashtëmujorit të parë.

Grafik 11. Treguesi i besimit të industrisë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 12. Treguesi i besimit të ndërtimit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 13. Treguesi i besimit të shërbimeve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 14. Treguesi i besimit të konsumatorit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 15. Kërkesa aktuale dhe e pritshme – industria.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 16. Kërkesa aktuale dhe e pritshme – ndërtimi.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 17. Kërkesa aktuale dhe e pritshme – shërbimet.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 18. Blerjet aktuale dhe të pritshme – konsumatorët.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 19. Gjendja financiare – industria.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 20. Gjendja financiare – ndërtimi.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 21. Gjendja financiare – shërbimet.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 22. Situata financiare aktuale dhe e pritshme e konsumatorëve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

3.2 PUNËZËNIA DHE MIRËQENIA E EKONOMIVE FAMILJARE

Në fund të tremujorit të tretë të vitit 2009, norma e papunësisë arriti në 12.76%. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, sektori privat jobujqësor ka kontribuar më shumë në punëzënien e forcave të lira.

Sipas INSTAT, numri i të punësuarve në sektorin joshtetëror për tremujorin e tretë të vitit 2009 krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë është rritur për të gjithë sektorët me përjashtim të industrisë, ndërkohë që niveli i pagave është rritur në mënyrë të qëndrueshme. Krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2008:

- në industri, numri i të punësuarve është ulur me 4.6% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm, ndërsa niveli i pagave është

rritur me 2.0%;

- në ndërtim, numri i të punësuarve është rritur me 9.5%, ndërsa pagat janë rritur 12.7%;
- në sektorin e tregtisë, numri të punësuarve është rritur me 9.6%, ndërsa pagat janë rritur 14.4%;
- në sektorin e hotelerisë, numri i të punësuarve është rritur me 18.3%, ndërsa pagat 14.4%;
- numri i të punësuarve në aktivitetin postar është rritur 3.2% dhe pagat e paguara nga ndërmarrja janë rritur 16.3%, ndërsa në komunikacion, numri i të punësuarve është ulur 8.7% ndërsa pagat janë rritur 14.7%.

Tabelë 8. Tregues të punësimit.

Tregu i punës (në mijë)	IV-07	I-08	II-08	III-08	IV-08	I-09	II-09	III-09
Forcat e punës	1082	1080	1079	1110	1116	1114	1114	1114
-Të punësuar	939	939	939	970	974	973	973	972
a) Në sektorin shtetëror	167	167	167	167	167	167	166	166
b) Në sektorin privat jobujqësor	230	231	231	235	239	238	238	237
c) Në sektorin privat bujqësi	542	542	542	569	569	569	569	569
-Të papunë	143	141	140	140	141	141	141	142
-Përfitojnë pagesë papunësie	10	9	9	10	10	8	8	9
Shkalla e papunësisë së regjistruar	13.2%	13.04%	12.97%	12.62%	12.68%	12.68%	12.7%	12.76%

Burimi: INSTAT.

Sipas vrojtimeve tremujore të Bankës së Shqipërisë për të tre sektorët e biznesit (industria, ndërtimi dhe shërbimet – grafik 23-25), punëzënia gjatë fundit të vitit 2009 është reduktuar. Pritshmëritë e bizneseve gjithashtu sinjalizojnë një reduktim të mëtejshëm të punëzënies me përjashtim të sektorit të shërbimeve.

Grafik 23. Punësimi aktual dhe i pritshëm – shërbimet.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 24. Punësimi aktual dhe i pritshëm – ndërtimi.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 25. Punësimi aktual dhe i pritshëm – industria.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 26. Remitancat dhe norma e papunësisë në disa vende të Evropës.



Burimi: Banka e Shqipërisë, Bureau of Labor Statistics, Eurostat.

Një tjetër burim i rëndësishëm i të ardhurave të individëve dhe familjeve, janë dërgesat e emigrantëve, të cilat për vitin 2009 kanë arritur në vlerën 780 milionë euro, duke rënë me 6.39% në krahasim me një vit më parë. Një zhvillim i tillë ishte i pritshëm dhe është në përputhje me treguesit e punëzënies në vendet e zhvilluara evropiane dhe pritet të ndikohet edhe në të ardhmen afatshkurtër nga kontraktimi i kërkesës dhe i punëzënies në këto vende.

Nga grafiku 26, vërehet një përputhje në kohë midis rritjes së normës së papunësisë në vendet e Bashkimit Evropian, veçanërisht në Greqi dhe në Italì, dhe rënies së dërgesave nga emigrantët.

Ecuria e papunësisë në vendet e BE-së nuk do të jetë i vetmi faktor shpjegues për ecurinë e remitancave. Duke marrë parasysh kufizimin e burimeve financiare për bankat evropiane (të diskutuar në pjesën e zhvillimeve ndërkombëtare), mbledhja e depozitave nga rezidentët e ekonomive përkatëse mund të jetë një prioritet për këto banka dhe kursimet e emigrantëve mund të fillojnë e të zhvendosen gradualisht në vendet e qendrës së interesit të tyre ekonomik. Si rezultat, oferta e valutës në vend, si dhe të ardhurat e individëve mund të vijojnë të pakësohen edhe pas rigjallërimit ekonomik në vendet e BE. Në këtë kontekst, marrja e masave për gjetjen e burimeve të brendshme të të ardhurave të familjeve shqiptare do të ishte e domosdoshme për të shmangur një korrektim drastik të konsumit. Nga ana tjetër, ruajtja e niveleve të qëndrueshme të kursit të këmbimit, do të kërkonte një rënie kompensuese të kërkesës për valutë, qoftë në formën e pakësimit të importeve ashtu dhe si kërkesë për huamarrje në valutë.

3.3 ZHVILLIMET E BILANCIT TË PAGESAVE

Nën ndikimin e kërkesës së ulët botërore si dhe tkurrjes së të ardhurave, zhvillimet e bilancit të pagesave tregojnë për një korrektim të lehtë të deficitit tregtar. Për pasojë, ndikimi i këtij të fundit mbi kursin e këmbimit ka qenë më i vogël dhe ka moderuar efektin e tkurrjes së remitancave.

Gjatë vitit 2009, zhvillimet në sektorin e jashtëm të ekonomisë u karakterizuan nga moderimi i deficitit tregtar dhe nga rënia e remitancave dhe e investimeve të portofolit. Nga ana tjetër, zhvlerësimi i monedhës vendase gjatë vitit dhe rritja e çmimit të lëndëve të para ka zbutur rënien e eksporteve. Në fund të vitit

2009, mjetet e rezervës u rritën me 32 milionë euro, duke arritur një masë të mbulimit të importeve prej 4.2 muajsh.

Në fund të vitit 2009, deficiti i llogarisë korrente arriti në 15.6% të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB), nga 14.9% në fund të vitit 2008 duke u ulur me 3.2% në krahasim me vlerën e tij të një viti më parë. Deficiti tregtar, në vitin 2009 arriti në 25% të PBB-së, krahasuar me 27.9% në vitin 2008. Në krahasim me vitin 2008, deficiti tregtar ishte rreth 7% më i ulët. Faktori kryesor në përmirësimin e tij ka qenë reduktimi i deficitit të tregtisë së mallrave me 127 milionë euro. Si importet, ashtu edhe eksportet kanë shënuar rënie në bazë vjetore. Importet gjatë vitit 2009 ishin rreth 9% më të ulëta sesa importet në vitin 2008, ndërsa eksportet ishin rreth 14% më të ulëta për të njëjtën periudhë.

Suficiti i llogarisë kapitale dhe financiare në fund të vitit 2009 arriti në 1018 milionë euro. Krahasuar me vitin 2008, suficiti i llogarisë kapitale dhe financiare ka rënë me 562.7 milionë euro kryesisht si pasojë e rënies në investimet e portofolit dhe investime të tjera, duke financuar vetëm 76.7% të deficitit të llogarisë korrente.

Në anën e investimeve vihet re ngadalësimi i flukseve hyrëse të investimeve direkte nga 3.4% në krahasim me rritjen vjetore dyshifrore 40.4% në vitin 2008. Të ardhurat nga privatizimet kanë luajtur një rol të rëndësishëm në rritjen e investimeve të huaja; gjatë vitit 2009, vlera e tyre ishte rreth 220 milionë euro.

Huamarrja publike (tërheqjet) ishte rreth 396 milionë euro, rreth 4.5% më e lartë se ajo e një viti më parë, ndërsa, huamarrja private regjistroi vlerën 39 milionë euro ose rreth 53.6% më e ulët se një vit më parë.

3.4 ZHVILLIMET FISKALE GJATË VITIT 2009

Në fund të vitit 2009, të ardhurat në buxhet u realizuan me rreth 93% të vlerës së planifikuar, ndërsa shpenzimet u realizuan me rreth 94% të vlerës së planifikuar. Ritmi i realizimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve të buxhetit, në krahasim me vlerat e realizuara në të njëjtën periudhë një vit më parë, ishte përkatësisht 2.4% dhe 7.8% më i lartë, duke reflektuar kështu natyrën ekspansioniste të politikës fiskale dhe efektet e ngadalësimit të aktivitetit ekonomik. Ndryshimet në ritmin e realizimit të të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë vitit 2009, kanë ndikuar në krijimin e një balance buxhetore negative prej rreth 79.9 miliardë lekësh.

Të ardhurat buxhetore kanë paraqitur një prirje ngadalësuese veçanërisht pas tremujorit të parë të vitit 2009. Kjo sjellje e të ardhurave është përcaktuar kryesisht nga të ardhurat nga tatimet dhe doganat, të ardhurat nga pushteti vendor dhe të ardhurat jotatimore. Diferenca me planin kanë shfaqur pothuajse të gjithë zërat e të ardhurave, me përjashtim të të ardhurave nga taksat doganore dhe sigurimi shoqëror. Gjithsesi, në terma vjetorë edhe të ardhurat nga taksat doganore kanë vijuar të pësojnë tkurrje.

Për sa i përket shpenzimeve, kontribuesit kryesorë në rritjen e tyre mbeten shpenzimet për personelin dhe shpenzimet për sigurimet shoqërore, por pas miratimit të aktit normativ, këto shpenzime janë nën nivelin e planit të ndryshuar. Kontributi i shpenzimeve kapitale është bërë më evident në dy vitet e fundit, si pasojë e shpenzimeve kryesisht në projektet e rëndësishme të infrastrukturës.

Ecuria e realizimit të të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore ka sjellë zgjerimin e deficitit buxhetor, i cili në fund të vitit vlerësohet rreth 7% e PBB-së[14]. Vlera nominale prej 79.9 miliardë lekësh e shënuar për periudhën 12-mujore, përfaqëson nivelin më të lartë të shënuar gjatë së njëjtës periudhë përgjatë gjithë dekadës së fundit. Ky deficit buxhetor është 33% më i lartë në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe është shoqëruar me nevoja më të larta për huamarrje, krahasuar me vitet e mëparshme. Kështu, krahas instrumenteve të përdorura gjerësisht në financimin e deficitit buxhetor gjatë viteve të mëparshme, në vitin 2009 ka gjetur përdorim dhe kredia sindikale, mundësuar nga institucione jorezidente dhe rezidente. Rol të konsiderueshëm në financimin e deficitit për vitin 2009 kanë luajtur dhe të ardhurat nga privatizimet e ndërmarrjeve me kapital shtetëror duke ndihmuar kështu në uljen e presioneve për likuiditet në tregun e parasë.

Tabelë 9. Financimi i deficitit buxhetor.

	2006	2007	2008	2009
Të ardhura	229.4	251.6	291.2	299.2
Shpenzime	258.8	285.7	351.5	379.1
Balanca buxhetore	-29.4	-34.1	-60.3	-79.9
Financimi	29.4	34.1	60.3	79.9
Financim i brendshëm	23.6	28.8	24.4	51.4
Huamarrje e brendshme	20.7	17.0	15.0	18.7
Të ardhurat e privatizimeve	2.0	13.2	5.5	27.6
Të tjera[15]	0.9	-1.5	3.9	-1.1
Kredi sindikale nga rezidentët	0.0	0.0	0.0	6.2
Financim i huaj	5.7	5.3	35.8	28.5
Projektet me burime të huaja	5.7	5.3	35.8	10.1
Kredi sindikale nga jorezidentët	0.0	0.0	0.0	18.4

Burimi: Ministria e Financave.

Rritja e deficitit buxhetor në vitin e kaluar në një masë më të madhe se në vitin 2008, ka sjellë një rritje të nivelit të borxhit publik rreth vlerës 59.6% të PBB-së, kundrejt 56% e PBB-së në fund të vitit 2008.

Zgjerimi i deficitit buxhetor dhe mënyra e financimit të tij gjatë vitit 2009, kanë ndikuar në orientimin e flukseve financiare në ekonomi. Në përgjithësi, nevojat më të mëdha për huamarrje të qeverisë ndikojnë në kufizimin e ofertës së kredisë për sektorin privat në ekonomi. Konsolidimi i financave publike ndikon në uljen e primeve të rrezikut në ekonomi, duke krijuar më shumë hapësira për kreditimin e sektorit privat, e duke favorizuar sheshimin e kurbës së normave të interesit, dhe uljen e mëtejshme të kostos së kreditimit. Në këtë kuadër, nismat për uljen e deficitit buxhetor dhe kontrollin e nivelit të borxhit publik i shërbejnë rritjes së qëndrueshme dhe afatgjatë të vendit.

Tabelë 10. Kredia për ekonominë, në milionë lekë.

Treguesi	Dhjetor 2007	Mars 2008	Qershor 2008	Shtator 2008	Dhjetor 2008	Mars 2009	Qershor 2009	Shtator 2009	Nëntor 2009	Dhjetor 2009
Mjetet e brendshme	618,926	638,569	683,714	712,787	725,737	727,373	745,897	760,189	773,419	780,222
Pretendimet neto ndaj qeverisë qendrore	256,840	255,744	265,569	265,655	257,992	245,574	261,781	264,766	269,286	269,923
Pretendimet ndaj korporatave jofinanciare publike	3,923	4,450	4,557	7,205	12,899	14,228	12,634	12,815	12,012	12,056
Pretendime ndaj sektorit privat*	285,425	306,984	338,608	365,237	377,924	396,635	399,714	408,854	412,198	416,496

**Përfshihen pretendimet ndaj korporatave të tjera jofinanciare dhe ndaj sektorëve të tjerë rezidentë.*
Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjatë vitit 2009, burimet e huaja kanë financuar rreth 35.66% të deficitit buxhetor, kundrejt 64.33% të financimit me burime të brendshme. Ndërkohë, për vitin 2008 financimi me burime të huaja ishte në masën 60%, ndërsa ai i brendshëm në masën 40%.

Në zbatim të politikës përkatëse, Ministria e Financave ka synuar rritjen e kohëzgjatjes mesatare të borxhit publik gjatë vitit 2009, duke rritur mundësitë për një administrim më të mirë të tij. Sidoqoftë, politika e emetimit të instrumenteve afatgjata nuk ka ecur sipas ritmeve të parashikuara për vitin 2009, pasi situata e tregut financiar të letrave me vlerë ka qenë e ndikuar nga situata e likuiditetit në treg duke u shoqëruar me rritjen e *yield-eve* të letrave me vlerë, si edhe të diferencave midis maturiteteve. Pas tremujorit të tretë të vitit, fokusi është zhvendosur drejt instrumenteve më afatshkurtra të borxhit, kryesisht drejt bonove të thesarit 12-mujore.

Financimi me burime të huaja ofron mundësi për vendosjen e një ekuilibri më të mirë në strukturën e borxhit dhe synon përmirësimin e kostos së tij në afat të mesëm. Emetimi i instrumenteve të borxhit të qeverisë në valutë të huaj dhe blerja e tyre nga investitorë institucionalë jorezidentë, shoqërohet me elemente nxitëse të disiplinës fiskale.

Sidoqoftë, prirja e rritjes së financimit të huaj në të ardhmen, duhet të ndiqet me vëmendje për të vlerësuar rrezikun e rifinancimit në terma të pafavorshëm dhe aftësinë për të përballuar koston e borxhit në përgjithësi.

Grafik 27. Përbërësit e borxhit publik.



Burimi: Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave.

Është e rëndësishme që mundësia e rifinancimit të borxhit të huaj në terma më të favorshëm në një periudhë afatmesme, të konsiderohet me kujdesin e nevojshëm për të parashikuar mundësi alternative në rast se hasen vështirësi në praktikë. Për sa i përket zhvillimit të borxhit të jashtëm, vërehet që portofoli i kredive me interes të ndryshueshëm është rritur

në mënyrë të ndjeshme gjatë dy viteve të fundit. Në këtë situatë, ky portofol bëhet më i ndjeshëm ndaj volatilitetit të normave të interesit referencë në tregun ndërkombëtar, si edhe ndaj luhatshmërisë së kurseve të këmbimit. Kjo luhatshmëri mund të japë efekte të konsiderueshme në buxhet. Për këtë arsye, përdorimi me efektivitet maksimal i borxhit duhet të përbëjë një objektiv kryesor.

Gjithashtu, nevojitet një përcaktim dhe zbatim i disiplinuar i kritereve të marrjes së borxhit të huaj në vazhdimësi, në mënyrë që të përballohet kostoja e rifinancimit ose e shlyerjes së tij në momentin e maturimit. Krahas kujdesit që duhet të tregohet për termat e huamarrjes, duhet që vlera e huamarrjes të përcaktohet në raport me mundësitë reale që ka ekonomia për të gjeneruar fonde të qëndrueshme në valutë gjatë së njëjtës periudhë, për shembull, prej ecurisë së eksporteve ose prej hyrjes së investimeve të huaja direkte. Parashikimi i flukseve hyrëse në valutë është i rëndësishëm për identifikimin e ndikimit të marrjes, përdorimit dhe shlyerjes së borxhit të huaj mbi ecurinë e kursit të këmbimit.

Përgjatë vitit 2010, vlerësohet e rëndësishme që realizimi i shpenzimeve publike të përgjithshme të kushtëzohet prej ecurisë së realizimit të të ardhurave. Rivendosja e prirjes rënëse të deficitit buxhetor është e rëndësishme për të ulur madhësinë dhe koston e financimit të tij, duke përmirësuar në vazhdimësi situatën e likuiditetit në tregun financiar dhe duke çliruar më shumë burime financiare në sistem. Ulja e këtij deficiti jep garanci më të mëdha për sigurimin e rifinancimit të borxhit me kushte më të favorshme përgjatë kohës.

4 TREGJET

4.1 TREGU I PASURIVE TË PALUAJTSHME

Ecuria e çmimeve të banesave është me rëndësi për sistemin financiar në vend, për publikun dhe për industrinë e ndërtimit. Për vetë rolin që pasuritë e patundshme luajnë në sistemin financiar, në sektorin bankar dhe në konsumin afatgjatë të qytetarëve, njohja e ecurisë së çmimit të tyre dhe e faktorëve që shkaktojnë ndryshimin e kësaj ecurie, merr rëndësi të madhe. Për këto arsye, është e rëndësishme t'i kushtojmë vëmendje tregut të pasurive të paluajtshme. Kështu, gjatë vitit 2009 indeksi i çmimeve të banesave për kryeqytetin[16] ka shënuar norma të larta rritjeje pas një periudhe rënëse përgjatë vitit 2008.

Grafik 28. Indeksi i çmimeve të shtëpive për rrethin e Tiranës.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ky indeks shënoi një rritje vjetore prej 11.6% në tremujorin e fundit të vitit dhe një rritje mesatare prej 13.6% për vitin 2009. Pas ndryshimeve negative tremujore të këtij indeksi gjatë tremujorit të parë të vitit, këto ndryshime kanë qëndruar rreth një vlere pozitive prej 5.8% për pjesën e mbetur të vitit. Kjo rritje ka reflektuar kryesisht ecurinë nënçmuese të lekut përgjatë gjithë kësaj periudhe, duke marrë në konsideratë që çmimet në tregun e banesave shprehen kryesisht në monedhën evropiane.

Rritja faktike në indeksin e çmimeve të shitjes që prej tremujorit të dytë të vitit 2009 është paraprirë nga vlerësime të bizneseve ndërtuese për rritjen e çmimeve të prodhimit. Prirjet për çmime në rritje në sektorin e ndërtimit sugjerojnë një ofertë të qëndrueshme në tregun e pasurive të paluajtshme. Nga ana tjetër, në krahun e kërkesës, shtrëngimi i kushteve të kreditimit gjatë vitit 2009 sugjeron për një ndrydhje të saj. Ngadalësimi i kredisë për pasuri të paluajtshme ka ardhur si pasojë e politikave dhe standardeve më të shtrënguara të bankave, por edhe prej një kërkese më të pakët për këtë produkt. Politikat e ndjekura nga bankat tregtare për shtrëngimin e kritereve të kreditimit janë vënë re kryesisht në rritjen e raportit të mbulimit me kolateral të kredisë, në rritjen e nivelit të mbulimit të kësteve të kredisë me të ardhura personale, në përzgjedhjen e cilësisë së kolateralit, si edhe në reduktimin e afatit të maturimit të kredisë në disa prej bankave. Kërkesa për këtë produkt është ndikuar gjithashtu edhe nga pritshmëritë për një rënie të çmimit të banesave.

Grafik 29. Pesha e kredisë për prona të patundshme në % kundrejt tepricës së kredisë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Indeksi i Kushtimit në Ndërtim, i cili vlerëson ecurinë e kostove të ndërtimit, gjatë tremujorit të

katërt të vitit 2009, arriti në vlerën 128.4% (Tremujori IV 1999=100), duke shënuar një rritje prej 0.1% kundrejt tremujorit të mëparshëm dhe një rënie prej 0.5% në krahasim me të njëjtën periudhë gjatë vitit 2008. Faktor kryesor në rënien e këtij treguesi është ndryshimi negativ i indeksit të çmimeve të grupit "shpenzime direkte" me 0.7% kundrejt tremujorit të katërt të vitit 2008. Ky grup shpenzimesh zë 67.6% të shpenzimeve totale, duke patur kështu peshën kryesore në shpenzimet e ndërtimit. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2008, indeksi i nëngrupit "shpenzime materiale" është ulur me 1.5%. Në këtë tremujor të fundit, krahasuar me tremujorin e katërt të një viti më parë, çmimet e materialeve të ndërtimit janë ulur me 1.8%, ndërsa çmimet e materialeve elektrike dhe hidrosanitare janë rritur përkatësisht me 8.3 dhe 1%. Indeksi i kushtimit në ndërtim ka shprehur gjithashtu rritje për nëngrupet e shpenzimeve për paga dhe transport përkatësisht prej 2.1 dhe 3.1%. Ndërkohë, ky indeks paraqet një rritje vjetore prej 0.1% në përqindjen e fitimeve të parashikuara dhe nuk shfaq ndryshime materiale për grupet e tjera në krahasim me tremujorin e mëparshëm dhe me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Zhvillimet në këtë indeks tregojnë që çmimet në tregun e banesave nuk kanë reflektuar plotësisht ecurinë e kostove të ndërtimit, duke nënkuptuar disi rritjen e marzheve të fitimit për industrinë e ndërtimit. Aktualisht, për të nxjerrë konkluzione mbi prirjet e ecurisë së çmimit të banesave në të ardhmen, mbetet mjaft i domosdoshëm përmirësimi i metodologjisë së mbledhjes së informacionit, për të siguruar një shtrirje më të madhe gjeografike si edhe një vlerësim më të saktë të këtij tregu në të ardhmen.

4.2 TREGJET FINANCIARE

Tregu financiar shqiptar dominohet nga veprimet e tregut ndërbankar, të letrave me vlerë të borxhit të qeverisë dhe të këmbimeve valutore. Segmente të tjera që lidhen me sigurimin, risigurimin dhe fondet e pensionit përbëjnë një pjesë të vogël të vëllimit të përgjithshëm të tregut financiar. Në fillim të vitit 2009, situata në tregun financiar u përkeqësua, normat e interesit ndërbankar u rritën si rezultat i rënies së likuiditetit dhe luhatjeve në tregun e këmbimeve valutore. Në gjysmën e dytë të vitit, situata u normalizua për shkak të masave të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë dhe përmirësimit të përgjithshëm të situatës së likuiditetit.

Grafik 30. Tregu ndërbankar.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

4.2.1 TREGU NDËRBANKAR

Gjatë vitit 2009 është vënë re një stabilizim i normave të interesit në tregun ndërbankar. Krahasuar me vitin 2008, norma mesatare e ponderuar e interesit pati një luhatje më të ulët që varioi midis 5 dhe 6%. Ky normalizim i normave pasqyron rritjen e besimit dhe përmirësimin e likuiditetit të tregut ndërbankar si rezultat i masave të ndërmarra.

4.2.2 TREGU PRIMAR I TITUJVE

Ecuria e *yield*-eve të tregut primar ka ndjekur prirje rritëse në pjesën më të madhe të vitit 2009, për të kthyer kah më pas gjatë muajve nëntor dhe dhjetor si reagim ndaj lehtësimit të politikës monetare. Ulja e normës bazë në fundin e muajit tetor duket të jetë përcjellë tek *yield*-et në tregun primar në një kohë që pjesëmarrja e lartë e bankave në këtë treg, por edhe uljet e mëparshme të normës, dukej sikur nuk kishin ndikuar bindshëm në këtë kah.

Pjesëmarrja e bankave në ankandet e letrave me vlerë të qeverisë ka qenë e lartë. Në dhjetor 2009, shuma totale e kërkuar në ankandet e letrave me vlerë të qeverisë ishte rreth 72 miliardë lekë nga 51 miliardë që ofronte Ministria e Financave. Për rrjedhojë, raporti "bid-to-cover" (Grafiku 31) ka arritur vlerën më të lartë që nga janari 2008, në 1.43[17].

Grafik 31. Raporti Bid-to-cover për Bonot.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjithsesi, ky përmirësim nuk ka ndikuar në zbutjen e presioneve rritëse të *yield*-eve, duke evidentuar kështu rritje të vlerësimit të rrezikut. Rritja më e theksuar në *yield*-et e bonove të thesarit është vërejtur për maturitetin më të gjatë 12-mujor, duke u përcjellë më pas dhe në *yield*-et e obligacioneve të parametruar me këtë tregues. Në fund të muajit tetor, interesi i bonove 12-mujore arriti vlerën 9.43% duke zbritur më pas në vlerat 9.06%. Ndonëse ecuria e *yield*-eve ka shfaqur prirje zbritëse në fund të vitit 2009, në terma mesatarë ato janë më të larta se në gjashtëmujorin e parë të vitit. Në nivel mesatar, *yield*-i i bonove njëvjeçare është 0.22 pikë përqindjeje me i lartë se gjashtëmujorin e parë të vitit 2009.

Grafik 32. Volumi i kërkesës dhe ofertës së Bonove.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Të njëjtën ecuri kanë ndjekur dhe *yield*-et për maturitetet e tjera, 6 dhe 3-mujore, por në masë më të përmbajtur. *Yield*-i për afatin 6-mujor pasi arriti vlerën 7.73% në muajin tetor, vijoi në zbritje për të shënuar 7.52% në fund të muajit dhjetor. *Yield*-i i bonove 3-mujore ka shfaqur luhatshmëri më të përmbajtur dhe ka qëndruar afërsisht në të njëjtin nivel.

Tregu primar i obligacioneve ka evidentuar të njëjtën prirje me atë të bonove të thesarit. *Yield*-et e obligacioneve janë rritur kryesisht gjatë tremujorit të tretë të ndikuar nga rritja e vlerësimit të rrezikut nga ana e bankave në një kohë që pjesëmarrja në ankande ka qenë në nivele të kënaqshme[18]. Në ankandet e zhvilluara në nëntor dhe më pas, *yield*-i i obligacioneve 2-vjeçare u ul duke ndjekur kështu uljen e përgjithshme që shfaqën edhe bonot e thesarit.

Grafik 33. Kurba e *yield*-eve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 34. Kursi ditor i këmbimit valutor të EUR, USD dhe GBP në Lekë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 35. Kursi i këmbimit sipas shportës 80:20.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në fund të tremujorit të katërt të vitit 2009, *yield*-i i obligacioneve 2-vjeçare vlerësohej me 9.30% ose 0.05 pikë përqindje më pak se mesatarja e gjashtëmujorit të parë të vitit 2009. Ecuri të njëjtë kanë ndjekur edhe *yield*-et e obligacioneve 3 dhe 5-vjeçare (me interes të ndryshueshëm). Kështu në fund të vitit 2009, ato shënonin respektivisht 9.60 dhe 10.93% (Grafiku 33). Vlen për t'u theksuar se rritja e *yield*-it të obligacioneve me interes të ndryshueshëm ka qenë kryesisht e ndikuar nga ecuria e instrumenteve me të cilat ai parametrohet, pasi marzhi i pranuar ka ndjekur gjithmonë prirje rënëse gjatë kësaj periudhe.

4.3 TREGU I KËMBIMEVE VALUTORE

Në vitin 2009, euro, dollari amerikan dhe paundi britanik u forcuan respektivisht me 12, 6 dhe 18% kundrejt lekut. Zhvlerësimi i lekut kundrejt monedhave kryesore pasqyron situatën e vështirësuar ekonomike në vend si dhe forcimin e këtyre monedhave në tregjet ndërkombëtare. Në gjysmën e dytë të vitit 2009 është vënë re një ngadalësim i rritjes së prodhimit të brendshëm bruto. Remitancat dhe eksportet kanë pësuar një rënie në raport me totalin e prodhimit të brendshëm bruto, duke ushtruar në këtë mënyrë presion zhvlerësues mbi monedhën vendase[19]. Për shkak të krizës që përfshiu tregjet financiare në botë, luhatshmëria në tregun valutor u rrit dukshëm. Kjo situatë rriti koston dhe rrezikun e veprimtarisë për bizneset që bazohen në import-eksportet dhe individët me kredi në valutë.

VEPRIMET E BANKËS SË SHQIPËRISË

Në 24 dhjetor 2008, Banka e Shqipërisë, uli me 100 pikë bazë normën e kredisë njëditore duke kaluar përkohësisht në një korridor asimetrik të normave kufi të interesit. Një muaj më pas, në 28 janar 2009, Këshilli Mbikëqyrës vendosi të ulë me 50 pikë bazë normën e marrëveshjeve të riblerjes. Banka e Shqipërisë ndryshoi gjatë vitit 2009 formën e ankandeve në tregun e hapur nga me shumë të kufizuar në ankande me shumë të pakufizuar dhe me normën të fiksuar në nivelin e normës bazë të interesit[20]. Bankat u lejuan të përdornin çdo ditë deri në 40% të rezervës së tyre të detyruar në lekë (nga 20% që ishte vendosur në korrik 2008).

Gjithashtu, në 28 tetor 2009 Këshilli Mbikëqyrës vendosi të ulë përsëri normën bazë në 5.25%. Këto veprime të njëpasnjëshme të Bankës së Shqipërisë i dhanë një ndihmë të konsiderueshme likuiditetit të sistemit financiar dhe normalizuan situatën e tregut ndërbankar.

Grafik 36. Normat e tregut.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

4.4 *SPREAD*-I MIDIS NORMAVE TË INTERESIT TË KREDIVE DHE DEPOZITAVE TË REJA

Gjatë vitit 2009, normat mesatare të ndërmjetësimit janë luhatur për të treja monedhat kryesore, duke treguar një ecuri jo të njëtrajtshme të *spread*-it midis depozitave dhe kredive të reja, ndonëse në harkun kohor të një viti evidentojnë rritje (Grafiku 37). Kështu, nga fundi i vitit 2008 vërehet një shtrëngim në normën e huadhënies për të gjitha monedhat, ndërkohë që në fund të vitit 2009 normat e interesit për depozitat në lekë janë të vetmet që tregojnë rritje[21]. *Si* rezultat i ritmeve rritëse të normave të interesit për kreditë e reja në të tre monedhat kryesore, spread-i i normave të interesit midis kredive dhe depozitave për të tre këto monedha, tregon rritje. Kështu, spread-i i normave të interesit për lekun rezultoi 11.14%[22] në fund të vitit 2009, rreth 1 pikë përqindjeje më i lartë se ai i një viti më parë. Ky ndryshim ka ardhur si rezultat i një ritmi më të lartë rritjeje të normave të interesit të kredive të reja në lekë kundrejt normave të depozitave. Ndërkohë, ndryshimi më i ndjeshëm i përket aktivitetit të ndërmjetësimit në euro, me një spread në rritje nga fundviti 2008 prej 1.7 pikësh përqindjeje, duke rezultuar 7.19% në fundvitin 2009. Shkak për këtë kanë qenë jo vetëm rritja e normave të kredisë, por edhe rënia e normave të depozitave në këtë monedhë. *Spread*-i është zgjeruar edhe në rastin e monedhës amerikane, si pasojë e rritjes së normave të kredisë dhe uljes së atyre të depozitave, por këto ndryshime (vetëm 0.3 pikë përqindje) janë të lehta në krahasim me dy monedhat e lartpërmendura.

Grafik 37. Spread-i për normën e interesit në %.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjatë vitit 2009 vërehet rritje e normave të interesit për depozitat e pranuara gjatë muajve të verës, rezultat i fushatave të bankave për të tërhequr publikun, sidomos të ardhurat sezonale nga emigracioni. Në muajin gusht, normat për depozitat në lekë dhe dollarë kanë arritur vlerën më të lartë të të gjithë vitit. Vëllimi i kredive të dhëna gjatë kësaj periudhe ka qenë gjithashtu në rritje, megjithëse normat e interesit nuk kanë treguar luhatje të qenësishme. Rezultat i këtyre zhvillimeve janë thellimi i *spread*-eve të normave të interesit midis kredive dhe depozitave të reja për të tre monedhat kryesore, në harkun kohor të një viti.

5 ZHVILLIMET NË SISTEMET E PAGESAVE

Në Republikën e Shqipërisë, klerimi dhe shlyerja e pagesave ndërmjet bankave, në monedhën kombëtare Lek, realizohet nëpërmjet dy sistemeve të pagesave: "Sistemi i shlyerjes së pagesave ndërbankare me vlerë të madhe - AIPS" dhe "Sistemi i klerimit të pagesave me vlerë të vogël – AECH", në përputhje me rregullat dhe procedurat e funksionimit të sistemeve.

Banka e Shqipërisë luan një rol kryesor në nxitjen dhe zhvillimin e sistemeve kombëtare të pagesave, kryesisht për shkak të rëndësisë së tyre në arritjen e stabilitetit financiar, në sigurimin e funksionimit të duhur të sistemit bankar dhe atij financiar, si dhe në mbështetje të funksionit kryesor për zbatimin e politikës monetare të vendit.

Gjatë vitit 2009, sistemet e pagesave kanë reflektuar "siguri" dhe "eficencë", karakteristika të domosdoshme për funksionimin efektiv të sistemit bankar, që do të thotë realizim i kërkesave kritike në mbështetje të stabilitetit financiar.

Për rrjedhojë të impaktit të krizës financiare globale, viti 2009 evidentoi tkurrje të volumit të transaksioneve, si në numër ashtu dhe në vlerë, edhe për sistemet e pagesave në vend. Kështu, gjatë vitit 2009, sistemi i shlyerjes së pagesave ndërbankare me vlerë të madhe (AIPS) shënoi një numër total prej 55 701 transaksionesh me vlerë 4 718 miliardë lekë, respektivisht rreth 2 dhe 8% më pak në krahasim me vitin 2008. Gjithashtu, volumi i pagesave të kleruara gjatë vitit 2009 në sistemin e pagesave me vlerë të vogël (AECH) rezulton të jetë ulur me 10%, ndërsa vlera e këtyre transaksioneve të kleruara është ulur me 12% kundrejt vitit 2008.

Mesatarisht çdo ditë në sistemin AIPS janë procesuar dhe shlyer rreth 225 transaksione me një qarkullim mesatar ditor prej 19 miliardë lekësh. Vlera totale e likuiditeteve të shlyera në sistemin AIPS gjatë vitit 2009, rezulton të jetë rreth 4.3 herë vlera e produktit të brendshëm bruto (PBB). Nga këto transaksione të procesuara dhe të shlyera në AIPS, rreth 53% të numrit të tyre, por vetëm 9.5% të vlerës, e zënë pagesat që bankat shlyejnë ndërmjet tyre për llogari të klientëve, përfshirë këtu dhe pagesat që bankat transferojnë çdo ditë në llogarinë e buxhetit të shtetit për llogari të klientëve. Ndërkohë, qarkullimin më të lartë të likuiditetit, mbi 57% ndaj totalit, e zënë transaksionet e iniciuara nga Banka e Shqipërisë, për përmbushjen e objektivave të saj ligjorë, si dhe pagesa të urdhëruara nga bankat por të ekzekutuara në sistem nga Banka e Shqipërisë. Lloji i transaksionit "shlyerje neto për sistemet e klerimit", i cili përbën 11.6% të totalit të vlerës së transaksioneve në AIPS, përfshin transaksionet për shlyerje neto të rezultateve nga sistemet e klerimit si: klerimi i pagesave me vlerë të vogël në sistemin AECH, klerimi i çeqeve bankare dhe personale në lekë, shlyerjet neto për emetimin/maturimin e letrave me vlerë të qeverisë dhe shlyerjet neto të rezultateve të pagesave në lekë me karta VISA, shërbime për të cilat Banka e Shqipërisë luan rolin e agjentit shlyerës.

Lidhur me transaksionet në sistemin AECH, në të cilin procesohen dhe klerohen pagesat e klientëve me vlerë nën 1 milion lekë, gjatë vitit 2009,

mesatarisht çdo ditë janë procesuar rreth 413 pagesa, me një vlerë mesatare ditore prej 62.33 milionë lekësh. Volumi dhe vlera më e madhe e transaksioneve të kleruara në AECH, vihet re në tremujorin e katërt të vitit 2009.

Përqendrimi në sistemet e pagesave vlerësohet nëpërmjet peshës së volumit të transaksioneve, që zënë 3 dhe 5 bankat më aktive respektivisht në secilin sistem. Kështu, në sistemin AIPS, vlera e transaksioneve të 3 bankave më aktive përbën 73% të vlerës totale të aktivitetit (nga 70% në vitin 2008), ndërsa 5 banka (përfshirë dhe Bankën e Shqipërisë) kanë iniciuar gjatë vitit 2009 rreth 61% në numër dhe 86% në vlerë të transaksioneve, kundrejt totalit të aktivitetit në AIPS. Gjithashtu, në sistemin AECH, vlerësohen 5 banka të kenë iniciuar gjatë vitit 2009 rreth 61% në numër dhe 67% në vlerë të transaksioneve, kundrejt totalit të aktivitetit në AECH. *Peshat e rëndësishme të një numri jo të konsiderueshëm bankash ndaj totalit të aktivitetit në të dy sistemet tregojnë shkallë të lartë përqendrimi lidhur me numrin dhe volumin e transaksioneve në sistemet e pagesave.*

Ndërkohë, viti 2009 vlerësohet për zhvillime pozitive lidhur me përdorimin e kredisë brenda ditës (në formën e kredisë së kolateralizuar me interes zero) nga pjesëmarrësit në sistemin AIPS. Kështu, krahasuar me vitin 2008, përdorimi i kredisë njëditore ka rënë me 64% në numër dhe 46% në vlerë. Gjithsesi, një faktor i rëndësishëm në pakësimin e kredisë njëditore vlerësohet të jetë ndryshimi i politikës së Bankës së Shqipërisë për rritjen e limitit (nga 20% në 40%) të përdorimit nga bankat të rezervës së detyruar në lekë, për nevoja likuiditeti gjatë ditës.

Gjithashtu, për vitin 2009, vlen të theksohet dukuria pozitive në lidhje me tendencën në rënie të përdorimit të çekut si instrument pagese në formë letre. Tabela në vijim pasqyron numrin dhe vlerën e urdhërpagesave ndërbankare të iniciuara me çeqe (personale dhe bankare) në lekë, si dhe të kleruara dhe shlyera për rezultat neto në sistemin AIPS. Nga tabela vihet re një rënie gjatë vitit 2009 përkatësisht prej 51% në numër dhe 73% në vlerë, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Tabelë 11. Shlyerja e çeqeve në AIPS.

Shlyerja e çeqeve në AIPS	2007	2008	2009
Numri i çeqeve të procesuara dhe shlyera	544	403	199
Vlera e çeqeve (miliardë lekë)	1,34	0,85	0,23

Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Sistemeve të Pagesave.

5.1 INSTRUMENTET E PAGESAVE[23]

Gjatë vitit 2009 është rritur numri i pajisjeve ATM dhe POS për përdorimin e kartave, përkatësisht me 15 dhe 48%, krahasuar me numrin e tyre në fund të vitit 2008. Gjithashtu, numri total i llogarive bankare të klientëve, të vlefshme për të kryer pagesa në lekë apo në valutë të huaj është 2,086,143, e krahasuar me fundin e vitit 2008 përbën rreth 33% më shumë llogari klientësh të hapura

gjatë vitit 2009. Rreth 93% e totalit të llogarive janë llogari individuale dhe mbi 99% llogari të rezidentëve.

Kartat janë instrumente pagesash që kanë gjetur përdorim në Shqipëri, pavarësisht se shkalla e përdorimit të tyre është ende e ulët krahasuar me treguesit e vendeve të tjera të rajonit. Në 31 dhjetor 2009, vërehet një rritje prej 11% e numrit të kartave në qarkullim, krahasuar me fundin e vitit 2008. Brenda kësaj rritjeje, peshë ka patur edhe shtimi i kartave të kreditit të emetuara gjatë vitit 2009, me një rritje prej 50%, kundrejt fundvitit 2008.

Gjatë vitit 2009, në total u procesuan mbi 9 milionë transaksione me karta, me një qarkullim total vjetor prej 102 miliardë lekësh. Nga totali i transaksioneve, rreth 96% e përbëjnë tërheqje *cash* nga ATM-të, tregues ky i një ekonomie me përdorim të lartë të *cash*-it.

Në fund të vitit 2009, 10 banka ofrojnë shërbime "*home banking*", që nënkupton aksesimin e llogarisë bankare nga shtëpia, nëpërmjet një linje interneti, telefoni apo një *software*-i, që banka i vë në dispozicion klientit të saj. Krahasuar me vitin 2008, gjatë vitit 2009 vërehet rritje e numrit dhe vlerës së transaksioneve "Home Banking", përkatësisht prej 55 dhe 25%.

ROLI I BANKËS SË SHQIPËRISË SI MBIKËQYRËSE E SISTEMIT TË PAGESAVE

Roli i bankës qendrore në reformimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave po merr një rëndësi gjithnjë dhe më të madhe në kushtet e turbulencave në tregjet financiare ndërkombëtare. Në këtë kuadër, Banka e Shqipërisë po punon për ndërtimin e një sistemi kombëtar pagesash të sigurt dhe eficient, në mbështetje të zhvillimit të tregut financiar në vend, por njëkohësisht duke synuar shmangien e risqeve që sjell ky zhvillim. Drejtimet kryesore ku është fokusuar puna, janë:

1. Forcimi i kuadrit ligjor në funksion të rolit mbikëqyrës për sistemet e pagesave.

Aktualisht, është në fazën përfundimtare draftimi i projektligjit *"Për sistemet e pagesave"*. Projekti synon të përcaktojë një kuadër ligjor të domosdoshëm për funksionimin e sigurt dhe eficient të sistemit kombëtar të pagesave, rolin dhe detyrat e Bankës së Shqipërisë në lidhje me zhvillimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave dhe të shlyerjeve në Republikën e Shqipërisë. Kapitujt të rëndësishme të projektligjit janë:

- rregullimi dhe mbikëqyrja e sistemeve, ku është synuar të përcaktohet qartë roli i Bankës së Shqipërisë si mbikëqyrëse e sistemeve të pagesave dhe të shlyerjes, pavarësisht nëse janë sisteme që operohen brenda Bankës së Shqipërisë, apo jashtë Bankës nga operatorë privatë, licencimi i subjekteve që ofrojnë shërbime pagesash në Republikën e Shqipërisë, kompetencat inspektuese dhe vendimmarrëse të Bankës së Shqipërisë për angazhimin në këtë rol etj.;

- mbrojtja e sistemeve, ku synohet të rregullohen çështje që lidhen me mbrojtjen e sistemeve nga paaftësia paguese e pjesëmarrësve në sistem, karakteri përfundimtar dhe pakthyeshmëria e urdhërpagesave të hyra në sistem, përcaktimi i çastit të hapjes së procedurave për paaftësi paguese të një pjesëmarrësi në sistem etj.;
- mbrojtja e marrëveshjeve të kolateralit financiar, ku rregullohen koncepte të tilla si vlefshmëria dhe zbatimi i marrëveshjeve të kolateralit financiar në sistemet e pagesave dhe të shlyerjes, shlyerja e kolateralit financiar të lënë peng dhe të tjera koncepte juridike, rregullimi i të cilave është i domosdoshëm për funksionimin normal të sistemeve të pagesave dhe të shlyerjes.

2. Përmirësimi dhe nxitja e ndryshimeve në sistemin kombëtar të pagesave në funksion të rolit reformator për sistemet e pagesave.

Projekti për zbatimin e IBAN-it, në zbatim të rregullores nr. 42, datë 16.07.2008 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë "Për strukturën dhe përdorimin e Numrit Ndërkombëtar të Llogarisë Bankare (IBAN)", që synon standardizimin e numrave të llogarive që përdoren për kryerjen e pagesave në Republikën e Shqipërisë, është zhvilluar në dy faza: (a) të gjitha bankat kanë përfunduar standardizimin e numrave të llogarive të klientëve në formatin IBAN, si dhe njoftimin e klientëve, brenda datës 1 qershor 2009; (b) duke filluar nga data 5 janar 2010, të gjitha bankat përdorin dhe validojnë saktësinë e numrave IBAN, për të gjitha pagesat e dërguara/marra brenda vendit apo ndërkufitare. Për këtë qëllim janë përshtatur sistemet e brendshme të bankave me sistemet e pagesave (AIPS dhe AECH) për të mundësuar krijimin, përdorimin dhe validimin e IBAN-it në instruksionet e pagesave të klientëve.

Projekti për ofrimin e shërbimit të shlyerjes neto të transaksioneve me karta në lekë, për bankat pjesëmarrëse në shërbimin MasterCard, u iniciua në gusht të vitit 2009, në vijim të kërkesës së kompanisë MasterCard. Në zbatim të vendimit të Këshillit Mbikëqyrës për miratimin e pjesëmarrjes së tërthortë të MasterCard në sistemin AIPS, po punohet për finalizimin e marrëveshjes me MasterCard dhe të procedurave të brendshme të Bankës për ofrimin e këtij shërbimi të ri. Pas nënshkrimit të marrëveshjes midis palëve (Banka e Shqipërisë dhe MasterCard International), si dhe miratimit të procedurave operacionale të shlyerjes, së shpejti do të fillojë edhe shlyerja neto në sistemin AIPS, e pagesave në lekë me karta MasterCard dhe Maestro.

6 ZHVILLIME TË SISTEMIT FINANCIAR

Niveli i ndërmjetësimit financiar në Shqipëri, i vlerësuar si raport i aktiveve të sektorit financiar[24] ndaj Produktit të Brendshëm Bruto[25] (PBB-së) ka shënuar rritje të lehtë në fund të vitit 2009, në rreth 82% kundrejt 80.4% në fund të vitit 2008. Në Tabelën 12, jepet shpërndarja e peshave të subjekteve që përbëjnë sistemin financiar ndaj PBB-së në vite. Në fund të vitit 2009, vëllimi i aktiveve të institucioneve financiare u rrit me rreth 7% krahasuar me fundin e vitit 2008. Në strukturën e aktiveve të sistemit financiar, bankat luajnë rolin kryesor. Në fund të vitit 2009, aktivet e tyre përfaqësonin rreth 94.7% të totalit të aktiveve të sistemit financiar dhe rreth 77.5% të Produktit të Brendshëm Bruto (PBB-së).

Tabelë 12. Pesha e aktiveve të subjekteve të sistemit financiar ndaj PBB-së në vite (në%).

Autoriteti licencues dhe mbikëqyrës	Sistemi financiar	Vitet				
		2005	2006	2007	2008	2009
Banka e Shqipërisë	Sistemi bankar	60.4	69.6	75.9	76.7	77.5
	Institucione jobanka	1.32	1.52	1.48	1.66	2.1
	SHKK-të dhe Unionet e tyre	0.46	0.52	0.63	0.7	0.77
Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare	Shoqëri sigurimi	1.24	1.29	1.36	1.45	1.5
	Fondet e pensionit	-	-	-	-	0.01

Burimi: Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Hapësirë Informuese 2. Sektori Financiar Jobankar

Sektori financiar jobankar përbën një peshë relativisht të vogël në totalin e sistemit financiar. Ky sektor përfaqësohet nga institucionet financiare jobanka, shoqëritë e kursim-kreditit, të cilat licencohen nga Banka e Shqipërisë dhe shoqëritë e sigurimit dhe fondet e pensioneve private suplementare, të licencuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF).

Grafik 38. Pesha e aktiveve të subjekteve të sistemit financiar ndaj totalit të aktiveve të sistemit financiar në %.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Sektori financiar jobankar kryen veprimtari ndërmjetësuese, por nuk pranon depozita nga publiku. Njësitë përbërëse të këtij sektori janë: 13 institucione financiare jobanka, 2 unione të mëdha të kursim-kreditit dhe shoqëritë e tyre anëtare, si dhe një numër i konsiderueshëm zyrash të këmbimit valutor. Mbështetur në të dhënat më të fundit për vitin 2009, aktivet e institucioneve financiare jobanka përbëjnë 2.53% të totalit të aktiveve të sistemit financiar (nga 2% në fund të vitit 2008) duke zënë 2.1% të PBB-së (nga 1.6% në fund të vitit 2008). Pesha e shoqërive të kursim-kreditit llogaritet në 0.94% të totalit të sistemit financiar, pranë nivelit të fundvitit 2008 dhe 0.77% të PBB-së së vendit (nga 0.7% në fund të vitit 2008). Segmentet e tjera të sektorit financiar jobankar, që monitorohen nga AMF janë: shoqëritë e sigurimit (të jetës dhe jo-jetës), fondet e pensionit privat suplementar dhe tregu i letrave me vlerë. Për kompanitë e sigurimit, sipas të dhënave të fundit që i përkasin tremujorit të tretë të vitit 2009, aktivet e tyre përbënin 1.8% të

sistemit financiar, nga 1.7% në fund të vitit 2008. Në raport me PBB-në, pesha e tyre llogaritet 1.5%. Fondet e pensionit privat zënë një peshë të papërfillshme në totalin e aktiveve të sistemit financiar dhe në PBB-në e vendit. Në Grafikun 38 më poshtë paraqitet struktura e sistemit financiar mbështetur në të dhënat më të fundit për secilin subjekt që operon në vend.

ANALIZË FINANCIARE MBI AKTIVITETIN E INSTITUCIONEVE FINANCIARE JOBANKA

Veprimtaria e institucioneve financiare jobanka gjatë vitit 2009[26] paraqet zhvillime pozitive për sa i përket rritjes së aktiveve dhe zgjerimit të portofolit të kredive, megjithatë evidentohet ngadalësim në disa prej treguesve financiarë të tyre si niveli i fitimit, niveli i kapitalizimit dhe rënia e cilësisë së portofolit të kredisë krahasuar me të njëjtën periudhë një vit më parë.

Aktivet e institucioneve financiare jobanka në tremujorin e tretë të vitit 2009 rezultuan afërsisht 23.6 miliardë lekë, rreth 8.9 miliardë lekë më shumë se një tremujor më parë (ose 61%) dhe rreth 5.8 miliardë më shumë (ose 32.7%) se fundi i një viti më parë (Grafiku 39).

Kontributin më të madh, përkrah shtimit të aktiveve të dy institucioneve të reja jobanka, për tremujorin e tretë të vitit 2009 e dhanë zëri *"Veprime me klientët"*, që përfaqëson aktivitetin kreditues, me rreth 33%, ndjekur nga zëri *"arka, depozita dhe llogaritë"* me rreth 8%.

Niveli i kapitalizimit, i matur si raport i *"llogarisë së kapitalit"* me *"totalin e aktiveve"*, në fund të tremujorit të tretë të vitit 2009 ka rënë në nivelin 34.9%, nga 53% në fundvitin 2008 (Grafiku 40). Kjo rënie e theksuar ka ardhur si rezultat i rritjes më të lartë të totalit të aktiveve (32.7%) referuar periudhës në fjalë, ndërkohë që llogaria kapitale ka rënë me rreth 12.7%. Kontribut të rëndësishëm në rritjen e aktiveve e dha zëri i detyrimeve "kredi të marra" me rreth 102.5%, i cili në tremujorin e tretë të vitit 2009 arriti në 11.6 miliardë lekë, nga 5.7 miliardë lekë në fundvitin 2008. Zëri i pasiveve të institucioneve financiare jobanka "kredi të marra" është burim financimi kryesisht nga korporatat depozituese dhe nga institucionet e tjera financiare.

Grafik 39. Rritja e nivelit të aktiveve të institucioneve jobanka sipas tremujorëve në %.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 40. Llogaria kapitale ndaj totalit të aktiveve në %.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 41. Ecuria e kredive në miliardë lekë dhe rritja e tyre në %.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 42. Kredi me probleme ndaj totalit të kredive në %.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Një tregues tjetër që lidhet me nivelin e kapitalizimit dhe që kufizon investimet e institucioneve financiare jobanka në mjete të qëndrueshme është dhe raporti "llogari kapitale/totali i aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara neto", i cili për tremujorin e tretë të vitit 2009, rezulton 427.3% nga 519% në fundvitin 2008. Ky tregues qëndron mbi nivelin e lejuar prej 100%, që është përcaktuar si normë rregullatore për këtë raport.

Portofoli i kredive zë peshën kryesore në totalin e aktiveve të institucioneve financiare jobanka mesatarisht 66.8% për nëntëmujorin e vitit 2009 nga 59.4% që ishte mesatarja për vitin 2008. Zgjerimi i portofolit të kredive evidentohet gjatë tremujorëve të vitit 2009 dhe kryesisht në tremujorin e tretë ai u ngjit në nivelin e 13.5 miliardë lekëve (rreth 28% dhe 34.6% më shumë referuar respektivisht një tremujori më parë dhe tremujorit të fundit të një viti më parë) (Grafiku 41).

Cilësia e portofolit të kredisë e matur si raport i kredive me probleme (në terma bruto) ndaj tepricës së kredisë ka ardhur duke u përmirësuar në baza tremujore, por në rënie krahasuar me fundin e një viti më parë. Në tremujorin e tretë të vitit 2009, kredia me probleme u llogarit në nivelin 4.1% krahasuar me 4.6% një tremujor më parë dhe 3.42 në tremujorin e fundit të vitit 2008 (Grafiku 42). Një tjetër tregues i cilësisë së aktiveve është ai i ndërtuar nga raporti i totalit të aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara neto ndaj totalit të aktiveve, i cili për tremujorin e tretë të vitit 2009 është përmirësuar në vlerën 8.2% nga 13%, që llogaritej një tremujor më parë dhe 10% në tremujorin e fundit të vitit 2008.

Institucionet financiare jobanka kanë përjetuar një rënie të rentabilitetit gjatë vitit 2009. Kështu, fitimi neto i nëntëmujorit 2009 prej rreth 439 milionë lekësh llogaritet 689 milionë lekë (ose -61%) më pak se e njëjta periudhë një vit më parë.

Për sa i përket nivelit të të ardhurave, në fund të nëntëmujorit 2009, ato arritën në 3.8 miliardë lekë, pothuaj në të njëjtin nivel me periudhën ekuivalente një vit më parë, ndërsa shpenzimet llogariten rreth 27% më të larta në krahasim me nëntëmujorin e vitit 2008. Ndër zërat e shpenzimeve, peshën kryesore vazhdojnë ta ruajnë ashtu si dhe një vit më parë, shpenzimet e përgjithshme të veprimtarisë me rreth 40% të totalit të tyre.

AKTIVITETI I SHOQËRIVE TË SIGURIMIT DHE FONDEVE TË PENSIONIT PRIVAT SUPLEMENTAR

Aktiviteti i tregut të sigurimeve, gjatë vitit 2009 ka shënuar rritje në masën 11.3%[27] krahasuar me një vit më parë, mbështetur nga shtimi i numrit të kontratave të sigurimit, vëllimi i primeve si dhe nga investimet e ndërmarra nga shoqëritë e sigurimit në depozita apo pasuri të paluajtshme. Në vitin 2009 u nënshkruan rreth 756 mijë kontrata sigurimi ose rreth 9.2% më shumë se një vit më parë. Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve arritën në rreth 7.8 miliardë lekë më shumë se një vit më parë. Primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zunë 42% dhe ato të sigurimit të detyrueshëm 58% të tregut. Sipas AMF, edhe pse dëmet e paguara bruto nga shoqëritë e sigurimit në total janë ngritur në rreth 1.7 miliardë lekë (ose 13% më shumë se një vit më parë), raporti dëme ndaj prime mbetet në nivelin 22%, nivel i ruajtur për tre vite radhazi.

Aktivet e sektorit të sigurimeve për tremujorin e tretë të vitit 2009, rezultuan 16.9 miliardë lekë, me një ngadalësim të lehtë ndaj një tremujori më parë dhe rreth 9.4% më lart se fundi i vitit 2008. Peshën kryesore në totalin e aktiveve të shoqërive të sigurimit e përbën zëri *"depozita, certifikata depozitash dhe llogari në banka"* me rreth 50%, ndjekur nga zëri *"investime në pasuri të paluajtshme"* me 9.4% dhe zëri *"provigjone teknike"* me 8.2%, ndërsa zëri *"mjete të qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara"* përfaqëson rreth 4.3% të totalit të aktiveve në fund të tremujorit të tretë të vitit 2009 (Grafiku 43).

Grafik 43. Pesha e zërave të aktiveve të shoqërive të sigurimit ndaj totalit të aktiveve në % TIII-09.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Raporti i kapitalit ndaj totalit të aktiveve, i cili mat nivelin e kapitalizimit të shoqërive të sigurimit, për tremujorin e tretë të vitit 2009 ka rënë në nivelin 49%, rreth 2.8 pikë përqindje më i ulët se një tremujor më parë dhe 7.6 pikë përqindje më i ulët se tremujori i fundit i vitit 2008. Krahas këtij treguesi, një tjetër indikator është ai i llogaritur si raport i kapitalit ndaj rezervave teknike, i cili tregon aftësinë për të përvetësuar humbjet si rezultat i ekspozimit ndaj rreziqeve të mundshme. Ky tregues për tremujorin e tretë të vitit 2009 u llogarit në nivelin 125% duke shënuar rënie të ndjeshme në krahasim me një tremujor më parë dhe me tremujorin e fundit të vitit 2008, si rezultat i shtimit të rezervave teknike[28].

Provigjonet teknike, për tremujorin e tretë të vitit 2009 rezultuan 1.3 miliardë lekë duke shënuar një rritje të konsiderueshme prej 26% në krahasim me fundin e vitit 2008.

Fitimi i shoqërive të sigurimit për nëntëmujorin e parë të vitit 2009 rezulton 730 milionë lekë nga 805 milionë lekë, referuar të njëjtës periudhë të një viti më parë. Ngadalësimi i rezultatit financiar është reflektuar edhe në dy

treguesit e kthimit RoA dhe RoE[29], të cilët për nëntëmujorin janë llogaritur përkatësisht 4.4% dhe 2.5%, nga 5.5 dhe 10.7% referuar të njëjtës periudhë të një viti më parë.

AMF ka vijuar të përsosë kuadrin rregullativ të këtij tregu dhe infrastrukturën teknologjike të monitorimit të tij. Në këtë mënyrë, gjatë vitit 2009 janë përpiluar dhe miratuar ligjet dhe rregulloret si më poshtë:

- Ligji nr.10076, datë 12.02.2009 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit". Qëllimi i këtij ligji është përmirësimi i bazës ligjore të sigurimit të detyrueshëm.
- Rregullore nr.36, datë 30.04.2009 "Për regjistrin elektronik të dëmeve të sigurimeve të detyrueshme motorike". Objekt i kësaj rregulloreje është përcaktimi i mënyrës dhe procedurave për raportimin e dëmeve të sigurimeve të detyrueshme përmes regjistrit elektronik të instaluar në serverat e qendrës së informacionit të sigurimeve të detyrueshme.
- Rregullore nr.75, datë 28.08.2009 "Për primet e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit". Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i nivelit të primeve dhe provigjoneve teknike, metodikave për përllogaritjen e primeve dhe provigjoneve teknike të sigurimeve të detyrueshme në sektorin e transportit.

Tregu i pensioneve private suplementare gjatë periudhës janar-dhjetor 2009 është rritur krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë me shtim të numrit të kontribuesve (për vitin 2009 numërohen gjithsej 4,429 kontribues krahasuar me 3,861 që ishin në vitin 2008). Kontributet në vlerë për vitin 2009 arritën në 72.9 milionë lekë nga 53 milionë lekë në vitin 2008, duke shënuar një rritje me rreth 37%.

Përmirësime në kuadrin rregullativ gjatë vitit 2009, janë ndërmarrë nga AMF edhe për tregun e pensioneve private, më konkretisht si më poshtë:

- Ligji nr.10197, datë 10.12.2009 "Për fondet e pensionit vullnetar". Qëllimi i këtij ligji është të vendosë standardet e nevojshme për: a) administrimin me efektivitet të pensionit vullnetar, nëpërmjet diversifikimit të investimeve, me synim rritjen e kontributeve të bëra në fondin e pensionit; b) nxitjen e qëndrueshmërisë, sigurisë dhe mirëqeverisjes së aktiveve të fondit të pensionit etj.
- Rregullore nr.1, datë 28.01.2010 "Për aktivet e lejuara, kufizimet dhe kufirin maksimal të investimit të fondit të pensionit". Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë aktivet e lejuara në të cilat mund të investohet fondi i pensionit, kufizimet dhe kufirin maksimal të lejuar të investimit.

AKTIVITETI I SHOQËRIVE TË KURSIM-KREDITIT (SHKK-TË)

- Shoqëritë e kursim-kreditit (SHKK-të) janë subjekt i licencimit dhe mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë. Duke qenë se ato pranojnë

kontribute nga anëtarët e shoqërive në formën e depozitave, ato raportojnë pranë Bankës së Shqipërisë totalin e aktivitetit, gjendjen financiare dhe normat mbikëqyrëse. Gjatë vitit 2009, kanë kryer veprimtarinë e tyre 135 shoqëri kursim-krediti, krahas 2 unioneve të tyre.

Totali i aktiveve të shoqërive të kursim-kreditit, bashkë me unionet e tyre, në tremujorin e katërt të vitit 2009 u rrit në rreth 8.8 miliardë lekë, vetëm 1.1% më lart se një tremujor më parë dhe rreth 14.5% më lart referuar të njëjtës periudhë një vit më parë. Aktivet e shoqërive të kursim-kreditit bashkë me unionet e tyre, kanë ruajtur pothuaj të njëjtën peshë jomateriale ndaj totalit të sistemit financiar sikurse një vit më parë, rreth 0.9%, megjithatë pesha e tyre ndaj PBB-së së vendit është rritur në 0.77%[30].

Aktiviteti kreditues luan rolin kryesor edhe në tremujorin e katërt të vitit 2009: shoqëritë e kursim-kreditit bashkë me unionet e tyre raportuan 78.6% të totalit të aktiveve të investuara në aktivitetin kredidhënës. Megjithatë, evidentohet rënie e peshës së portofolit të kredive ndaj totalit të aktiveve përgjatë tremujorëve të dytë dhe të tretë për këto shoqëri.

	TIV-08	TI-09	TII-09	TIII-09	TIV-09
Totali i aktiveve (mln lek)	7,657	7,866	8,251	8,670	8,765
Teprica e kredisë (mln lek)	6,284	6,419	6,438	6,634	6,893
Teprica e kredisë/totalit të aktiveve (%)	82.1	81.6	78.03	76.5	78.6
Kredi me probleme (mln lek)	82.4	103.8	118.6	132.1	135.2
Kredi me probleme/tepricës së kredisë (%)	1.31	1.62	1.84	1.99	1.96

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 13. Treguesit e aktivitetit të shoqërive të kursim-kreditit dhe unioneve të tyre sipas tremujorëve.

Treguesi i cilësisë së portofolit të kredisë mbi baza bruto për shoqëritë e kursim-kreditit bashkë me unionet e tyre, ka shënuar një përmirësim të lehtë në fund të vitit 2009, duke rënë në nivelin 1.96% nga rreth 2% që llogaritej një tremujor më parë, megjithatë referuar të njëjtës periudhë një vit më parë cilësia e portofolit ka shënuar rënie (tabela 12). Kjo ka ardhur si rezultat i ritmit më të lartë rritës të huave me probleme (64.2%) ndaj tepricës së kredisë (9.7%), në krahasim me fundin e vitit 2008.

Rezultati neto i shoqërive të kursim-kreditit bashkë me unionet e tyre në fund të vitit 2009 ka rënë në 91.5 milionë lekë nga 109.2 milionë lekë, duke shënuar rënie me rreth 19% krahasuar me një vit më parë.

Nga analiza e mësipërme, konkludohet se shoqëritë e kursim-kreditit bashkë me unionet e tyre kanë zgjeruar aktivitetin përgjatë vitit 2009 mbështetur nga një shtim i numrit të shoqërive anëtare të kursim-kreditit (në 135 nga 133 shoqëri), zgjerim të portofolit të kredive, megjithë cilësinë më të ulët dhe me një ngadalësim të rezultatit financiar referuar vitit të mëparshëm.

6.1 ZHVILLIME TË PËRGJITHSHME NË SISTEMIN BANKAR VENDAS

6.1.1 ECURIA E AKTIV-PASIVEVE DHE PËRBËRJA E TYRE

Në fund të vitit 2009, aktivet e sektorit bankar përbënin 77.5% të Produktit të Brendshëm Bruto (kundrejt rreth 76.7% të një viti më parë) dhe 94.7% të totalit të aktiveve të sektorit financiar. Aktivet e sektorit, në fund të dhjetorit 2009, ishin 886.3 miliardë lekë, në rritje me 6.3% kundrejt fundit të vitit të kaluar[31]. Ecuria e qëndrueshme e aktiveve pasqyron edhe rikthimin e depozitave (duke filluar nga tremujori i dytë 2009), të cilat ishin tërhequr nga sektori bankar për shkak të efekteve psikologjike të krizës financiare ndërkombëtare.

Duke ndjekur ecurinë e periudhave të mëparshme, portofoli i kredive vazhdon të përbëjë pjesën kryesore të aktiveve: në fund të vitit 2009, ky portofol raportohet në vlerën rreth 450 miliardë lekë[32] dhe përbën 50.8% të totalit të aktiveve të sektorit bankar, peshë kjo me një rritje prej 3.2 pikësh përqindje në krahasim me fundvitin e kaluar.

Zërin e dytë për nga pesha në aktivet e sektorit e përbëjnë "Veprimet me thesarin dhe ndërbankare"[33]. Në fund të vitit 2009, ky zë ishte në shifrën 254.3 miliardë lekë, duke përbërë 28.7% të totalit të aktiveve. Element përbërës i grupit "Veprimet me thesarin dhe ndërbankare" janë dhe investimet në bonot e thesarit, në vlerën e 106.3 miliardë lekëve në fund të vitit 2009, të cilat evidentojnë një ecuri të dukshme në rënie përgjatë viteve.

Pesha e zërit "Veprimet me letrat me vlerë" është thuajse e pandryshuar, ndërsa zërat e tjerë të aktiveve kanë në vazhdimësi një volum të pakonsiderueshëm.

Tabelë 14. Pesha e zërave të aktiveve (dhjetor'03 – dhjetor'09).

Pesha ndaj totalit të aktiveve (në%)	Dhjetor '03	Dhjetor '04	Dhjetor '05	Dhjetor '06	Dhjetor '07	Dhjetor '08	Dhjetor '09
1. Veprime me thesarin dhe ato ndërbankare. Nga këto:	76.5	72.4	58.8	50.6	39.5	30.1	28.7
- Marrëdhënie me Bankën Qendrore	8.7	8.7	9.3	8.9	9.0	8.3	7.8
- Bono thesari	49.6	45.8	35.3	26.3	17.1	12.8	12.0
- Marrëdhënie me bankat e tjera	16.2	15.6	12.2	13.2	11.2	6.6	6.5
2. Veprime me klientët (bruto)	13.5	16.4	25.7	31.7	39.4	47.6	50.8
3. Veprime me letrat me vlerë	5.4	7.0	12.2	14.7	18.0	20.0	20.1
4. Mjete të tjera	0.8	0.8	0.7	0.9	1.3	1.0	0.9
5. Mjete të qëndrueshme	1.5	1.9	1.5	1.5	1.5	1.8	1.7
Totali i aktiveve	100	100	100	100	100	100	100

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në anën e detyrimeve evidentohen depozitat e klientëve, në vlerën e 694.3 miliardë lekëve[34], me peshën kryesore prej 78.3% të totalit të pasiveve (tabelë 15). Veçanërisht gjatë vitit 2008, ky zë kishte shënuar rënie prej 7.5 pikësh përqindje, për shkak të fenomenit të tërheqjes së depozitave nga sektori bankar, ndërsa shënohet rikthimi i tyre gjatë vitit 2009.

"Veprime me thesarin dhe ndërbankare"[35] përbën zërin e dytë, për nga pesha ndaj totalit të pasiveve, duke u llogaritur në vlerën e 90 miliardë lekëve në fund të vitit 2009. Pesha në rritje e këtij grupi në krahasim me vitin 2007 është rrjedhojë e financimeve në rritje të bankave të nivelit të dytë nga Banka e Shqipërisë nëpërmjet marrëveshjeve të riblerjes, ndërkohë që viti 2009 evidenton rënie të financimeve të huaja bankare.

"Burimet e përhershme"[36] kanë vijuar peshën në rritje edhe në fund të vitit 2009. "Kapitali i aksionerëve" përbën zërin kryesor të "Burimeve të përhershme". Në fund të vitit 2009, ai kap shifrën 84.8 miliardë lekë, në rritje me 13.4 miliardë lekë, ose 19% kundrejt fundit të vitit 2008. Kapitali i paguar është 60.9 miliardë lekë, 9.7 miliardë ose 19% më shumë se në dhjetor 2008, duke reflektuar faktin që gjatë vitit 2009 në disa banka është kryer injektim kapitali[37] (Tabelë 14).

Tabelë 15. Pesha e zërave të pasiveve (dhjetor '03 – dhjetor '09).

Pesha ndaj totalit të pasiveve (në%)	Dhjetor 2003	Dhjetor 2004	Dhjetor 2005	Dhjetor 2006	Dhjetor 2007	Dhjetor 2008	Dhjetor 2009
1. Veprime me thesarin dhe ato ndërbankare. Nga këto:	4.4	4.5	4.1	7.6	5.7	11.8	10.1
- Marrëdhënie me Bankën Qendrore	0.2	0.2	0.2	0.2	0.0	0.1	0.0
- Bono thesari të përshtatshme për rifinancim me Bankën Qendrore	0.0	0.0	0.0	1.4	0.2	2.4	3.6
- Marrëdhënie ndërbankare	4.2	4.3	4.0	4.0	5.3	9.0	6.2
2. Veprime me klientët (bruto)	88.7	88.1	88.1	84.2	84.9	77.3	78.3
3. Detyrime të tjera	0.7	1.0	0.6	0.8	1.0	1.1	0.6
4. Burimet e përhershme, nga këto:	6.2	6.3	7.2	7.4	8.4	9.6	10.8
- Kapitali i aksionerëve	5.9	6.1	6.6	6.8	7.5	8.6	9.6
Totali i pasiveve	100	100	100	100	100	100	100

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në fund të vitit 2009, Grupi[38] 3 i bankave zë 72.6% të totalit të aktiveve të sektorit bankar, Grupi 2 zë 22.7%, ndërsa Grupi 1 zë 4.7% të tij. Gjatë vitit 2009, grupet e bankave sipas madhësisë së aktivitetit nuk e kanë ndryshuar përbërjen e tyre. Pesha e Grupit 3 është pakësuar me vetëm 1 pikë përqindje kundrejt fundit të vitit 2008 dhe po me të njëjtën madhësi është rritur pesha e Grupit 1 të bankave. Ndërkohë, kontributi i Grupit 2 në totalin e aktiveve të sektorit bankar mbetet i pandryshuar. Sektori bankar shqiptar, në terma të shpërndarjes së aktiveve, vazhdon të mbetet i përqendruar.

6.1.2 PËRBËRJA E BILANCIT SIPAS VALUTAVE DHE POZICIONI I HAPUR NETO NË VALUTË

Në fund të vitit 2009, aktivet e sektorit bankar në valutë të huaj zinin rreth 50.2% të totalit të aktiveve, 1.3 pikë përqindje më shumë se në fundin e vitit të kaluar. Detyrimet e sektorit bankar në valutë të huaj zinin rreth 49% të totalit të aktiveve, 0.4 pikë përqindje më shumë se në dhjetor 2008.

Historikisht, aktivet dhe pasivet në valutë të sektorit bankar kanë qenë në vlera të përafërta, siç mund të vërehet edhe në Tabelë 16. Sidoqoftë, duke

filluar nga qershori 2009, pesha e aktiveve në valutë e ka tejkaluar atë të detyrimeve, me një diferencë prej 1 pikë përqindjeje, e cila ka ardhur në rritje në tremujorin e tretë dhe në atë të fundit të vitit[39].

Gjithsesi, veprimtaria e sektorit bankar në valutë vlerësohet e ekuilibruar, ndërsa volumi në rritje tregon për burime më të shumta të financimit në valutë të huaj kundrejt atyre në monedhën vendase.

Tabelë 16. Pesha e aktiveve dhe detyrimeve në valutë ndaj totalit të aktiveve të sektorit bankar, në përqindje (dhjetor'05 – dhjetor'09).

Periudha	Aktive në valutë	Detyrime në valutë	Diferenca (1) - (2)
Dhjetor 2005	41.1	41	0.1
Mars 2006	41.5	41	0.5
Qershor	41.6	41.6	0
Shtator	43.3	43.2	0.1
Dhjetor 2006	44.2	44	0.2
Mars 2007	45.6	45.2	0.4
Qershor	45.7	45.7	0
Shtator	46.6	46.5	0.1
Dhjetor 2007	46.8	46.9	-0.1
Mars 2008	47.9	47.7	0.2
Qershor	48	48.1	-0.1
Shtator	50.6	50.2	0.4
Dhjetor 2008	48.9	48.5	0.4
Mars 2009	50.2	49.7	0.5
Qershor	48.4	47.5	0.9
Shtator	49.5	48.3	1.2
Dhjetor 2009	50.2	48.9	1.3

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në fund të vitit 2009, pozicioni i hapur neto në valutë i sektorit bankar përbënte rreth 4% të kapitalit bazë (Grafiku 44.a). Ky tregues, edhe gjatë vitit 2009, ka vijuar të qëndrojë brenda intervalit "në blerje" 0 – 10% (Grafiku 44.b).

Grafik 44. Ekspozimi ndaj rrezikut të kursit të këmbimit për sektorin bankar dhe grupet e bankave sipas madhësisë së aktivitetit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Vlerat e pozicionit të sektorit bankar në valutë të huaj janë të moderuara dhe si pasojë mbartin një rrezik potencial të moderuar nga efektet e luhatjeve të kursit të këmbimit.

6.1.3 PËRBËRJA SIPAS AFATIT TË MATURIMIT

Në fund të vitit 2009, aktivet e sektorit bankar kishin një afat maturimi[40] mesatar të mbetur prej 29.5 muajsh, nga 31.8 muaj, që shënoi në fund të vitit të mëparshëm. Në të njëjtën periudhë, maturimi[41] mesatar i mbetur i pasiveve të sektorit bankar llogaritet prej rreth 11.6 muaj, nga 9.7 muaj në fund të vitit 2008. Ecuria e maturimit mesatar të aktiveve dhe pasiveve paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

Nga Grafiku 45, vihet re se në fund të vitit 2009 diferenca *(gap-i)* në maturim midis aktiveve dhe detyrimeve është ngushtuar në 17.9 muaj nga 22.1 muaj që llogaritej të njëjtën periudhë një vit më parë. Ngushtimi i diferencës ka ardhur si rezultat i përmirësimit të strukturës të aktiveve dhe detyrimeve sipas maturitetit të mbetur, që tregon angazhimin e sektorit bankar në minimizimin e mospërputhjes midis tyre.

Në lidhje me vlerësimin e maturimit të zërave të veçantë të bilancit, jemi përqendruar tek depozitat dhe kreditë, si produktet që ndikojnë më tepër diferencën e maturimit të zërave të bilancit. Në fund të tremujorit të katërt të vitit 2009, depozitat paraqesin një afat maturimi mesatar[42] prej rreth 4.74 muajsh, pa shënuar ndryshime të qenësishme referuar të njëjtës periudhë një vit më parë. Në fund të vitit 2009, maturimi mesatar[43] i portofolit të kredisë ka rënë në 44.7 muaj, krahasuar me 47.4 muaj referuar të njëjtës periudhë një vit më parë. *Ecuria në rënie e maturimit mesatar të portofolit të kredisë ka ndikuar në ngushtimin e gap-it sipas maturimit të mbetur të aktiv-pasiveve të sektorit bankar.*

6.1.4 ZËRAT JASHTË BILANCIT

Në fund të vitit 2009, zërat jashtë bilancit shënuan vlerën prej 833.5 miliardë lekësh (rreth 92 miliardë

Grafik 45. Maturimi mesatar i mbetur aktiveve dhe pasiveve (në muaj).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 46. Maturimi mesatar i mbetur i depozitave (në muaj).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 47. Maturimi mesatar i mbetur i kredisë (në muaj).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

lekë ose 12.4% më shumë se një vit më parë), duke përbërë 94% të totalit të aktiveve të sektorit bankar.

Faktori kryesor i rritjes së zërave jashtë bilancit shpjegohet me rritjen e "garancive të marra klientëve[44]" gjatë vitit 2009, me rreth 128 miliardë lekë ose 21%, gjë që flet për masat më të shtrënguara të bankave në lidhje me kreditimin.

Ndër zërat jashtë bilancit, evidentohen detyrimet ("angazhime të marra[45]" dhe "garanci të marra") me peshë mbizotëruese, rreth 91.5% e totalit, nga 86.2% një vit më parë. Ndër detyrimet jashtë bilancit, në fundvitin 2009, "garancitë e marra klientëve" llogariten rreth 98% e totalit të tyre, ndërkohë që "angazhimet e marra" shënojnë rënie me 4.8 miliardë lekë ose 22% në krahasim me fundin e vitit 2008. Reduktimi i zërit "angazhime të marra" nga jorezidentët konfirmon ngushtimin e burimeve të huaja të financimit për sektorin bankar vendas, gjatë vitit 2009.

Ndërkohë, në kahun e aktiveve jashtë bilancit, "angazhimet dhe garancitë e dhëna" llogariten rreth 6% e totalit të zërave jashtë bilancit. Krahasuar me fundvitin 2008, dallohet volum i njëjtë i "angazhimeve të dhëna", ndërsa "garancitë" shënojnë rënie me rreth 6 miliardë lekë ose 23%.

Elementi i rrezikut ndër zërat jashtë bilancit gjenerohet tek "transaksionet valutore: valutë e blerë/shitur sipas kontratave me afat" dhe tek "angazhimet për instrumente financiare". Këto llogari, në fundvitin 2009, përbëjnë vetëm 2.4% të totalit të zërave jashtë bilancit, nga rreth 7% në fundvitin 2008, ngjarje që tregon minimizimin e ekspozimit të sektorit bankar ndaj rreziqeve, që lidhen me zërat jashtë bilancit.

6.1.5 SHPËRNDARJA E INVESTIMEVE DHE CILËSIA

Grafik 48. Ecuria e zërave të aktivit në mln Lekë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Shpërndarja e investimeve në sistemin bankar pasqyron ecurinë e zërave përbërës të aktivit në periudha të ndryshme, për të parë në këtë mënyrë orientimin e investimeve dhe nivelin e rrezikut që ka sipërmarrë sektori bankar gjatë ushtrimit të veprimtarisë. Në lidhje me ecurinë e zërave të aktiveve në Grafikun 48 paraqiten gjendjet "stok" të tyre.

Vihet re se aktivet e sistemit bankar i janë rikthyer trendit rritës në tremujorin e tretë të vitit 2009, rritje e cila ka vijuar edhe në tremujorin e katërt të vitit. Konkretisht, zëri *"veprime me klientë bruto"* që përfaqëson aktivitetin kreditues, u rrit me rreth 13% referuar të njëjtës periudhë një vit më parë, duke përftuar rreth 99.5% të rritjes vjetore të aktiveve të sektorit bankar.

Zëri "veprime me thesarin dhe ndërbankare" është rritur me rreth 1.2%, duke dhënë një kontribut vjetor vetëm me 5.6% në rritjen e aktiveve të sistemit.

Zëri "veprime me letrat me vlerë" ka shënuar rritje rreth 6.6% referuar të njëjtës periudhë një vit më parë. Ky zë përfitoi rreth 21% të rritjes vjetore të aktiveve të sistemit bankar.

Efekt negativ në rritjen e aktiveve dhanë zërat "mjete të tjera" dhe "fonde rezervë të krijuara"[46], përkatësisht me ndikim vjetor prej -0.6% dhe – 23%. Zërat e tjerë "mjete të qëndrueshme" dhe "interesa të përllogaritur" nuk kanë shënuar zhvillime të qenësishme.

Kontributin më të lartë vjetor në rritjen e aktiveve nga zërat e burimeve për vitin 2009, e dhanë "Veprimet me klientët" (që përfaqësojnë aktivitetin depozitues) dhe "Burimet e përhershme" përkatësisht me rreth 96% dhe 30%, mbi mesataret e tyre historike[47] të llogaritura në nivelet 37% dhe 28.4%. Ndërkohë, zërat e tjerë të pasivit dhanë kontribut negativ në rritjen e aktiveve, ku veçojmë kryesisht zërin "Veprime me thesarin dhe ndërbankare" me -16.9% dhe zërin "Detyrime të tjera" me -7.3%, shifra këto nën mesataren historike të llogaritur për këto dy zëra.

Grafik 49. Kontributi në rritjen e aktiveve nga burimet në %.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Për të vlerësuar nivelin e rrezikut të investimeve të bankave, analizojmë ecurinë e aktiveve me rrezik të sektorit bankar (Grafiku 50).

Aktivet me rrezik të sektorit bankar kanë vijuar trendin rritës përgjatë gjithë vitit 2009, duke u ngjitur kështu në nivelin 502.8 miliardë lekë në fund të vitit 2009, duke përbërë në këtë mënyrë rreth 56.7% të totalit të aktiveve, nga 40.8% referuar të njëjtës periudhë një vit më parë. Kjo peshë në rritje, kryesisht me bazë vjetore, u shkaktua jo vetëm si rezultat i rritjes së konsiderueshme të aktiveve me normë të lartë ponderimi me rrezik, por edhe për pasojë të një ritmi rritjeje relativisht të ulët të aktiveve të sistemit bankar (6.25%).

Grafik 50. Aktivet me rrezik dhe portofoli i kredisë, ndaj totalit të aktiveve në %.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ecuria e aktiveve me rrezik përcaktohet kryesisht nga ecuria e portofolit të kredisë, i cili në dhjetor të vitit 2009 përfaqësonte 50.7% të totalit të aktiveve, shumë pranë peshës së një tremujori më parë dhe 47.6% një vit më parë. Për sa i përket grupeve sipas madhësisë së aktivitetit, raporti i "aktiveve me rrezik ndaj totalit të aktiveve" ka shënuar rritje të konsiderueshme në bazë vjetore për Grupin 2

Grafik 51. Aktivet me rrezik ndaj totalit të aktiveve, sipas grupeve të bankave në %.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 52. Pesha e portofolit të kredisë ndaj totalit të aktiveve, sipas grupeve të bankave (në %).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 53. Kredia e re (majtas) dhe përdorimi i kredisë (djathtas).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

(nga 45.9% në dhjetor 2008 në 73.5% në dhjetor 2009) dhe për Grupin 3 (nga 37.7% në 47.3% në dhjetor 2009), pasi edhe portofoli i kredive për bankat e këtyre grupeve është zgjeruar me ritme më të shpejta (për bankat e Grupit 2: nga 61.6% e totalit të aktiveve në dhjetor 2008, në rreth 68.3% në dhjetor 2009; për bankat e Grupit 3 është rritur nga 43.3% në 52.3% të totalit të aktiveve në dhjetor 2009).

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar karakteristikave të portofolit të kredisë duke analizuar në mënyrë të detajuar ritmin e rritjes së kredisë dhe përdorimin e saj; përbërjen e portofolit të kredisë sipas natyrës së huamarrësit, sipas valutave, sipas kohëzgjatjes, sipas shpërndarjes sektoriale; ecurinë e kredisë me probleme si dhe mbulimin me kolateral. Në vazhdim do të paraqesim këto karakteristika për kredinë e re dhe për kredinë "stok".

Gjatë vitit 2009, sektori bankar dha kredi të re në masën 224 miliardë lekë[48], duke shënuar një rënie prej 52.8 miliardë lekësh (ose 19.1%) referuar vitit 2008. Sipas monedhave origjinale, evidentohet rënie e kredisë së re në monedhën vendase me 14.6 miliardë lekë (ose rreth 14%), rënie e kredisë së re në valutë përkatësisht me 76 milionë dollarë (ose 27.8%), 333.7 milionë euro (ose 27.6%) dhe në monedha të tjera me rreth 472 milionë lekë (ose 79%), krahasuar me të njëjtën periudhë një vit më parë.

Gjatë vitit 2009, sektori bankar mblodhi kredi në masën 182.3 miliardë lekë, nga 176 miliardë lekë një vit më parë.

Raporti i kredisë së mbledhur me kredinë e dhënë, përfaqëson treguesin e përdorimit të kredisë. Për fundin e muajit dhjetor 2009, ky raport ishte 77.8% nga 86.3% në shtator 2009 dhe 73.6%, referuar të njëjtës periudhë të një viti më parë (Grafiku 53).

Nga grafiku vihet re se në tremujorin e tretë të vitit 2009, përdorimi i kredisë ka arritur nivelin më të lartë në 97%. Njëkohësisht, vërehet se ky tregues ka marrë vlerën më të ulët në tremujorin e parë të vitit 2009, rezultat ky i kushtëzuar nga rënia e të dy komponentëve, kredi e re dhe kredi e mbledhur në atë periudhë. Mesatarja e këtij treguesi që

prej muajit mars 2006 është llogaritur në nivelin 64.8%.

Në grafikun 54 paraqitet niveli i kredisë së re në çdo tremujor sipas viteve, në raport me vlerën e tij në tremujorin e parë të vitit 2006.

Nga grafiku i mësipërm konstatohet rënie e ritmit të kredisë së re gjatë tremujorëve të vitit 2009, krahasuar me një vit më parë. Në këtë mënyrë, në tremujorin e katërt të vitit 2009, sektori bankar dha 1.9 herë më shumë kredi të re se periudha bazë (mars 2006), ndërkohë që referuar të njëjtës periudhë një vit më parë, sektori bankar dha rreth 2.4 herë më shumë.

Sipas grupeve të përdoruesve, gjatë vitit 2009, sektori i biznesit përfitoi rreth 82% të kredisë së re, ndërsa shpërndarja sipas mënyrës së përdorimit për këtë sektor, jepet në Grafikun 55.

Nga ky grafik vihet re se peshën kryesore të kredisë së re akorduar nga sektori i biznesit në tremujorin e katërt, e zë kredia e re në formën "overdraft" rreth 56.2%, nga 46.1% e llogaritur një tremujor më parë, dhe 51.6% referuar të njëjtës periudhë një vit më parë. Njëkohësisht, konstatojmë se kredia e re për këtë kategori në tremujorin e katërt rezulton mbi mesataren e llogaritur për periudhën mars 2007-dhjetor 2009, rreth 45.4%. Në lidhje me kategoritë e tjera, vihet re rënia e peshës së kredisë së re akorduar për "investime për pasuri të paluajtshme" në 7.6% nga 13.5%, që është mesatarja e llogaritur për këtë kategori.

Shpërndarja e kredisë së re sipas mënyrës së përdorimit për individët/familjet, paraqitet në Grafikun 57.

Gjatë vitit 2009, vihet re se kredia e re dhënë individëve është përqendruar kryesisht në kategorinë "investime në pasuri të paluajtshme", megjithëse ka shënuar një ngadalësim të ndjeshëm në tremujorin e katërt të vitit, ku pesha e kredisë së re akorduar për këtë kategori ra në 35.9% nga 49.4% një tremujor më parë dhe 42.9% referuar të njëjtës periudhë një vit më parë. Kredia e re akorduar për këtë kategori ka rënë njëkohësisht

Grafik 54. Kredia e re sipas tremujorëve në vite (Mars '06=1).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 55. Shpërndarja e kredisë së re të bizneseve sipas qëllimit të përdorimit (në %).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 56. Shpërndarja e kredisë së re për biznesin në %.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 57. Shpërndarja e kredisë së re për individët sipas qëllimit të përdorimit (në %).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

poshtë mesatares së llogaritur për periudhën, 48.4% (Grafiku 58). Në tremujorin e fundit të vitit 2009, evidentohet rritje e peshës së kredisë së re të akorduar "për konsum të mallrave jo të qëndrueshëm" në nivelin 19.1%, duke shënuar kështu peshën më të lartë për këtë kategori në harkun kohor prej 3 vitesh.

Në lidhje me përbërjen sipas monedhave, në tremujorin e katërt të vitit 2009 peshën kryesore e zë kredia e re akorduar në euro rreth 55.4%, nga 54.6% që është mesatarja e periudhës. Kredia e re akorduar në lek ka zënë rreth 37.2% të kredisë së re, pranë mesatares së periudhës prej 36.5%. Ndërkohë, vërehet rënia e peshës së kredisë së re në monedhën amerikane, në nivelin 7.4%, poshtë vlerës së llogaritur në fundin e vitit 2008 prej 12.6% dhe mesatares prej 8.6%.

Grafik 58. Shpërndarja e kredisë së re për individët në %, Dhjetor 2009.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Sipas afatit të përdorimit, gjatë vitit 2009, kredia e re afatshkurtër rezultoi 139.7 miliardë lekë, rreth 10.7 miliardë lekë ose 7% më pak se një vit më parë. Njëkohësisht, për të njëjtën periudhë vihet re një zhvendosje e kredisë së re nga ajo afatgjatë drejt asaj afatmesme. Konkretisht, kredia e re afatgjatë rezultoi 38.6 miliardë lekë, ndërsa ajo afatmesme 46.6 miliardë lekë. Sipas tremujorëve, kredia e re afatshkurtër ka shënuar peshën më të madhe në tremujorin e katërt të vitit 2009 me rreth 66%, kredia e re afatmesme dhe ajo afatgjatë në tremujorin e dytë të vitit përkatësisht 23% dhe 21%.

Në mënyrë më të detajuar, për sektorin e biznesit dhe për individët, përbërja e kredisë së re gjatë tremujorit të katërt të vitit 2009 sipas përdorimit dhe valutës, jepet në Tabelën 16.

Tabelë 17. Të dhënat e kredisë së re, për tremujorin e katërt të vitit 2009.

Biznesi (000 lekë)	48,764,018	%	Individët (000 lekë)	8,968,482	%
lekë	16,063,969	32.94	lekë	5,419,264	60.43
Overdraft	9,171,303	57.09	Overdraft	893,426	16.49
Kapital qarkullues	4,563,847	28.41	Konsum i mallrave jo të qëndrueshëm	1,263,645	23.32
Investime në blerje pajisjesh	1,763,647	10.98	Konsum i mallrave të qëndrueshëm	662,615	12.23
Investime për pasuri të paluajtshme	565,171	3.52	Për pasuri të paluajtshme	1,663,008	30.69
usd	4,143,841	8.50	Për ushtrim aktiviteti	936,569	17.28
Overdraft	2,131,298	51.43	usd	128,714	1.44
Kapital qarkullues	1,473,064	35.55	Overdraft	19,326	15.01
Investime në blerje pajisjesh	513,991	12.40	Konsum i mallrave jo të qëndrueshëm	16,678	12.96
Investime për pasuri të paluajtshme	25,488	0.62	Konsum i mallrave të qëndrueshëm	60,904	47.32
euro	28,556,209	58.56	Për pasuri të paluajtshme	22,908	17.80
Overdraft	16,105,434	56.40	Për ushtrim aktiviteti	8,898	6.91
Kapital qarkullues	4,419,365	15.48	euro	3,408,531	38.01
Investime në blerje pajisjesh	4,895,490	17.14	Overdraft	651,494	19.11
Investime për pasuri të paluajtshme	3,135,919	10.98	Konsum i mallrave jo të qëndrueshëm	431,456	12.66
Monedha të tjera	-	-	Konsum i mallrave të qëndrueshëm	240,459	7.05
			Për pasuri të paluajtshme	1,541,749	45.23
			Për ushtrim aktiviteti	543,373	15.94
			Monedha të tjera	11,974	0.13

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në lidhje me shpërndarjen e kredisë së re sipas sektorëve të ekonomisë për vitin 2009, 35.9% ka shkuar në mbështetje të sektorit të tregtisë, riparimit të automjeteve dhe artikujve shtëpiakë nga 26% një vit më parë; rreth 14.3% e kredisë së re është drejtuar në sektorin e ndërtimit nga 12.3% një vit më parë; rreth 3% e kredisë së re është drejtuar në sektorin e transportit, magazinimit dhe telekomunikacionit nga 9.7% një vit më parë dhe rreth 11.8% i është drejtuar sektorit të industrisë përpunuese nga 8.8% një vit më parë. Në këtë mënyrë, konstatojmë se sektori bankar gjatë vitit 2009, ka mbështetur më shumë me financim sektorin e industrisë përpunuese, atë të tregtisë dhe më pak sektorin e transportit.

Në lidhje me zhvillimet e vlerës "stok" të portofolit të kredisë, në fund të vitit 2009, konstatohet se teprica e kredisë së sektorit bankar është ngjitur në vlerën 449.8 miliardë lekë, duke përfaqësuar rreth 39.3% të Produktit të Brendshëm Bruto (PBB-së). Rritja e kredisë është ndikuar nga rritja e kredisë në lekë dhe zhvlerësimit të monedhës vendase kundrejt monedhës amerikane dhe asaj evropiane.

Rreth 70.3% e tepricës së kredisë është dhënë në valutë të huaj dhe 29.7% në monedhën vendase. Sipas afateve, kredia afatshkurtër rezultoi rreth 33% e tepricës së kredisë, kredia afatmesme rreth 20% dhe kredia afatgjatë rreth 47%, duke u luhatur lehtësisht me muajin shtator 2009 dhe të njëjtën periudhë një vit më parë.

Në grafikun 59, paraqitet shpërndarja e tepricës së kredisë sipas sektorit publik, bizneseve dhe individëve.

Grafik 59. Shpërndarja e kredisë, Dhjetor 2009.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Teprica e kredisë së përfituar nga sektori i biznesit në fund të vitit 2009, rezultoi rreth 291 miliardë lekë, me një rritje prej 14.6% në krahasim me fundvitin 2008. Rreth 139.7 miliardë lekë nga teprica e kredisë i takojnë sektorit të individëve, i cili shënoi rritje vjetore prej rreth 4.1%.

Nga kredia për sektorin e biznesit në fund të vitit 2009, rreth 96.7 miliardë lekë[49] ose 33.2% janë në formën *"overdraft"*, mbi peshën mesatare për periudhën *(mars 2007-dhjetor 2009)* prej 28.7%[50] për këtë kategori.

Grafik 60. Pesha e tepricës së kredisë së bizneseve sipas qëllimit të përdorimit ndaj tepricës së kredisë totale të bizneseve në %.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në periudhën kohore prej tre vjetësh, teprica e kredisë dhënë bizneseve është përqendruar në formën "overdraft" dhe "investime për pasuri të paluajtshme". Ndërkohë, kredia e dhënë për "kapital qarkullues" dhe "investime në blerje pajisjesh" shënon rënie të rëndësisë së saj ndaj totalit të tepricës së dhënë bizneseve.

Në shpërndarjen e tepricës së kredisë dhënë individëve, sipas qëllimit të përdorimit[51], evidentohet kredia e akorduar *"për pasuri të paluajtshme"* me peshën kryesore prej 70% dhe me një rritje prej 10.6% në krahasim me tepricën e një viti më parë.

Në harkun kohor prej tre vitesh, teprica e kredisë dhënë individëve shfaq: zhvendosje drejt kredisë "për konsum të mallrave jo të qëndrueshëm", rënie të konsiderueshme të kredisë "për konsum të mallrave të qëndrueshëm", rënie më të lehtë të kredisë për "ushtrim aktiviteti" dhe qëndrueshmëri të kredisë "për pasuri të paluajtshme".

Në Tabelën 18 më poshtë, paraqitet pesha e tepricës së kredisë për sektorin e individëve sipas qëllimit të përdorimit:

Tabelë 18. Pesha e tepricës së kredisë së individëve sipas qëllimit të përdorimit ndaj tepricës së kredisë totale të individëve, në përqindje.

Individët	TI-07	TII-07	TIII-07	TIV-07	TI-08	TII-08	TIII-08	TIV-08	TI-09	TII-09	TIII-09	TIV-09	Mesatarja
Overdraft	4.81	4.86	5.06	4.4	4.5	4.6	4.8	5.6	4.95	5.16	4.42	4.40	4.80
Konsum i mallrave jo të qëndrueshëm	2.1	2.3	2.4	2.04	2.1	2.03	3.4	2.9	11.42	11.82	11.74	11.48	5.48
Konsum i mallrave të qëndrueshëm	17.7	19	19.1	19	17.3	17	16.4	16.6	6.14	6.39	5.90	5.89	13.87
Investime pasuri te paluajtshme	62	61.1	62.4	63.9	65.7	66.2	65.7	65.9	68.52	68.28	69.97	70.05	65.81
Ushtrim aktiviteti	13.3	12.6	11.1	10.6	10.4	10.1	9.6	8.9	8.97	8.35	7.97	8.19	10.01

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në fund të vitit 2009, kredia që ka shkuar për konsum të pastër, e identifikuar si kredi e dhënë për individët në formën "overdraft", për konsum të mallrave jo të qëndrueshëm dhe të qëndrueshëm, vlerësohet 30.4 miliardë lekë ose rreth

7% e totalit të portofolit të kredisë, 22% e portofolit të kredisë dhënë individëve dhe rreth 2.7% e PBB-së. Kredia e përdorur për qëllime investimi (blerje pajisjesh dhe ushtrim aktiviteti) vlerësohet rreth 88.5 miliardë lekë ose 20.5% e totalit të portofolit të kredisë dhe 7.7% e PBB-së. Kredia e përdorur për investime në pasuri të paluajtshme (biznese dhe individë) vlerësohet 165.7 miliardë lekë ose rreth 14.5% e PBB-së së vendit.

Përbërja e portofolit të kredisë sipas përdorimit jepet në Grafikun 61.

Grafik 61. Shpërndarja e kredisë (në % ndaj totalit) Dhjetor 2009.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Për sa i përket shpërndarjes gjeografike, veprimtaria krediduese e sektorit bankar është përqendruar kryesisht në rrethet Tiranë, Durrës, Elbasan, Shkodër, Vlorë dhe Fier. *Në fund të vitit 2009, pesha e kredisë për këto rrethe ndaj totalit të kredisë, llogaritej 88.9%.* Aktiviteti kreditues është kryesisht i përqendruar në rrethin e Tiranës me peshën mesatare[52] më të lartë të tepricës së kredisë ndaj totalit të dhënë gjithsej, rreth 68%, ndjekur nga qyteti i Durrësit me rreth 7.6%. Pesha mesatare më e ulët evidentohet në qytetin e Shkodrës me 2.6%. Në grafikun 62 më poshtë jepet shpërndarja e peshës mesatare për rrethet kryesore ku është përqendruar veprimtaria krediduese.

Grafik 62. Pesha mesatare e kredisë për rrethet kryesore të vendit në % (T4/07-T4/09).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në lidhje me shpërndarjen e kredisë sipas sektorëve të ekonomisë për tremujorin e katërt të vitit 2009, konstatojmë se peshën kryesore të totalit të kredisë për secilin rreth e zë kryesisht kredia

Grafik 63[53]. Pesha mesatare e kredisë sipas afateve për rrethet kryesore të vendit në % (T4/07-T4/09).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 64. Shpërndarja e kredisë sipas sektorëve të ekonomisë për rrethet kryesore të vendit në % (TIV-2009).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

akorduar sektorit të tregtisë. Megjithatë veçojmë rrethin e Elbasanit ku kredia është përqendruar në nivel të lartë në sektorin e industrisë (21.7%), rrethin e Shkodrës për sektorin e ndërtimit (16.4%) dhe me më pak financim janë mbështetur sektorët e bujqësisë dhe transportit për secilin rreth të vendit (Grafiku 64).

6.1.6 CILËSIA E KREDISË

Gjatë vitit 2009, cilësia e portofolit të kredisë ka shënuar rënie. Raporti i kredive me probleme ndaj totalit të portofolit të kredisë, mbi baza bruto, në fund të vitit u ngrit në nivelin 10.5%, kundrejt 9.75% në tremujorin e tretë të vitit dhe 6.6% në fund të vitit 2008 (Grafiku 65).

Grafik 65. Hua me probleme (bruto) ndaj totalit të huave në %.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Vetëm gjatë tremujorit të katërt të vitit, kreditë me probleme të sektorit bankar u rritën me rreth 4.5 miliardë lekë ose 10.4% krahasuar me një tremujor më parë. Ndërkohë, teprica e kredisë në të njëjtën periudhë u rrit me rreth 2.8%. Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2008, kreditë me probleme u rritën me rreth 20.8 miliardë lekë ose 78.9%, ndërsa teprica e kredisë u rrit me 13.4%. Kjo ngjarje konfirmon ndikimin kryesor të ritmit të ulët rritës të tepricës së kredisë gjatë vitit 2009, në përkeqësimin e raporteve që masin cilësinë e këtij portofoli.

Sipas kategorive të klasifikimit vërehet që në fund të vitit 2009, rreth 75% e portofolit të kredisë konsiderohet "standard" nga 78.3% që përfaqësonte kjo kategori në të njëjtën periudhë një vit më parë. Ndërkohë, evidentohet zhvendosje e kredisë në klasat me cilësi më të ulët, konkretisht "hua të dyshimta" dhe "hua të humbura", pesha të cilave llogaritet 2.7% dhe 3%, nga 1.4% dhe 1.3% referuar fundit të vitit 2008.

Grafik 66. Hua me probleme ndaj totalit të huave sipas grupeve të bankave (në %).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Për sa i përket grupeve sipas madhësisë së aktivitetit, për tremujorin e katërt të vitit 2009, bankat e përfshira në Grupin 2 kanë shënuar rritjen më të madhe të treguesit "hua me probleme ndaj totalit të huave" referuar të njëjtës periudhë një vit më parë, me rreth 5.5 pikë përqindje duke u ngjitur në 13%. Bankat e Grupit 1 kanë shënuar rritjen më të ulët vjetore me vetëm 1.4 pikë përqindje, duke arritur nivelin 4.9% (Grafiku 66).

Sipas grupeve të përdoruesve, cilësia e portofolit të kredisë ka rënë si për bizneset dhe për individët.

Raporti i kredive me probleme ndaj tepricës së kredisë, për bizneset dhe individët llogaritet përkatësisht 12.4% dhe 8.2%, krahasuar me 7.6% dhe 5.5% në fund të vitit 2008.

Sipas monedhës, në fund të vitit 2009, raporti i "kredive me probleme në lekë /tepricës së kredisë në lekë" dhe raporti i "kredive me probleme në valutë/tepricës së kredisë në valutë" u llogaritën në nivele të përafërta rreth 10%, respektivisht nga 7.5% dhe 6.3% referuar fundit të vitit 2008. Rënia e cilësisë së portofolit të kredisë në lek me bazë vjetore, ka ardhur si rezultat i ritmit më të lartë të rritjes së huave me probleme (67%) se rritja e tepricës në lekë (23%).

Një tregues tjetër që vlerësohet për analizimin e cilësisë së portofolit në valutë është raporti i tepricës me probleme në valutë, kredimarrësit e së cilës janë të pambuluar nga luhatjet e kursit të këmbimit. Konkretisht, në fund të vitit 2009, raporti "hua me probleme në valutë, ku kredimarrësi është i pambuluar nga kursi i këmbimit/teprica e kredisë në valutë, ku kredimarrësi është i pambuluar nga kursi i këmbimit" rezultoi 9.6% kundrejt 5.9% në fund të vitit 2008, çka tregon për efektin negativ të zhvlerësimit të kursit të këmbimit në cilësinë e portofolit të kredisë[54].

Cilësia e portofolit të kredisë në fund të vitit 2009 ka rënë ndjeshëm për disa prej sektorëve kryesorë të ekonomisë. Raporti më i lartë i huave me probleme ndaj tepricës së kredisë është shënuar për sektorin e industrisë rreth 15.8% nga 6.7%, që ishte në fund të vitit 2008, ndjekur nga sektori i ndërtimit me 13.9% kundrejt 7.6% një vit më parë. Në grafikun e mëposhtëm paraqitet ecuria e cilësisë së portofolit të kredisë edhe për sektorë të tjerë të ekonomisë ku vërehet qartë trendi rritës i këtij raporti në fund të vitit 2009.

Grafik 67. Cilësia e portofolit të kredisë sipas sektorëve të ekonomisë në %.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Për të vlerësuar aftësinë e sektorit bankar për të përballuar humbjet e paparashikuara, që vijnë si rezultat i aktivitetit të kreditimit, llogariten raportet e kredive me probleme në terma neto ndaj treguesve të kapitalit. Në fund të vitit 2009, raportet e kredive me probleme neto ndaj elementeve të kapitalit kanë shënuar rritje krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke nënkuptuar rritje të rrezikut që lidhet me kreditë me probleme. Konkretisht, në fund të vitit 2009, raporti "kredi me probleme neto ndaj kapitalit bazë" u ngjit në nivelin 29.9%, rreth 7 pikë përqindje më i lartë se raporti i një viti më parë. Raportet "kredi me probleme neto ndaj kapitalit rregullator" dhe "kredi me probleme neto ndaj kapitalit aksioner" u llogaritën përkatësisht 28% dhe 27%, duke u rritur të dy me rreth 6 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë (Grafiku 68).

Grafik 68. Hua me probleme neto ndaj kapitalit rregullator në %.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 69. Hua me probleme neto ndaj kapitalit bazë sipas grupeve të bankave në %.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 70. Ecuria e raportit të mbulimit të kredive me probleme me provigjone sipas tremujorëve në %.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Sipas grupeve të bankave, në fund të vitit 2009, rritjen më të lartë në nivel mesatar për treguesit *"kredi me probleme neto ndaj kapitalit"* e shfaqin bankat e Grupit 2, ku treguesi llogaritet në nivelin 47.6%, me një rritje prej rreth 16.8 pikë përqindje në krahasim me fundin e një viti më parë. Bankat e Grupit 3 kanë shënuar një rritje kryesisht graduale në nivel mesatar në 25.8%, nga 22.3% që llogaritej një vit më parë. Për bankat e Grupit 1, rritja e treguesit të mësipërm në nivel mesatar mbetet i ulët rreth 1.4 pikë përqindje. Në nivel specifik, grupet e bankave sipas madhësisë së aktivitetit kanë shënuar rritje të qenësishme kryesisht për raportin "hua me probleme neto ndaj kapitalit bazë" krahasuar me një vit më parë (Grafiku 69).

6.1.7 FONDET REZERVË PËR HUMBJET NGA KREDITË (PROVIGJONET) DHE MBULIMI ME KOLATERAL

Në kuadër të rënies së cilësisë së kredisë, sektori bankar ka rritur me ritme të shpejta fondet e nevojshme rezervë (provigjonet), të cilat në fundvitin 2009 arritën në rreth 24.2 miliardë lekë, rreth 10.5% më shumë se një tremujor më parë dhe rreth 114% më shumë se një vit më parë. Në fund të vitit 2009, raporti "provigjone për kreditë me probleme ndaj huave me probleme" (raporti i mbulimit) është ngritur në 51.3%, nga 42.8% në fund të vitit 2008, si rezultat i rritjes më të lartë të fondeve rezervë (114%) se rritja e huave me probleme (78.9%).

Në procesin e kredidhënies, një rol të rëndësishëm luan kolaterali, si burim i rikuperimit të vlerës së kredisë me probleme në një masë të pjesshme ose të plotë. Në fund të vitit 2009, vlera e atyre kredive për të cilat ekziston kolaterali[55] rezulton rreth 79% e portofolit të kredisë. Kredia e kolateralizuar kryesisht në formën e pasurive të paluajtshme, në tremujorin e katërt rezultoi 61%, shumë pranë vlerës së llogaritur në të njëjtën periudhë një vit më parë (60%). Për sa i përket mbulimit me kolateral të portofolit të kredisë me probleme për fundvitin 2009, ai llogaritet në nivelin prej 61%, nga 69% një vit më parë. Në lidhje me mbulimin me kolateral të portofolit të kredisë në valutë, rezulton se për 68.3% të tepricës në euro dhe rreth 51.6 të tepricës

në dollarë ekziston kolaterali në formën e pasurive të paluajtshme (Grafiku 71).

Grafik 71. Kategoritë e kredisë të kolateralizuara me pasuri të paluajtshme në %.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

TREGUESIT E KAPITALIT

Gjatë vitit 2009, sektori bankar nuk shfaqi luhatje të mëdha të treguesve të kapitalit. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit[56] për sektorin bankar, në fund të vitit, paraqitet në nivelin 16.2% ose 1 pikë përqindje më i ulët sesa në fundin e vitit 2008. Ky tregues ka pasur një ecuri në rënie të lehtë gjatë vitit, por sidoqoftë është mjaft më i lartë krahasuar me nivelin minimal të kërkuar (Grafiku 72). Në fund të vitit 2009, kapitali rregullator i sektorit bankar ishte 81.3 miliardë lekë (22.7 miliardë lekë, ose 39% më shumë se një vit më parë), duke ndjekur një ecuri rritëse gjatë gjithë tremujorëve të vitit. Totali i aktiveve dhe zërave jashtë bilancit të ponderuar me rrezikun arriti në 502.8 miliardë lekë ose 48% më shumë se në fundin e vitit 2008. Rritjen më të madhe kundrejt fundit të vitit të kaluar (me 185% kundrejt një viti më parë) e kanë pasur aktivet me rrezik të lartë (koeficient ponderimi 150%).

Në lidhje me grupet e bankave, në fund të vitit 2009, norma e mjaftueshmërisë së kapitalit ishte rreth 32.7% për Grupin 1, 13.6% për Grupin 2 dhe 16% për Grupin 3 të bankave. Bankat e Grupeve 2 dhe 3 kanë patur një rënie të kësaj norme gjatë vitit: veçanërisht Grupi 2 e ka mbyllur vitin me një normë të mjaftueshmërisë së kapitalit 1.7 pikë përqindje më të ulët se një vit më parë (Grafiku 72.b).

Grafik 72. Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit (raporti i kapitalit rregullator ndaj aktiveve të ponderuara me rrezik).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në fund të vitit 2009, treguesi i raportit të kapitalit aksioner ndaj totalit të aktiveve ishte 9.6% për sektorin bankar ose 1 pikë përqindje më i lartë se një vit më parë. Gjatë vitit 2009, ky tregues paraqet një prirje të qëndrueshme në rritje (Grafiku 73.a). Pjesa më e madhe e bankave kanë patur rritje të kapitalit të paguar, në një vlerë totale prej 9.86 miliardë lekësh, gjë që ka ndikuar në rritjen e këtij treguesi.[57]

Sipas grupeve të bankave, në fund të vitit 2009, raporti "kapital aksioner ndaj totalit të aktiveve" është rreth 20% për Grupin 1, 8.4% për Grupin 2 dhe 9.3% për Grupin 3 të bankave (Grafiku 73.b). Grupet 2 dhe 3 paraqesin një rritje të këtij raporti kundrejt fundit të vitit 2008, përkatësisht me 0.8 dhe 1.1 pikë përqindje. Grupi 1 shënoi rënie me 1.4 pikë përqindje të këtij raporti, por megjithatë evidentohet mbi vlerën mesatare për sistemin bankar. Nëse krahasohet niveli i fundvitit me atë të tremujorëve, Grupi 3 paraqet rritje të kapitalit aksioner ndaj totalit të aktiveve kundrejt të gjithë tremujorëve të vitit, ndërsa Grupi 2 vetëm kundrejt tremujorit të parë.

Grafik 73. Raporti i kapitalit aksioner ndaj aktiveve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në fund të vitit 2009, sektori bankar shqiptar vazhdon të paraqitet i mirëkapitalizuar. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit shfaq rënie të lehtë kundrejt fundit të vitit të kaluar, por është mjaft më i lartë se niveli minimal i kërkuar. Rënia shpjegohet me rritjen e aktiveve të ponderuara me koeficientët përkatës të rrezikut, e cila e tejkalonte rritjen e kapitalit rregullator. Ky ndryshim i aktiveve të ponderuara, e në veçanti rritja e konsiderueshme e aktiveve me koeficientin më të lartë të ponderimit (150%), përbën një element të shtuar rreziku për sektorin bankar.

Rritja e kapitalit të paguar, në një kohë kur bankat u përballën me efektet e krizës, shfaq gatishmërinë e aksionerëve për të investuar dhe përbën një element pozitiv të zhvillimeve të këtij viti.

6.1.8 REZULTATI FINANCIAR DHE EFICIENCA E PËRDORIMIT TË BURIMEVE

Sektori bankar e mbylli vitin 2009 me një fitim neto prej 3.5 miliardë lekësh. Kjo shifër është rreth 3.8 miliardë lekë, ose 51.7%, më e ulët se fitimi i vitit të kaluar, duke reflektuar kështu në mënyrë më të ndjeshme pasojat e krizës financiare botërore mbi performancën e bankave.

Norma vjetore e kthimit mbi kapitalin (RoE)[58] për sektorin bankar ishte 4.6%; 7 pikë përqindje më e ulët se në fundin e vitit të kaluar. Lidhur me ecurinë e përbërësve të treguesit RoE, siç u tha më lart, fitimi neto i sektorit u pakësua me 51.7%, ndërsa kapitali aksioner mesatar u rrit me 20.8% kundrejt fundit të vitit 2008. Në fillim të vitit 2009, ecuria e këtij treguesi ka qenë mjaft e luhatshme, ndërkohë që pas muajit korrik, treguesi ka shfaqur një rritje të qëndrueshme (Grafiku 74.a).

Grafik 74. Kthimi nga kapitali (RoE).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 75. Kthimi nga aktivet (RoA).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në fund të vitit 2009, treguesi i kthimit nga aktivet (RoA) për sektorin bankar ishte 0.4%, rreth 0.5 pikë përqindje më i ulët se një vit më parë. Ky tregues përgjithësisht ndjek një ecuri të ngjashme me atë të kthimit nga kapitali (Grafiku 75).

Për të dy treguesit e eficiencës së veprimtarisë, kanë qenë bankat e Grupit 3, ato të cilat kanë përcaktuar ecurinë e tyre. Ky grup ka shfaqur vlera pozitive të treguesve RoE dhe RoA gjatë gjithë vitit 2009.

Nëse analizohen faktorët me ndikimin kryesor në performancën e bankave, do të vërehet se raporti "shpenzime të përgjithshme jo për interesa ndaj të ardhurave bruto të veprimtarisë" ka shfaqur rritje tepër të theksuar gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2009 (duke arritur në nivelin maksimal 267%, në muajin shtator) dhe ka rënë pastaj gjatë tremujorit të fundit (231.4% në dhjetor) (Grafiku 76.a). Sipas grupeve të bankave, raporti "shpenzime jo për interesa ndaj të ardhurave bruto", ka shënuar rënie gjatë tremujorit të fundit për Grupin 3 (gjë që ka përcaktuar edhe ecurinë e raportit për të gjithë sektorin) dhe rritje për Grupin 2 të bankave (Grafiku 76.b). Shpenzimet e përgjithshme jo për interesa kanë patur nivelin e tyre më të lartë në tremujorin e tretë të vitit.

Grafik 76. Shpenzime të përgjithshme jo për interesa ndaj të ardhurave bruto të veprimtarisë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ecuria e "shpenzimeve jo për interesa" ndikohet drejtpërsëdrejti nga ajo e provigjoneve, të cilat u rritën me rreth 12 miliardë lekë gjatë vitit 2009: vetëm 13% e kësaj rritjeje u realizua gjatë tremujorit të katërt. Nga ana tjetër, të ardhurat bruto u rritën me rreth 9 miliardë lekë në tremujorin e fundit të vitit, kundrejt mesatarisht 5.7 miliardë lekëve në tremujorët e mëparshëm. Në fund të vitit 2009, raporti i "shpenzimeve për provigjone" ndaj "të ardhurave bruto të veprimtarisë" ishte në vlerën 45%, në rritje me rreth 16 pikë përqindje kundrejt fundit të vitit të kaluar.

Raporti "të ardhura neto nga interesat/të ardhurave bruto të veprimtarisë" analizohet për të parë rolin që ka veprimtaria bazë e ndërmjetësimit financiar në të ardhurat e përgjithshme të sektorit bankar. Në fund të vitit 2009, ky raport ishte 119.6%, 13 pikë përqindje më i lartë se në fund të vitit 2008 (Grafiku 77.a). Nga analiza e pjesëve përbërëse të këtij raporti, del në pah se gjatë tremujorit të fundit të vitit 2009, të ardhurat nga interesat dhe të ardhurat bruto të veprimtarisë së sektorit bankar janë rritur pothuajse njësoj. Krahasuar me fundin e vitit 2008, të ardhurat neto nga interesat për sektorin bankar kanë shënuar rritje prej 19%, kundrejt një rënieje 9% të të ardhurave bruto të veprimtarisë. Rënia e të ardhurave bruto të veprimtarisë, në një kohë që të ardhurat neto nga interesat kanë shënuar rritje të ndjeshme, shpjegohet me rritjen e shpenzimeve për provigjone. Siç u tha më lart, rritja e provigjoneve ka shënuar një frenim të konsiderueshëm gjatë tremujorit të katërt të vitit.

Raporti "të ardhura neto nga interesat/të ardhurave bruto të veprimtarisë" ka shfaqur një ecuri të ndryshme për grupe të ndryshme bankash. Kështu, Grupi 2 ka patur rritje të theksuar të këtij raporti deri në muajin maj 2009 (kur arriti në nivelin 295%), pas të cilit ai shfaqi rënie deri në nivelin 210% në muajin dhjetor. Ndërkohë, për Grupin 3 të bankave vihet re një luhatshmëri më e moderuar e këtij raporti, i cili ka shënuar një ulje të zbutur gjatë tremujorit të fundit të vitit (108% në fund të vitit) (Grafiku 77.b.).

Grafik 77. Të ardhurat neto nga interesat ndaj të ardhurave bruto të veprimtarisë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Hapësirë Informuese 3: Zbërthimi i treguesit RoE sipas modelit DuPont[59].

Në vijim paraqitet zbërthimi i treguesit RoE sipas modelit DuPont. Modeli DuPont realizon zbërthimin e treguesit RoE (kthim nga kapitali) sipas disa elementeve përbërëse të tij. Konkretisht:

RoE = Rezultati neto/Kapitali aksioner mesatar = EAT/BVE;
*RoE = RoA * EM (ku EM = shumëzuesi i kapitalit);*
EM = Aktive mesatare/Kapitali aksioner mesatar = TA/BVE

Në tabelën e mëposhtme, paraqitet zbërthimi i treguesit RoE sipas elementeve të tij përbërës në vitet 2003 – 2009.

Tabelë 19. Ecuria e elementeve përbërëse të treguesit RoE në vitet 2003 – 2009.

	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Kthyeshmëria nga kapitali aksioner (në%), ROE= EAT/BVE	19.53	21.10	22.43	20.17	20.32	11.4	4.58
Kthyeshmëria nga aktivet mesatare (në%), ROA= EAT/TA	1.24	1.28	1.41	1.36	1.48	0.92	0.42
Komponentët përbërës të ROE, ROE=PM*AU*EM							
Marzhi i fitimit (në%), PM=EAT/TOI	14.29	15.80	17.24	17.67	17.95	10.43	3.26
Shkalla e përdorimit të aktiveve (në%), AU=TOI/TA	8.66	8.08	8.15	7.70	8.24	8.79	12.79
Shumëzuesi i kapitalit (në herë), EM=TA/BVE	15.78	16.54	15.96	14.82	13.74	12.49	10.99
Komponentët përbërës të ROA, ROA=AU-ER							
Shkalla e përdorimit të aktiveve (në%), AU=TOI/TA	8.66	8.08	8.15	7.70	8.24	8.79	12.79
Raporti i shpenzimeve (në%), ER=TOE/TA	7.42	6.80	6.75	6.34	6.76	7.87	12.37
Komponentët përbërës të ROA, ROA=NIM*EAR+B-LLP/TA-T/TA							
Marzhi neto i interesave (në%), NIM=NII/EA	3.23	3.08	3.75	4.22	4.35	4.13	4.04
Raporti i aktiveve që sjellin të ardhura me aktivet totale (në%), EAR=EA/TA	95.85	94.80	93.33	93.19	93.34	93.12	91.30
Barra e bankave (në%), B=NNII/TA	(1.11)	(0.93)	(1.45)	(1.69)	(1.62)	(1.69)	(1.75)
Raporti i shpenzimeve për provigjione ndaj totalit të aktiveve (në%), LLP/TA	0.25	0.26	0.19	0.48	0.53	1.06	1.39
Raporti i shpenzimeve për taksa dhe tatime ndaj totalit të aktiveve (në%), T/TA	0.50	0.45	0.46	0.41	0.44	0.18	0.12
Komponentët përbërës të NIM, NIM=REA-COL*LEA							
Kthimi nga aktivet që sjellin të ardhura (në%), REA=II/EA	8.07	6.96	6.84	7.05	7.72	8.07	8.10
Kosto e fondeve të marra borxh (në%), COL=IE/PL	5.23	4.14	3.28	3.05	3.70	4.31	4.43
Raporti i pasiveve që paguajnë interes me aktivet që sjellin të ardhura (në%), LEA=PL/EA	92.47	93.80	94.36	92.90	91.15	91.58	91.71

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Lista e shkurtimeve:

EAT = Rezultati neto
BVE = Kapitali aksioner
TA = Totali i aktiveve
TOI = Të ardhura totale
AU = Përdorimi i aktiveve
EM = Shumëzuesi i kapitalit
TOE = Shpenzime totale
PM = Marzhi i fitimit
ER = Raporti i shpenzimeve
NIM = Marzhi neto i interesave
NII = Rezultati neto nga interesat
EA = Aktive që sjellin të ardhura
EAR = Raporti i aktiveve që sjellin të ardhura me aktivet totale
NNII = Rezultati neto jo nga interesat

LLP = Shpenzime për provigjone
T = Shpenzime për taksa dhe tatime
REA = Kthimi nga aktivet që sjellin të ardhura
COL = Kosto mesatare e detyrimeve
LEA = Raporti i pasiveve që paguajnë interes me aktivet që sjellin të ardhura
IE = Shpenzime për interesa
PL = Pasive që shkaktojnë shpenzime
B = Barra e bankës

Grafik 78. Paraqitja grafike e elementeve përbërëse të kthimit nga kapitali.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Nga analiza e treguesve të mësipërm vihet re se:

- *Marzhi i fitimit (fitimi neto/të ardhurat totale) ka patur rritje në periudhën 2003 – 2007, ndërsa paraqet rënie të konsiderueshme në vitet 2008 e 2009. Në vitin 2009, marzhi i fitimit është 3.3%, d.m.th. 7.2 pikë përqindje më i ulët se një vit më parë dhe 14.7 pikë përqindje më i ulët sesa në vitin 2007. Në këtë ndryshim, ka ndikuar rënia e fitimit neto me 52% (kundrejt vitit 2008) dhe rritja e të ardhurave totale me rreth 55%. Rënia e marzhit të fitimit është një ndër faktorët kryesorë që ka shkaktuar rënien e RoE. Kjo rënie do të thotë se një pjesë më e vogël e të ardhurave totale mbetet në dispozicion të aksionerëve (për t'u shpërndarë si dividend) apo të bankës (për t'u rikapitalizuar), pas zbritjes së shpenzimeve.*
- *Nga ana tjetër vihet re rritja e shkallës së përdorimit të aktiveve: 12.8% në vitin 2009, në rritje me 4 e 5 pikë përqindje kundrejt përkatësisht viteve 2008 e 2007. Në vitet 2003 – 2008, ky tregues është luhatur në intervalin 7.7 – 8.8%.*
- *Shumëzuesi i kapitalit (aktive mesatare/kapitalit aksioner mesatar) ka vazhduar edhe në vitin 2009 prirjen e tij rënëse, të nisur që në vitin 2005: në vitin 2009, ky raport ka vlerën 11 (kundrejt 12.5 në vitin 2008 dhe 13.7 në vitin 2007). Kjo ecuri ka ardhur si pasojë e rritjes vjetore të shpejtë të kapitalit aksioner (me 20.8% në vitin 2009) përkundrejt një rritjeje më të ulët të aktiveve mesatare, prej 6.3% në të njëjtën periudhë. Vlera e shumëzuesit të kapitalit në fund të vitit 2009, shpreh se aktivet mbulojnë rreth 11 herë kapitalin e investuar. Rritja vjetore e kapitalit aksioner mesatar me rreth 20.8%, siç është paraqitur edhe në analizën e treguesve të kapitalit, është një element pozitiv i zhvillimeve gjatë vitit të fundit.*

Nga një zbërthim i mëtejshëm i treguesit RoE dhe pas disa veprimesh, arrihet në një shprehje të këtij treguesi si më poshtë:

*RoE = [NIM*EAR + B – LLP/TA - T/TA] * EM*

- *Marzhi neto i interesave (NIM) është raporti i rezultatit neto nga interesat me aktivet mesatare që sjellin të ardhura. Në fund të vitit 2009, ky tregues është 4%, në rënie me 0.1 dhe 0.3 pikë përqindje përkatësisht kundrejt vitit 2008 dhe vitit 2007. Ky raport ka qenë në rritje deri në vitin 2007 (vit kur ka shënuar vlerën 4.35) dhe më pas ka rënë.*

Për sa u takon elementeve përbërëse të këtij treguesi, rezultati neto nga interesat në vitin 2009 është rritur me 1.9% kundrejt vitit 2008 (ndërkohë që në vitin 2008 rritja vjetore kishte qenë 12.3%, dhe në fund të vitit 2007, 27.3%). Aktivet mesatare që sjellin të ardhura paraqesin rritje me 4.2%. Duke qenë se janë rritur më tepër sesa rezultati neto nga interesat, marzhi neto i interesave ka pësuar rënie.

- Raporti i aktiveve mesatare që sjellin të ardhura me aktivet mesatare (EAR) në fund të vitit 2009, është 91.3%, në rënie me 1.8 pikë përqindje kundrejt fundit të vitit të kaluar.

- Barra e bankës (B) është raporti i rezultatit neto jo nga interesat me aktivet mesatare. Ky tregues në fund të vitit 2009 është -1.75%, në rënie me rreth 1 pikë kundrejt vitit të kaluar. Rezultati neto jo nga interesat është negativ (shpenzimet jo për interesa i kanë tejkaluar të ardhurat jo nga interesat) dhe është thelluar (nga -13.5 milionë në -14.9 milionë), ndërsa aktivet mesatare janë rritur me 6.3%.

- Shpenzimet për provigjone ndaj aktiveve mesatare (LLP/TA) kanë rezultuar 1.4% në fund të vitit 2009, në rritje me 0.3 pikë përqindje kundrejt fundit të vitit të kaluar. Mesatarja e këtij treguesi (LLP/TA) në vitet 2003-2008 ka qenë 0.46. Gjatë vitit 2009, shpenzimet për provigjone shënojnë rritje me 40% kundrejt atyre të vitit 2008, duke e tejkaluar kështu me mbi 6 herë rritjen e aktiveve mesatare.

- Shpenzimet për taksa dhe tatime ndaj aktiveve mesatare (T/TA): në fund të vitit 2009, ky tregues ishte 0.12%, në rënie me 0.06 pikë kundrejt fundit të një viti më parë. Shpenzimet për taksa dhe tatime kanë rënë si pasojë e uljes së fitimit neto të raportuar në fund të vitit nga sektori bankar.

Gjatë vitit 2009, të gjitha elementet përbërëse të treguesit RoE (kthim nga kapitali aksioner), me përjashtim të shpenzimeve për taksa dhe tatime, kanë shfaqur ecuri në një kah të tillë që kanë ndikuar rënien e treguesit në fund të vitit 2009 (në 4.6% nga 11.4% në fund të vitit 2008). Ndryshimin më të madh e ka patur raporti i totalit të shpenzimeve ndaj totalit të aktiveve, me një rritje prej 4.5 pikësh përqindje në krahasim me vitin 2008.

6.1.9 DEPOZITAT DHE ECURIA E TYRE

Rënia e depozitave të sektorit bankar në tremujorin e fundit të vitit 2008 deri në mesin e vitit 2009, ndikoi në ecurinë e tyre gjatë gjithë vitit. Rënia e depozitave erdhi si rezultat i lëkundjes së besimit të publikut në qëndrueshmërinë e sektorit bankar, për shkak të efekteve psikologjike të lidhura me zhvillimin dhe ashpërsimin e krizës ndërkombëtare financiare dhe pasigurinë mbi efektin ndaj sektorit bankar shqiptar. Pavarësisht kësaj, niveli i depozitave shënoi një rritje konstante gjatë pjesës së dytë të vitit, duke dëshmuar rritjen e besimit të publikut në sistemin bankar, por edhe përpjekjet e bankave për të tërhequr depozita të reja nëpërmjet rritjes në normat e interesit, sidomos gjatë muajve të verës.

Depozitat vazhdojnë të mbeten të përqendruara në bankat më të mëdha të sektorit bankar[60], por shkalla e përqendrimit të tyre ka rënë në mënyrë të ndjeshme.

Totali i depozitave ka shënuar një rritje vjetore prej rreth 7.6% krahasuar me fundin e vitit 2008, ndërkohë që rritja e vitit të kaluar qëndron rreth nivelit 2.4% (Tabelë 19). Që nga muaji qershor, rritja ka qenë 8.45%, duke treguar vështirësitë e sistemit bankar në lidhje me depozitat në fillim të vitit si rrjedhojë e tërheqjeve nga ana e klientëve gjatë fundit të vitit 2008.

	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Rritja e totalit të depozitave (në%)	13.4	16.4	20.1	19.9	2.4	7.6

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 19. Rritja vjetore e totalit të depozitave për sektorin bankar, gjatë viteve 2004-2009.

Në analizën e strukturës së depozitave sipas maturimit, vërehet se në muajin dhjetor 2009, shumica e depozitave të sektorit bankar, rreth 67%, ishin me maturim deri në një vit (Grafiku 79). Kundrejt muajit shtator 2009, depozitat me afat deri në një muaj janë rritur me 3.3 pikë përqindje; ato me afat maturimi 6 deri në 12 muaj janë rritur me 3 pikë përqindje; depozitat mbi 5 vjet, të cilat përbëjnë një peshë të papërfillshme, janë pothuaj të pandryshuara, ndërsa maturimet e tjera kanë pësuar rënie. Kundrejt fundit të vitit 2008, depozitat me afat maturimi deri në një muaj kanë rënë me 1.7 pikë përqindje; me të njëjtën vlerë janë rritur depozitat me afat maturimi 6-12-mujor, ndërkohë që nuk vlen të përmenden ndryshimet në afatet e tjera të maturimit, të cilat tregojnë luhatje të parëndësishme.

Grafik 79. Struktura e depozitave të sektorit bankar sipas maturimit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Lidhur me strukturën e depozitave sipas monedhës, vërehet se në fund të vitit 2009, depozitat në lekë përbënin 54% të totalit të depozitave, në vlerën 376.2 miliardë lekë, ndërsa ato në valutë përbënin 46% të totalit të depozitave, në vlerën 318 miliardë lekë. Pesha e depozitave në lekë ka rënë me 0.6 pikë përqindje kundrejt fundit të muajit shtator dhe me 2.7 pikë përqindje kundrejt fundit të vitit 2008.

Ecuria e depozitave të reja në monedhën vendase ka treguar rritje që prej muajit maj të vitit 2009, pas rënies së tremujorit të katërt të vitit të kaluar. Kështu, në muajin dhjetor, u pranuan 47.6 miliardë lekë depozita të reja në monedhën vendase, rreth 17% më shumë se depozitat e reja të pranuara në muajin qershor dhe rreth 6.7% më shumë se depozitat e reja të pranuara në janar 2009. Shifra më e lartë në muajin shtator tregon pranimin e më shumë depozitave nga sistemi bankar si rezultat i fushatave nxitëse gjatë muajve të verës, por edhe si pasojë e uljes së normave të interesit për depozitat pas këtij muaji.

Për sa i takon strukturës së maturimit të depozitave të reja të pranuara, në fund të vitit 2009 është vënë re një rritje në peshën e depozitave të reja me maturim deri në 3-mujor, në një kohë kur në të gjitha maturimet e tjera vërehet rënie që nga fundi i vitit 2008.

Tabelë 20. Struktura e maturimit të depozitave të reja të pranuara nga sektori bankar në lekë.

Pesha e maturimeve (%)	Dhjetor 2008	Mars 2009	Qershor 2009	Shtator 2009	Dhjetor 2009
2 vjet	1.31	0.8	0.69	1.21	1.06
1 vit	29.60	22.47	19.28	33.05	27.87
6 muaj	17.10	14.92	20.83	12.96	14.33
3 muaj	23.91	32.44	17.80	25.29	30.69
1 muaj	27.77	29.10	41.21	27.23	25.77

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Norma mesatare e interesit për depozitat e reja në lekë, ka qenë 5.37% në dhjetor, në krahasim me 5.48% në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Norma më e lartë e interesit në muajin gusht ka reflektuar kërkesën më të lartë të sektorit bankar për depozita në lekë, ndërkohë që rënia gjatë muajve në vazhdim tregon për një situatë më të mirë të depozitave në sistemin bankar.

Depozitat e reja të pranuara nga sektori bankar në euro, në muajin dhjetor 2009, ishin 487 milionë euro, duke treguar një ecuri në rënie gjatë gjithë vitit. Kështu, depozitat e reja në euro të pranuara në muajin dhjetor 2009 ishin 9.3% më të ulëta se ato të muajit shtator, ndërsa janë rreth 35.1% më të ulëta kundrejt muajit dhjetor 2008. Në lidhje me strukturën e maturimit të depozitave të reja në monedhën evropiane, vërehet zhvendosja e publikut nga depozitat 1-mujore në ato 3-mujore gjatë muajve të fundit të vitit; në këtë mënyrë depozitat e reja me afat maturimi 3-mujor dominojnë strukturën e depozitave të reja (Tabelë 21).

Tabelë 21. Struktura e maturimit të depozitave të reja të pranuara nga sektori bankar, në euro.

Pesha e maturimeve (%)	Dhjetor 2008	Mars 2009	Qershor 2009	Shtator 2009	Dhjetor 2009
2 vjet	0.13	0.19	0.13	0.55	0.32
1 vit	3.56	2.40	4.40	11.98	10.59
6 muaj	2.18	3.62	5.70	6.92	7.47
3 muaj	8.78	8.17	7.40	14.80	66.62
1 muaj	85.31	85.60	82.34	65.68	14.94

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Norma mesatare e interesit për depozitat e reja në euro ka qenë 2.17% në muajin dhjetor 2009, kundrejt 3.14% në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Ky tregues shpjegon qartë rënien e depozitave të reja në këtë monedhë.

Depozitat e reja në usd të pranuara nga sektori bankar, në muajin dhjetor 2009 ishin 87.3 milionë usd. Ecuria e tyre gjatë tremujorit të fundit të vitit ka qenë në rënie, por në rritje krahasuar me vitin e kaluar. Kështu, depozitat e reja në usd të pranuara në muajin dhjetor ishin 19% më të ulëta se ato të muajve shtator 2009, por 37% më të larta se ato në fund të vitit. Gjatë gjithë vitit 2009, depozitat me afat maturimi nën 3 muaj përbëjnë mbi 70% të totalit të depozitave të reja në monedhën amerikane, njëlloj si në fund të vitit të kaluar (Tabelë 22).

Tabelë 22. Struktura e maturimit të depozitave të reja të pranuara nga sektori bankar, në usd.

Pesha e maturimeve (%)	Dhjetor 2008	Mars 2009	Qershor 2009	Shtator 2009	Dhjetor 2009
2 vjet	0.12	0.16	0.11	0.46	0.46
1 vit	15.82	10.36	11.99	18.55	16.40
6 muaj	12.42	10.18	14.72	12.82	10.85
3 muaj	22.55	33.75	26.28	31.23	39.54
1 muaj	49.09	45.47	46.63	34.68	32.63

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Norma mesatare mujore e interesit për depozitat e reja në usd, ka qenë 1.29% në dhjetor 2009, krahasuar me 2.01% në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Muajt e parë të vitit 2009, pranimet e reja të depozitave dhe të llogarive rrjedhëse në lekë shfaqën një prirje rënëse në baza mujore, por me një ritëm rënieje tepër të ngadalësuar. Kjo ka përkuar me vijimin e prirjes rënëse të depozitave në tremujorin e parë të vitit 2009. Duke filluar nga muaji maj, stoku i depozitave ka rinisur të rritet duke reflektuar një qëndrueshmëri më të madhe të depozitave ekzistuese dhe duke arritur vlerën më të lartë në muajin gusht. Gjatë vitit vërehen luhatje të shpeshta në depozitat e reja në lekë, po vlen të theksohet se situata paraqitet në mënyrë të ndjeshme e përmirësuar gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit.

Grafik 80. Vëllimi total i pranimeve të reja në lekë kundrejt normave mesatare të interesit për llogaritë rrjedhëse, depozitat pa afat dhe depozitat me afat në lekë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Pranimet e depozitave të reja dhe të llogarive rrjedhëse në euro, shfaqin një ecuri të qëndrueshme gjatë muajve të parë të vitit 2009. Ndërkohë që vërehet përmirësim më i qëndrueshëm i flukseve të reja hyrëse nga depozitat/llogaritë rrjedhëse në dollarë amerikanë.

Grafik 81. Vëllimi total i pranimeve të reja në valutë kundrejt normave mesatare të interesit për llogaritë rrjedhëse, depozitat pa afat dhe depozitat me afat në euro dhe usd.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në përgjithësi, ecuria e depozitave të reja, mbështet mendimin që rikthimi i depozitave në sektorin bankar duket se është vendosur mbi ritme rritjeje të qëndrueshme, pas një fillim viti që ndiqte ecurinë rënëse që prej fundit të vitit 2008. Fluksi i depozitave të reja në pjesën e dytë të vitit 2009,tregon se besimi i publikut në sistemin bankar vendas është rivendosur. Gjithsesi, luhatjet e shpeshta në pranimin e depozitave të reja sjellin nevojën e monitorimit të vazhdueshëm të likuiditetit të bankave.

6.1.10 TREGUESIT E LIKUIDITETIT TË SEKTORIT BANKAR

Fenomeni i tërheqjes së depozitave gjatë fundit të vitit 2008 dhe fillimit të vitit 2009 nxorri në pah nevojën e përmirësimit të kuadrit rregullator në lidhje me administrimin e rrezikut të likuiditetit nga bankat e nivelit të dytë. Kështu, Banka e Shqipërisë miratoi rregulloren "Për administrimin e rrezikut të likuiditetit" në muajin tetor 2009, sipas së cilës, aktivet likuide të sektorit bankar në fund të vitit 2009 llogariten rreth *27.6% e totalit të aktiveve* dhe rreth *32.6% e totalit të detyrimeve afatshkurtra me maturim të mbetur deri në 1 vit. Nivelet e këtyre raporteve vlerësojnë një situatë të kënaqshme likuiditeti për sektorin bankar vendas.*

Ndërkohë, analiza thellohet më në detaje, duke marrë në konsideratë tërësinë e treguesve të mëposhtëm, si plotësues të vlerësimeve mbi situatën e likuiditetit të bankave të sistemit.

Raporti "depozita/kredi" në fund të vitit 2009 tregon vlerën 154.3%, 8.3 pikë përqindjeje më pak se në muajin dhjetor të vitit të kaluar. Kjo ecuri vjen si rezultat i një rritjeje më të lartë të tepricës së kredisë në krahasim me atë të depozitave. Kështu, ndryshimi i tepricës së kredisë dhjetor 2008-dhjetor2009 është 53 miliardë lekë, ndërkohë që i njëjti ndryshim për depozitat llogaritet 49 miliardë lekë. Ky raport ka patur luhatje jo të qenësishme gjatë gjithë vitit 2009.

Përsa i përket të njëjtit raport në valutë, ai tregon rritje (nga 103% në 112.6%) nga dhjetori i vitit të kaluar në fundin e vitit 2009, duke prezantuar një ritëm shumë më të lartë[61] të rritjes së depozitave në valutë në krahasim me atë të kredive në valutë.

Në fund të vitit 2009, raporti i "aktiveve nga jorezidentët" mbi "detyrimet ndaj jorezidentëve" për sistemin, është rritur në 1.42% nga 0.96% që ishte në fund të vitit 2008. Gjatë gjashtëmujorit të parë 2009, sistemi bankar është paraqitur debitor për herë të parë ndaj jorezidentëve. Rënia e aktiveve dhe rritja e pasiveve jorezidente ka ardhur si rrjedhojë e nevojës për likuiditet që shfaqi sistemi bankar në gjysmën e parë të vitit 2009. Megjithatë, në gjysmën e dytë të vitit 2009, ky raport ka pasur një ecuri në rritje duke reflektuar përmirësimin e likuiditetit të sistemit bankar.

Gjatë gjashtëmujorit të dytë 2009, niveli i aktiveve jorezidente të sistemit ka shfaqur një tendencë në rritje, duke u kthyer në vlerat e tremujorit të katërt 2008. Në fund të vitit 2009, aktivet jorezidente ishin 9.4% e sistemit nga 9.7 në fund të vitit 2008.

Në nivel grupbankash, Grupi 2 paraqitet më i ndjeshëm ndaj aktiveve jorezidente. Në fund të vitit 2009, Grupi 2 ka ulur nivelin e aktiveve jorezidente në 6.7% të totalit të aktiveve, nga 13.1% në tetor 2008. Kjo rënie e dukshme e aktiveve jorezidente, reflektoi nevojën e menjëhershme të këtyre bankave për mjete likuide.

Detyrimet ndaj jorezidentëve në raport me totalin e detyrimeve njohën rritje në tremujorin e fundit 2008 dhe në tremujorin e parë 2009. Në tremujorin e parë 2009, detyrimet ndaj jorezidentëve kanë shfaqur rënie, për shkak të përmirësimit të situatës së likuiditetit në vend.

Në nivel grupbankash, Grupi 2 paraqitet dukshëm më i varur ndaj detyrimeve jorezidente. Gjatë tremujorit të fundit 2008 dhe tremujorit të parë 2009, evidentohet rritje e detyrimeve ndaj jorezidentëve. Kjo ecuri ka shfaqur prirje rënëse në tremujorët e fundit të vitit 2009 duke pasqyruar përmirësim të likuiditetit për bankat e këtij grupi.

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet ecuria e indeksit të Herfindahl-it, i cili që prej tremujorit të parë 2008, me përjashtim të tremujorit të katërt

Grafik 82. Aktive të jorezidentëve / detyrime ndaj jorezidentëve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 83. Totali i aktiveve të jorezidentëve mbi totalin e aktiveve (sistemi).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 84. Aktivet e jorezidentëve, ndaj totalit të aktiveve, sipas grupbankave.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 85. Totali i pasiveve të jorezidentëve mbi totalin e pasiveve (sistemi).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 86. Detyrimet ndaj jorezidentëve, ndaj totalit të detyrimeve, sipas grupbankave.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 87. Përqendrimi i detyrimeve ndaj jorezidentëve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 88. Raporti i portofolit të bonove të thesarit/hua marrë nga Banka e Shqipërisë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

2009, shfaq rënie të përqendrimit të "detyrimeve ndaj jorezidentëve," për sektorin bankar.

Në dhjetor 2009, raporti për sistemin i "portofolit të bonove të thesarit" ndaj "hua marrë nga Banka e Shqipërisë", ka rënë në nivelin 3.3 nga 30 që ishte në shtator 2008. Rënia pasqyron sasinë e përdorur si kolateral për hua të marra nga Banka e Shqipërisë. Financimi nëpërmjet huamarrjes nga Banka e Shqipërisë, ka reduktuar sasinë e bonove të thesarit të disponueshme për kolateral, duke reduktuar në këtë mënyrë mundësitë potenciale të sigurimit të likuiditetit për sistemin bankar.

Në fund të vitit 2009, gap-i kumulativ negativ i aktiveve dhe pasiveve me afat maturimi deri në tre muaj është ngushtuar në 16.7% nga 21.9% një vit më parë. Ngushtimi ka ardhur si rrjedhojë e rritjes vjetore me 6.3% të aktiveve deri në tre muaj, ndërkohë që pasivet ranë me 2.7%[62].

6.1.11 VLERËSIM I NIVELIT TË KAPITALIZIMIT TË SEKTORIT BANKAR DHE BANKAVE INDIVIDUALE SIPAS METODOLOGJISË *STRESS-TESTING*

Nëpërmjet analizës *stress-test,* vlerësohet stabiliteti i sistemit financiar dhe mjaftueshmëria e kapitalit për sektorin bankar. Kjo analizë ka për qëllim simulimin e situatave përtej normalitetit ekonomik. *Stress testing* vlerëson impaktin e menjëhershëm të këtyre situatave në gjendjen

Grafik 89. Gap i maturimit për shportat "Deri në 1 muaj"dhe "Deri në 3 Muaj".



Burimi: Banka e Shqipërisë.

financiare të sektorit bankar, duke përjashtuar mundësinë e rritjes së kapitalit të paguar gjatë periudhës së marrë në konsideratë. Në praktikë, kjo është pothuaj e pamundur, pasi situata zakonisht përkeqësohet gradualisht dhe bankat kanë kohë të marrin masat e nevojshme, duke injektuar kapital. Megjithatë, nëpërmjet kësaj analize supozohen dy skenarë, me qëllim matjen e mjaftueshmërisë së kapitalit të bankave pas goditjeve të supozuara. Ndërsa skenari i parë supozon një përkeqësim të faktorëve makroekonomikë, skenari i dytë është më ekstrem dhe me një probabilitet të ulët ndodhjeje.

Përllogaritjet e impaktit të rritjeve të portofolit me probleme në madhësinë e kapitalit dhe të aktiveve me rrezik të secilës bankë, apo të sektorit bankar në tërësi, krahas ecurisë së elementeve të tjerë ndikues, konkludojnë në rezultatet e pasqyruara në vijim, lidhur me mjaftueshmërinë e kapitalit të bankave dhe sektorit bankar, respektivisht në fundvitet 2010 dhe 2011.

Tabelë 23. Rezultatet e stress-test për skenarin e parë.

Bankat e Nënkapitalizuara sipas Skenarit 1				
	Fundi i vitit 2010		Fundi i vitit 2011	
	Banka të veçanta	Sistemi Bankar	Banka të veçanta	Sistemi Bankar
Kapitali Rregullator				
Nënkapitalizim Modest /1	Po	I mirë-kapitalizuar	Po	I mirë-kapitalizuar
Nënkapitalizim i Rëndë /2	Jo		Jo	
Kapital Bazë (Kapitali Bazë/Totalin e Aktiveve me Rrezik)		I mirë-kapitalizuar		I mirë-kapitalizuar
Nënkapitalizim Modest /3	Jo		Jo	
Nënkapitalizim të Rëndë /4	Jo		Jo	

/1 = Nën raportin prej 12%;
/2 = Nën raportin prej 6%;
/3 = Nën raportin prej 6%;
/4 = Nën raportin prej 3%.

Në këtë mënyrë, sipas skenarit të parë evidentohen disa banka, nën normën rregullatore të mjaftueshmërisë së kapitalit prej 12%. Ndërkohë, sektori bankar paraqitet i mirëkapitalizuar për të dy vitet e ardhshme.

Tabelë 24. Rezultatet e stress-test për skenarin e dytë.

Bankat e Nënkapitalizuara sipas Skenarit 2				
	Fundi i vitit 2010		Fundi i vitit 2011	
	Banka të veçanta	Sistemi Bankar	Banka të veçanta	Sistemi Bankar
Kapitali Rregullator				
Nënkapitalizim Modest /1	Po	I mirë-kapitalizuar	Po	I kapitalizuar
Nënkapitalizim i Rëndë /2	Po		Po	
Kapital Bazë (Kapitali Bazë/Totalin e Aktiveve me Rrezik)		I mirë-kapitalizuar		I kapitalizuar
Nënkapitalizim Modest /3	Po		Po	
Nënkapitalizim të Rëndë /4	po		po	

/1 = Nën raportin prej 12%;
/2 = Nën raportin prej 6%;
/3 = Nën raportin prej 6%;
/4 = Nën raportin prej 3%.

Përllogaritjet sipas skenarit të dytë evidentojnë 3 dhe 4 banka nën normën rregullatore prej 12%, respektivisht për fundvitet 2010 dhe 2011.

Në konkludim, sektori bankar vendas paraqitet i shëndetshëm ndaj goditjeve të forta makroekonomike, të cilat ndikojnë në përkeqësimin e portofoleve të bankave dhe për pasojë në rezultatet neto negative të tyre. Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit të sektorit bankar, në secilin skenar, nuk bie nën minimumin rregullator, pavarësisht humbjeve të gjeneruara të bankave, rrjedhojë e goditjeve të supozuara.

STRES TEST I RREZIKUT TË KREDISË

Në këtë test integrohet bashkëveprimi i disa faktorëve makroekonomikë mbi raportin e kredive me probleme, i cili mund të merret si tregues i probabilitetit të mospagimit të një kredie në kushte të caktuara. Në tabelat e mëposhtme jepen supozimet për skenarë hipotetikë që kombinojnë zhvillime të pafavorshme të rritjes ekonomike, kursit të këmbimit ndaj monedhës euro dhe normës së interesit Euribor. Për qëllime krahasimi gjithashtu përfshihen dhe dy skenarë bazë (Tabelë 25 dhe Tabelë 26) në të cilët supozimet mbi faktorët e mësipërm janë më pranë zhvillimeve të pritshme apo situatës aktuale.[63] Llogaritja e masës së përkeqësimit të aktiveve për çdo skenar bën të mundur llogaritjen e nevojave për kapital shtesë në rast se norma e mjaftueshmërisë së kapitalit do të binte nën nivelin e lejuar prej 12%.

Tabelë 25. Rezultatet e stress-test për skenarin e parë.

Skenar 1 (Bazë)	T3_09	T4_09	T1_10	T2_10	T3_10	T4_10	
Kursi euro/lek	134.51	137.96	139.05	138.6	137.3	137.0	Supozime
Norma e Euribor	+ 40 pikë bazë çdo vit						Supozime
Rritja ekonomike	2.8	2.8	3.25	3.25	3.25	3.25	Supozime
Raporti i kredive me probleme	9.75%	10.48%	12.17%	12.47%	12.13%	11.54%	Llogaritja në bazë të supozimeve
Nevoja për kapital shtesë	-	-	-	-	-	-	Llogaritja në bazë të supozimeve

Tabelë 26. Rezultatet e stress-test për skenarin e dytë.

Skenar 2 (Bazë)	T3_09	T4_09	T1_10	T2_10	T3_10	T4_10	
Kursi euro/lek	Zhvlerësim vjetor prej 5%						Supozime
Norma e Euribor	+ 100 pikë bazë çdo vit						Supozime
Rritja ekonomike	2.8	2.8	3.25	3.25	3.25	3.25	Supozime
Raporti I kredive me probleme	9.75%	10.48%	12.17%	13.60%	14.57%	15.47%	Llogaritja në bazë të supozimeve
Nevoja për kapital shtesë	-	-	-	-	-	-	Llogaritja në bazë të supozimeve

Tabelë 27. Rezultatet e stress-test për skenarin e tretë.

Skenar 3	T3_09	T4_09	T1_10	T2_10	T3_10	T4_10	
Kursi euro/lek	Zhvlerësim vjetor prej 10%						Supozime
Norma e Euribor	+ 100 pikë bazë çdo vit						Supozime
Rritja ekonomike	2.8	2.8	3.25	3.25	3.25	3.25	Supozime
Raporti il kredive me probleme	9.75%	10.48%	12.17%	13.52%	14.82%	16.18%	Llogaritja në bazë të supozimeve
Nevoja për kapital shtesë	-	-	-	-	-	-	Llogaritja në bazë të supozimeve

Tabelë 28. Rezultatet e stress-test për skenarin e katërt.

Skenar 4	T3_09	T4_09	T1_10	T2_10	T3_10	T4_10	
Kursi euro/lek	Zhvlerësim vjetor prej 20%						Supozime
Norma e Euribor	+ 400 pike bazë çdo vit						Supozime
Rritja ekonomike	2.8	2.8	-0.75	-0.75	-0.75	-0.75	Supozime
Raporti i kredive me probleme			12.17%	15.00%	19.28%	24.63%	Llogaritja në bazë të supozimeve
Nevoja për kapital shtesë (mil)	-	-	-	-	-	3,978	Llogaritja në bazë të supozimeve

Pretendohet që nëse do të ndodhte skenari 3, në fund të vitit 2010, raporti i kredive me probleme do të arrinte në rreth 16%. Në këtë rast, norma e mjaftueshmërisë së kapitalit do të mbetej mbi kufirin e lejuar gjatë gjithë kohës deri në fund të vitit, si rrjedhim nuk do të nevojitej kapital shtesë (për totalin e sitemit bankar, edhe pse për banka të veçanta mund të kërkohej kapital shtesë).

Nëse do të ndodhte skenari 4, në fund të vitit 2010 raporti i kredive me probleme do të ruante në rreth 25%. Ky skenar është shumë ekstrem dhe rrjedhimisht me pak i mundshëm, por përdorimi i tij tregon se ç'madhësi goditjesh mund të përballojë niveli aktual i kapitalizimit të sistemit bankar. Rezulton se në fund të vitit 2010 sistemit do t'i nevojitej një shtesë kapitali prej rreth 4 miliarde lekësh që të arrinte normen e mjaftueshmërisë prej 12%.

Në tabelën më poshtë paraqiten dhe devijimet standarde të raportit të kredive me probleme për secilin skenar si dhe vlerësimet intervalore për nivelet e besueshmërisë 90% dhe 95%.

Tabelë 29. Raporti i kredisë me probleme në fund të vitit 2010.

	Skenar 1	Skenar 2	Skenar 3	Skenar 4
Mesatare	11.54%	15.47%	16.18%	24.63%
Devijim standard	0.011818	0.015123	0.01567	0.020169
Vlerësim intervalor me 90% besueshmëri	9.74%-13.63%	13.15%-18.13%	13.77%-18.93%	19.44%-26.08%
Vlerësim intervalor me 95% besueshmëri	9.41%-14.03%	12.72%-18.63%	13.32%-19.45%	18.84%-26.73%

Në Grafikun 90 jepet shpërndarja e dendurive të vlerave të raportit të huave me probleme për fundin e vitit 2010 të simuluara me metodën Monte Carlo për katër skenarët e mësipërm. Siç tregohet nga grafiku, probabiliteti i përballjes me vlera ekstreme (larg mesatares së llogaritur) të raportit të kredive me probleme rritet nga skenari 1 në skenarin 4.

Si konkluzion i kësaj analize del që në total sistemi bankar është i mirëkapitalizuar dhe i aftë të përballojë goditje ekstreme të faktorëve ekonomikë të cilët përkeqësojnë cilësinë e kredisë.

Megjithatë, kjo provë merret vetëm me rrezikun e kredisë dhe nuk trajton rreziqet e tjera si për

Grafik 90. Shpërndarja e raportit të kredive me probleme sipas katër skenarëve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

shembull, ai i likuiditetit, i normave të interesit etj. Gjithashtu, konkluzioni vlen për sistemin bankar, ndërkohë që për banka të veçanta nevojitet një administrim më i kujdesshëm i portofolit dhe shtesa të kapitalit mund të jenë të nevojshme në varësi të situatave të paraqitura.

TREGUES TË SISTEMIT BANKAR

Tabelë 30 Sektori bankar.

(%)	Dhjetor '07	Dhjetor '08	Qershor '09	Shtator '09	Dhjetor '09
Treguesit me bazë kapitalin					
Kapitali rregullator ndaj aktiveve të peshuara me risk	17.08	17.23	16.85	16.67	16.1708917
Kapitali bazë ndaj aktiveve të peshuara me risk	16.01	16.31	16.10	15.88	15.27023
Kapitali bazë ndaj totalit të aktiveve	6.57	7.83	8.74	8.83	8.66
Kapitali rregullator ndaj totalit të aktiveve	7.01	8.28	9.15	9.27	9.17
Kapitali aksioner ndaj totalit të aktiveve	7.62	8.57	9.34	9.32	9.57
Huatë me probleme neto ndaj kapitalit					
Huatë me probleme neto ndaj kapitalit bazë	10.72	22.97	25.72	27.25	29.93
Huatë me probleme neto ndaj kapitalit rregullator	10.05	21.74	24.58	25.94	28.24
Huatë me probleme neto ndaj kapitalit aksioner	9.14	21.08	24.07	25.80	27.07
Huatë me probleme bruto ndaj totalit të huave	3.36	6.64	8.73	9.75	10.48
Kthimi nga kapitali, ROE (bazë vjetore)	20.74	11.35	1.78	1.79	4.58
Kthimi nga aktivet, ROA (bazë vjetore)	1.57	0.91	0.16	0.16	0.42
Tregues të të ardhurave dhe shpenzimeve					
Marzhi i interesave ndaj të ardhurave bruto	92.67	106.50	129.11	131.51	119.55
Shpenzime jointeresi ndaj të ardhurave bruto	58.51	81.36	201.61	266.99	231.40
Likuiditeti					
Aktive likuide ndaj totalit të aktiveve	49.77	42.83	40.90	41.34	27.65
Aktive likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra (deri në një vit)	73.96	64.86	56.85	63.93	32.58
Pozicioni i hapur neto në valutë ndaj kapitalit					
Pozicioni i hapur neto në valutë të huaj ndaj kapitalit bazë	1.80	4.54	4.60	0.63	4.12
Pozicioni i hapur neto në valutë të huaj ndaj kapitalit rregullator	1.69	4.30	4.40	0.60	3.89
Pozicioni i hapur neto në valutë të huaj ndaj kapitalit aksioner	1.57	4.05	5.06	0.70	4.31

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 31. Grupet sipas madhësisë së aktiveve.

	Dhjetor'07			Dhjetor'08			Qershor '09			Shtator'09			Dhjetor '09		
(%)	G1	G2	G3	G1	G2	G3	G1	G2	G3	G1	G2	G3	G1	G2	G3
Treguesit me bazë kapitalin															
Kapitali rregullator ndaj aktiveve të peshuara me risk	45.1	15.8	15.5	30.8	15.3	16.6	32.1	14.4	16.8	33.0	14.0	16.6	32.7	13.6	16.1
Kapitali bazë ndaj aktiveve të peshuara me risk	48.7	12.5	15.3	29.1	12.5	16.5	30.4	12.4	16.6	33.1	11.6	16.5	32.7	10.9	15.9
Kapitali bazë ndaj totalit të aktiveve	29.5	6.2	5.8	20.3	8.1	7.0	19.4	8.8	8.1	20.6	8.5	8.2	19.1	8.0	8.2
Kapitali rregullator ndaj totalit të aktiveve	29.5	7.9	5.8	21.5	10.0	7.1	20.5	10.2	8.2	20.6	10.2	8.3	19.1	10.0	8.3
Kapitali aksioner ndaj totalit të aktiveve	30.8	7.8	6.6	21.3	7.7	8.2	20.1	9.3	8.7	21.5	8.9	8.7	20.0	8.4	9.3
Huatë me probleme neto ndaj kapitalit															
Huatë me probleme neto ndaj kapitalit bazë	2.2	25.7	7.6	3.6	33.1	23.4	4.0	39.1	24.3	5.1	43.9	25.3	4.9	51.9	27.0
Huatë me probleme neto ndaj kapitalit rregullator	2.2	20.3	7.5	3.4	26.9	23.2	3.8	33.9	24.1	5.1	36.6	25.0	4.9	41.5	26.7
Huatë me probleme neto ndaj kapitalit aksioner	2.1	16.2	6.6	3.5	32.1	20.3	3.8	37.2	22.6	4.9	42.0	23.8	4.7	49.3	23.8
Huatë me probleme bruto ndaj totalit të huave	3.6	4.3	2.7	3.5	7.7	6.4	3.8	10.5	8.2	4.8	11.5	9.2	4.9	13.1	9.6
Kthimi nga kapitali, ROE (bazë vjetore)	2.5	15.3	29.0	(4.5)	(4.8)	18.5	(5.4)	(25.4)	10.4	(5.2)	(22.1)	9.7	(6.5)	####	14.1
Kthimi nga aktivet, ROA (bazë vjetore)	0.8	1.4	1.7	(1.0)	(0.4)	1.4	(1.1)	(2.0)	0.9	(1.1)	(1.8)	0.8	(1.4)	(1.8)	1.2
Tregues të të ardhurave dhe shpenzimeve															
Marzhi i interesave ndaj të ardhurave bruto	74.9	96.8	91.6	79.0	121.0	104.5	84.8	227.2	117.6	85.0	210.7	121.5	89.9	209.6	107.6
Shpenzime jointeresi ndaj të ardhurave bruto	96.3	67.3	51.4	144.7	122.3	67.4	164.2	244.8	197.8	159.1	228.5	281.7	167.5	255.8	231.6
Likuiditeti															
Aktive likuide ndaj totalit të aktiveve	47.3	38.3	55.4	40.1	31.13	46.6	37.8	25.14	45.784	41.1	25.9	46.1	29.7	18.4	30.4
Aktive likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra (deri në një vit)	79.9	55.3	83.3	63.6	49.52	69.3	59.51	39.28	61.206	74.0	44.7	68.5	38.6	23.2	34.9
Pozicioni i hapur neto në valutë ndaj kapitalit															
Pozicioni i hapur neto në valutë të huaj ndaj kapitalit bazë	5.3	3.9	(0.5)	2.4	12.8	2.6	3.1	9.3	3.3	2.3	0.9	0.3	(1.3)	8.0	3.8
Pozicioni i hapur neto në valutë të huaj ndaj kapitalit rregullator	5.3	3.1	(0.5)	2.3	10.4	2.6	2.9	8.0	3.3	2.3	0.8	0.3	(1.3)	6.4	3.7
Pozicioni i hapur neto në valutë të huaj ndaj kapitalit aksioner	5.1	3.3	(0.4)	2.3	11.8	2.2	3.0	12.1	3.5	2.2	1.2	0.3	(1.3)	9.9	3.8

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 32. Grupet sipas origjinës së kapitalit.

	Dhjetor'07				Dhjetor'08				Qershor '09				Shtator'09				Dhjetor			
(%)	Itali	Francë	Greqi	Shqipëri	Itali	Francë	Greqi	Shqipëri	Itali	Francë	Greqi	Shqipëri	Itali	Francë	Greqi	Shqipëri	Itali	Francë	Greqi	Shqipëri
Treguesit me bazë kapitalin																				
Kapitali rregullator ndaj aktiveve të peshuara me risk	15.80	19.65	15.08	14.22	16.9	15.5	16.5	14.7	17.6	14.8	14.8	15.6	18.4	13.5	14.4	15.1	18.8	14.2	14.1	14.2
Kapitali bazë ndaj aktiveve të peshuara me risk	12.96	16.82	15.08	11.05	16.3	13.2	16.5	10.4	16.7	12.7	14.8	11.2	17.5	11.6	14.4	12.0	17.9	11.3	14.1	11.2
Kapitali bazë ndaj totalit të aktiveve	5.45	8.75	9.52	4.56	7.9	8.3	10.8	7.5	8.4	8.8	11.1	7.8	8.8	8.6	11.3	8.2	8.5	8.6	11.2	7.8
Kapitali rregullator ndaj totalit të aktiveve	6.65	10.22	9.52	6.63	8.2	9.7	10.8	10.6	8.9	10.3	11.1	10.9	9.2	10.0	11.3	10.3	9.0	10.8	11.2	9.9
Kapitali aksioner ndaj totalit të aktiveve	7.12	8.91	9.33	5.06	9.3	9.1	9.1	8.3	9.3	9.4	11.5	8.4	10.3	9.3	11.8	8.5	10.5	9.5	11.6	8.1
Huatë me probleme neto ndaj kapitalit																				
Huatë me probleme neto ndaj kapitalit bazë	13.4	15.7	7.2	18.0	12.5	47.6	10.5	16.4	25.2	57.3	21.1	25.2	20.0	59.6	22.9	22.7	25.0	70.0	22.8	42.4
Huatë me probleme neto ndaj kapitalit rregullator	11.0	13.4	7.2	12.4	12.1	40.7	10.5	11.6	24.0	49.1	21.1	18.1	19.1	51.2	22.9	18.0	23.8	55.4	22.8	33.4
Huatë me probleme neto ndaj kapitalit aksioner	10.3	15.4	7.1	16.2	10.7	43.3	17.3	14.8	22.8	53.5	20.3	23.4	17.2	55.0	22.0	21.8	20.3	63.4	21.9	40.6
Huatë me probleme bruto ndaj totalit të huave	3.4	5.7	2.3	2.8	4.3	12.7	4.5	3.1	8.0	16.3	6.5	4.9	7.5	16.8	7.1	5.2	8.8	18.6	8.1	8.1

Kthimi nga kapitali, ROE (bazë vjetore)	20.6	0.3	18.7	32.9	11.8	(18.9)	8.2	19.1	9.5	(38.5)	(5.9)	6.9	14.4	(38.0)	(2.9)	6.8	15.7	(30.8)	(5.7)	4.5
Kthimi nga aktivet, ROA (bazë vjetore)	1.3	0.0	1.8	1.7	1.0	(1.7)	0.7	1.4	0.9	(3.4)	(0.6)	0.6	1.3	(3.4)	(0.3)	0.6	1.5	(2.8)	(0.6)	0.4
Tregues të të ardhurave dhe shpenzimeve																				
Marzhi i interesave ndaj të ardhurave bruto	77.1	122.0	101.7	83.7	83.9	206.3	116.7	88.1	89.0	8374.9	173.2	103.2	78.4	203104.3	147.9	106.4	73.3	381.8	171.7	110.8
Shpenzime jointeresi ndaj të ardhurave bruto	63.0	102.8	56.1	54.2	95.7	205.9	94.1	69.6	98.8	9156.2	796.4	85.1	79.4	215872.6	1045.4	85.7	74.8	537.3	1125.1	91.0
Likuiditeti																				
Aktive likuide ndaj totalit të aktiveve	51.5	42.5	26.7	43.9	47.6	34.0	24.9	29.9	47.3	30.3	19.1	26.4	46.5	29.2	18.0	30.3	34.0	26.7	18.6	21.7
Aktive likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra (deri në një vit)	74.4	73.0	35.9	73.1	72.3	68.4	33.0	48.6	67.5	56.1	25.1	39.6	73.3	57.6	24.2	52.7	40.1	37.6	22.4	25.7
Pozicioni i hapur neto në valutë ndaj kapitalit																				
Pozicioni i hapur neto në valutë të huaj ndaj kapitalit bazë	(7.16)	3.32	(2.01)	11.92	(2.1)	21.1	(2.9)	1.5	1.6	31.4	(0.1)	8.5	0.6	1.1	0.4	1.2	0.6	15.6	(1.7)	6.8
Pozicioni i hapur neto në valute të huaj ndaj kapitalit rregullator	(5.87)	2.84	(2.01)	8.20	(2.1)	18.0	(2.9)	1.1	1.5	27.0	(0.1)	6.1	0.5	0.9	0.4	0.9	0.6	12.4	(1.7)	5.3
Pozicioni i hapur neto në valutë të huaj ndaj kapitalit aksioner	(5.48)	3.25	(1.82)	10.73	(1.8)	19.1	(2.6)	1.4	1.4	29.4	(0.3)	7.9	0.5	1.0	0.8	1.1	0.5	14.2	(3.3)	6.5

Burimi: Banka e Shqipërisë.

SHËNIME

[1] Sistemi financiar përbëhet nga bankat dhe të gjitha institucionet e tjera financiare jobanka, ku përfshihen shoqëritë e sigurimit.
[2] Duke e marrë kursin e këmbimit të lekut ndaj valutave kryesore, të pandryshuar gjatë vitit 2009.
[3] FMN- përditësim- "Parashikimi Ekonomik Botëror ", janar 2010.
[4] Bureau of Economic Analysis - Publikim i muajit shkurt 2010.
[5] News release- botim i datës 4 mars 2010.
[6] Parashikimi i ndërmjetëm -- shkurt 2010.
[7] FMN, përditësim – 'Parashikimi Ekonomik Botëror', janar 2010.
[8] LTRO - long term refinancing operations (operacione rifinancuese afatgjata).
[9] Në 3 mars, Rezerva Federale njoftoi programin (TALF- Term Asset –Backed Securities Loan Facility) përmes të cilit do të jepte hua deri në 200 miliardë dollarë mbajtësve të ligjshëm të titujve ABS të cilësisë AAA, ndërsa në 18 mars, njoftoi blerjen e titujve te mbështetur në kredi hipotekare në vlerë 750 miliardë dollarë. Në Evropë, Banka e Anglisë njoftoi në 5 mars blerjen e aktiveve të sektorit privat, ndërsa BQE bëri të ditur në 7 mars planin e saj për blerjen e obligacioneve të mbuluara deri në vlerën totale 60 miliard euro, i cili u implementua në 6 korrik 2009.
[10] Të gjitha informacionet janë marrë nga raportimet e publikuara në faqet e internetit të grupeve bankare përkatëse. Të dhënat e fundvitit 2009 janë të paauditurara.
[11] Të dhënat për PBB-në dhe rritjen reale të saj për vitet 2001-2007 janë të INSTAT-it. Për vitin 2008, të dhënat janë vlerësime të Ministrisë së Financave, të FMN-së dhe të dhëna të Bankës së Shqipërisë. Për vitin 2009, të dhënat i referohen "Publikimit të PBB tremujor" të INSTAT, Prill 2010.
[12] Në mungesë të të dhënave të publikuara për vitin 2009, i jemi referuar të dhënave për treguesit fiskalë në Kuadrin Makroekonomik dhe Fiskal 2011-2013 të miratuar me vendim të KM, në datë 07.01.2010.
[13] Borxhi qeveritar duke përfshirë borxhin e garantuar nga qeveria. Për konvertimin e stokut të borxhit të jashtëm në lekë është përdorur kursi i këmbimit i fundit të vitit.
[14] I referohet raportit të deficitit buxhetor vjetor ndaj PBB-së nominale prej 1,143,373 milionë lekë (Ministria e Financave).
[15] Zëri "Të tjera" përfaqëson shumën e gjendjes së depozitës së qeverisë pranë Bankës së Shqipërisë, depozitës së sigurimeve shoqërore e shëndetësore, mjetet në ruajtje si edhe principalin e nënhuasë.
[16] Ky indeks merr në konsideratë vetëm Tiranën, pa përfshirë zonat periferike të saj.
[17] Një ankand duhet të ketë raportin mbi 2 që të quhet i suksesshëm.
[18] Raporti bid/cover në ankandet e obligacioneve ka qenë mesatarisht mbi 1.
[19] Bazuar mbi Deklaratën e Politikës Monetare për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2009.
[20] Në janar 2010 u rivendosën ankandet me shumë të kufizuar.
[21] Në fund të vitit 2009, normat mesatare të ponderuara të interesit për depozitat e reja në euro dhe në usd shënojnë rënie në krahasim me fundvitin 2008.
[22] Në përllogaritjen e spread-eve të normave të interesit midis depozitave dhe kredive të reja, janë përfshirë dhe llogaritë rrjedhëse, megjithëse këto të fundit janë pak të ndjeshme ndaj normave të interesit.
[23] Mbështetur në analizat, matjet dhe vlerësimet e Departamentit të Sistemeve të Pagesave, Banka e Shqipërisë.
[24] Sistemi financiar përbëhet nga: bankat, institucionet financiare jobanka, shoqëritë e sigurimit, shoqëritë e kursim-kreditit dhe fondet e pensionit private suplementare.
[25] Është shfrytëzuar vlera e PBB-së prej 1,143.37 miliardë lekësh, vlerësim i FMN-së dhe Ministrisë së Financave.
[26] Të dhënat e përdorura për analizën financiare të institucioneve jobanka i referohen tremujorit të tretë të vitit 2009, si periudha e fundit për të cilën ato kanë raportuar aktivitetin e tyre pranë Bankës së Shqipërisë.
[27] Referuar raportit të publikuar nga AMF, Dhjetor 2009. Aktualisht, operojnë 9 shoqëri sigurimi

të jo-jetës dhe 3 shoqëri sigurimi të jetës.

[28] Ky raport në tremujorin e fundit të vitit 2008 u llogarit në nivelin 172% dhe në tremujorin e dytë të vitit 2009 në nivelin 134%.

[29] RoA është llogaritur si raport i rezultatit financiar të periudhës (për shembull, nëntëmujori i parë i vitit 2009) ndaj aktiveve mesatare (mesatarja e aktiveve për dy periudha 2009 dhe 2008), e njëjta formulë edhe për RoE, por ndaj kapitalit mesatar.

[30] Në tremujorin e katërt të vitit 2008, aktivet e shoqërive të kursim-kreditit bashkë me unionet e tyre përfaqësonin 0.7% të PBB-së së vendit.

[31] Në rast se nga vlerat e aktiveve, për efekt krahasimi, hiqet efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit, aktivet e sektorit bankar paraqesin një rritje me rreth 1.2%, si kundrejt dhjetorit 2008, ashtu edhe kundrejt shtatorit 2009. Gjatë vitit 2009, leku është zhvlerësuar me 11% kundrejt euros dhe me 9% kundrejt usd.

[32] Përfshirë interesat e përllogaritura.

[33] Përfshijnë transaksionet që kryejnë bankat me Bankën e Shqipërisë (depozita, rezervë e detyruar, operacionet e tregut të hapur – marrëveshjet e riblerjes, transaksionet me bonot e thesarit, si edhe operacionet midis bankave tregtare (depozita, llogari rrjedhëse, hua etj.).

[34] Përfshirë interesat e përllogaritura.

[35] Përveç veprimeve me Bankën e Shqipërisë (marrëveshjet e anasjellta të riblerjes), përfshijnë edhe marrëdhëniet (huamarrjet nga) me banka të huaja (kryesisht, nga grupi bankar të cilit i përkasin).

[36] Përfshin rezervat specifike, llogarinë e kapitalit (kapitali i paguar, fitimi/humbja e mbartur, fitimi/humbja e vitit, rezervat, diferencat e rivlerësimit), etj.

[37] Shih paragrafin "Treguesit e kapitalit".

[38] Kriteri për ndarjen e bankave në grupe është madhësia e aktivitetit: konkretisht, G1 është grupi i bankave të vogla (pesha e aktiveve të secilës bankë në këtë grup është nën 2% të totalit të aktiveve të sistemit); G2 është grupi i bankave të mesme (pesha e secilës bankë përbërëse të këtij grupi është midis 2 dhe 7% e totalit të aktiveve të sistemit) dhe G3 është grupi i bankave të mëdha (pesha e secilës bankë në këtë grup është mbi 7% e totalit të aktiveve të sektorit bankar).

[39] Gjatë vitit 2009, aktivet në valutë të sektorit bankar janë rritur me rreth 37 miliardë lekë, ndërsa pasivet në valutë me 28.5 miliardë lekë. Kjo prirje është vënë re veçanërisht ndërmjet muajve korrik – gusht 2009 dhe ka ardhur si pasojë e thellimit të diferencave midis aktiveve dhe pasiveve në valutë për disa banka të sistemit, të cilat evidentojnë ritëm më të lartë rritjeje të mjeteve në valutë kundrejt detyrimeve në valutë.

[40] Është llogaritur mesatarja e ponderuar e shpërndarjes së aktiveve, sipas kategorive të raportuara të maturimit. Për çdo interval është marrë "apriori", një vlerë pranë mesit të tij. Konkretisht, për intervalin që përfshin aktivet me maturim të mbetur "0-7 ditë", kohëzgjatja mesatare është marrë 3.5 ditë; për atë "7 ditë deri në 1 muaj", kohëzgjatja mesatare është marrë 18.5 ditë; për atë "1-3 muaj", kohëzgjatja mesatare është marrë 2 muaj; për atë "3-6 muaj", kohëzgjatja mesatare është marrë 4.5 muaj; për intervalin "6-12 muaj", kohëzgjatja mesatare është marrë 9 muaj; për intervalin "1-5 vjet", kohëzgjatja mesatare është marrë 36 muaj; për intervalin "mbi 5 vite", kohëzgjatja mesatare është marrë 10 vite ose 120 muaj (duke qenë së pjesa më e madhe në këtë segment përfaqësohet nga kreditë hipotekare me maturim fillestar 15 vjet).

[41] Është llogaritur mesatarja e ponderuar e shpërndarjes së pasiveve, sipas kategorive të raportuara të maturimit. Për çdo interval është marrë një vlerë pranë mesit të tij. Konkretisht, për intervalin që përfshin pasivet "0-7 ditë", kohëzgjatja mesatare është marrë 3.5 ditë; për atë "7 ditë-1 muaj", kohëzgjatja mesatare është marrë 18.5 ditë; për atë "1-3 muaj", kohëzgjatja mesatare është marrë 2 muaj; për atë "3-6 muaj", kohëzgjatja mesatare është marrë 4.5 muaj; për atë "6-12 muaj", kohëzgjatja mesatare është marrë 9 muaj; për intervalin "1-5 vjet", kohëzgjatja mesatare është marrë 36 muaj; për intervalin "mbi 5 vite", kohëzgjatja mesatare është marrë 6 vite ose 72 muaj.

[42] Është llogaritur mesatarja e ponderuar e shpërndarjes së depozitave, sipas kategorive të raportuara të maturimit. Për çdo interval është marrë "apriori", një vlerë pranë mesit të tij. Konkretisht, për intervalin që përfshin depozitat "deri në 7 ditë", kohëzgjatja mesatare është marrë 3.5 ditë; për atë "7 ditë-1 muaj", kohëzgjatja mesatare është marrë 18.5 ditë; për atë "3-6 muaj", kohëzgjatja mesatare është marrë 4.5 muaj; për intervalin "6-12 muaj", kohëzgjatja mesatare është marrë 9 muaj; për intervalin "1-5 vjet", kohëzgjatja mesatare është marrë 36 muaj; për intervalin "mbi 5 vjet", kohëzgjatja mesatare është marrë 6 vjet ose 72 muaj.

[43] Është llogaritur mesatarja e ponderuar e shpërndarjes së kredisë, sipas kategorive të raportuara të maturimit. Për çdo interval është marrë "apriori", një vlerë pranë mesit të tij. Konkretisht, për intervalin që përfshin kreditë "deri në 7 ditë", kohëzgjatja mesatare është marre 3.5 muaj; për atë "7 ditë -1 muaj", kohëzgjatja mesatare është marrë 18.5 ditë; për atë "3-6 muaj", kohëzgjatja mesatare është marrë 4.5 muaj; për intervalin "6-12 muaj", kohëzgjatja mesatare është marrë 9 muaj; për intervalin "1-5 vjet", kohëzgjatja mesatare është marrë 36 muaj; për intervalin "mbi 5 vjet", kohëzgjatja mesatare është marrë 10 vjet ose 120 muaj.

[44] Në formën e pasurive të patundshme, apo të kolateraleve të tjera si: depozita, automjete, makineri dhe pajisje etj..

[45] Përfshin linjat e kredisë, pjesën e papërdorur.

[46] Zëri "fondet rezervë të krijuara", me rritjen e tij shkakton efekt negativ në totalin e aktiveve, për shkak të shenjës së tyre negative (fondet rezervë të tre klasave të fundit të kredive pasqyrohen në aktiv, me shenjë negative).

[47] Mesatarja historike e llogaritur përfshin periudhën mars 2006-dhjetor 2009.

[48] Vlera e kredisë së re është e zhveshur nga efekti i kursit të këmbimit.

[49] Si kategoria me peshën më të lartë të tepricës së kredisë akorduar sektorit të biznesit, rritja reale për këtë kategori të zhveshur nga kursi i këmbimit rezulton 18.3% krahasuar me fundin e vitit 2008.

[50] Rreth 49.6 miliardë lekë (ose 17%) e tepricës së kredisë dhënë bizneseve, i përket kredisë për kapital qarkullues, poshtë mesatares së periudhës prej 19%. Rreth 77 miliardë lekë (ose 26.5%) përfaqësojnë investime në blerje pajisjesh, poshtë vlerës së mesatares së llogaritur prej 29.6%, dhe rreth 67.8 miliardë lekë (ose 23.3%) përfaqësojnë investime në pasuri të paluajtshme, me një luhatje të lehtë nga mesatarja prej 22.5%.

[51] Nga kredia për individët/familjet, rreth 6 miliardë lekë (ose 4.4%), janë marrë në formën "overdraft", poshtë mesatares së periudhës prej 4.8%; rreth 16 miliardë lekë (ose 11.5%), janë marrë kredi për konsum të mallrave jo të qëndrueshme, duke shënuar një rritje të konsiderueshme nga mesatarja prej 5.5%. Ndërkohë, rreth 8.2 miliardë lekë (ose 5.9%) janë marrë kredi për konsum të mallrave të qëndrueshëm, me një rënie të theksuar nga mesatarja prej 13.9%. Njëkohësisht, rënie të peshës ka shënuar edhe kredia akorduar për "ushtrim aktiviteti" në 8.2% nga 10%, që është vlera mesatare.

[52] Pesha mesatare e tepricës së kredisë sipas secilit rreth ndaj totalit është marrë për periudhën dhjetor 2007 deri në dhjetor 2009.

[53] Shpërndarja e kredisë sipas afateve për rrethet kryesore evidenton se kredia në harkun kohor T4/07-T4/09 është dhënë kryesisht në periudhën afatshkurtër në rrethin e Tiranës, me një peshë mesatare 73%. Ndërkohë, në rrethin e Durrësit dominon kredia dhënë në periudhën afatgjatë me një peshë mesatare 7.9% dhe në qytetin e Vlorës, kredia në periudhën afatmesme me 5.1%.

[54] Më konkretisht sipas monedhave, raporti i mësipërm në euro rezulton 9.8% nga 6.1% në fund të vitit 2008, dhe në dollarë ky tregues u ngjit në 8.5% nga 4.9% një vit më parë.

[55] Kolaterali në formën e pasurive të paluajtshme (rezidenciale, tregtare ose tokë), cash etj.

[56] Raporti i kapitalit rregullator me aktivet e ponderuara me koeficientët përkatës të rrezikut. Niveli minimal për këtë tregues, i kërkuar nga kuadri rregullativ i mbikëqyrjes, është 12%.

[57] Për dhjetë banka, janë kryer derdhje kapitali aksioner gjatë vitit 2009.

[58] Kur u referohemi treguesve kthim nga kapitali (RoE) dhe kthim nga aktivet (RoA), bëhet fjalë për tregues me bazë vjetore.

[59] Për një analizë më të hollësishme të këtij zbërthimi, shih studimin e Irini Kalluci "Analizë e sistemit bankar shqiptar nën këndvështrimin rrezik – performancë", Banka e Shqipërisë, 2009.

[60] Përqendrimi i depozitave në sistemin bankar është matur me anë të indeksit të Herfindahl-it. Vlera për fundin e vitit 2009 ishte 1551, nga 1732 në dhjetor 2008. Kjo tregon ende një përqendrim të lartë të depozitave në sistemin bankar, megjithëse në rënie.

[61] Nga dhjetori i vitit 2008 në fundin e vitit 2009, rritja për depozitat në valutë ka qenë 40 miliardë lekë, ndërsa ajo për tepricën e kredisë vetëm 12.5 miliardë lekë.

[62] Ndikimin më të madh në rritjen e aktiveve deri në tre muaj e kanë pasur aktivet "shtatë ditë deri në një muaj", që u rritën me 12.2% në vitin 2009. Ndërkohë, aktivet "deri në një javë" dhe aktivet "një deri në tre muaj", respektivisht u rritën 10% dhe ranë 9%. Peshën më të madhe në rënien e pasiveve afatshkurtëra e kanë pasur pasivet "deri në dhjetë ditë", të cilat ranë me 16% krahasuar me fundin e dhjetorit 2008. Ndërsa, pasivet "dhjetë ditë deri në një muaj" dhe "një deri në tre muaj", të cilat u rritën përkatësisht 16.2 dhe 4.2%. Për dhjetorin 2009, shporta e aktiveve dhe

pasiveve "deri në dhjetë ditë" ka ndryshuar në shportën "deri në një javë" dhe shporta e "dhjetë ditë deri në një muaj" ka ndryshuar në "një javë deri në një muaj" (mbështetur në raportimet e reja sipas rregullores "Për administrimin e rrezikut të likuiditetit").

[63] Skenarët ne fjalë nuk përbëjnë parashikime të NPL, pasi ecuria e tyre varet nga një shumëllojshmëri faktorësh si mikro ashtu edhe makroekonomikë, por shërbejnë si referencë për të vlerësuar ndikimin e ndryshimit të situatës makroekonomike në cilësinë e kredisë.